

MEDIACIONI INTERKULTUROR

**Milena Dragiqeviq Sheshiq
Sanjin Dragojeviq**

Titulli i originalit / Milena Dragicevic Šešic / Sanjin Dragojević, Interkulturna medijacija

Përktheu nga serbokroatishtja / Anton Berishaj

Botues / Revista MM / Qendra për studime humanistike "Gani Bobi" Prishtinë

Për botuesin / Shkëlzen Maliqi

Shtypi / Dukagjini, Pejë

Tirazhi / 800 ekz.

Layout / Dren Maliqi

Përkthimin dhe botimin e këtij libri ndihmoi / Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KFOS)

**Edicioni MM
2006**

PËRMBAJTJA

HYRJE 9

**KONTEKSTI KULTUROR I BALLKANIT, RESPEKTIVISHT I EVROPËS JUGLINDORE:
DIVERSITETI DHE STIGMATIZIMI**

Mozaiku multikulturor dhe komunikimi interkulturor **17**

Kujtesa kolektive dhe konstruksioni i identitetit **21**

Udhëzime metodologjike për punën dhe edukimin në komunikimin interkulturor **24**

POLITIKA KULTURORE DHE ZHVILLIMI KULTUROR

Pse Bosna e Hercegovina nuk e ka një politikë kulturore shtetërore? **32**

Komunikimi interkulturor dhe procesi i konceptimit dhe miratimit të politikës kul-
turore (shtetërore) **34**

Politika kulturore si një mjet i medacionit interkulturor: qëllimet metodike dhe
detyrat për punë **38**

SEKTORI CIVIL DHE ROLI I TIJ NË JETËN KULTURORE

Tre sektorë në zhvillimin kulturor **44**

Zhvillimi dhe qëndrueshmëria e sektorit civil në regjion **53**

Veprimi i shoqërisë civile në kulturë: qëllimet metodike dhe detyrat për punë **54**

MENAXHMENTI STRATEGJIK DHE PROJEKTET MULTIKULTURORE

Qasja strategjike ndaj zhvillimit të organizatave joqeveritare **60**

Konceptualizimi dhe formësimi i një projekti interkulturor **65**

Menaxhmenti projektues

Cikli jetësor i projektit

Struktura e kërkesës për dotacion - letër fondacionit ose ministritë **69**

Evaluimi i projektit interkulturor Të jetosh në ardhmëri: qëllimet metodike dhe detyrat	SHTOJCAT
MEDIACIONI INTERKULTUROR DHE DIALOGU NË KOMUNITETET MULTINETNIKE 77	Shtojca 1.
Mediacioni socio-kulturor dhe zvogëlimi i distancës sociale 82	
Format e medacionit interkulturor dhe socio-kulturor 85	
mediacioni i orientuar drejt grupeve më të gjera të populates 90	
mediacioni i lidhur me grupet me nevoja të veçanta 101	
mediacioni i lidhur me grupet me identitetë pakice dhe identitetë specifike 103	
mediacioni i lidhur me grupet e izoluara dhe të marginalizuara në hapësirë 106	
Qëllimet metodike dhe detyrat e medacionit interkulturor 108	
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR REGIONAL, PARTNERITETI DHE RRJETËZIMI	Shtojca 2.
Pengesat, bllokadat dhe rrethanat e pavolitshme për vendosjen e bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar në regjion 114	
Përparësitë dhe mangësitë e nismave ndërkombëtare në regjion 119	
Partneriteti 123	
Rrjetet 126	
Strategjite zhvillimore të rrjeteve 130	
Bashkëpunimi jashtë kornizave lokale: qëllimet metodike dhe detyrat 131	
VETËVLERËSIMI: SI TË SHQYRTOHET VETVETJA DHE ZHVILLIMI VETJAK	Shtojca 3.
Parametrat interkulturorë dhe kriteret për evaluimin e zhvillimit organizativ 136	
Vlerësimi dhe vetëvlerësimi: qëllimet metodike dhe detyrat 141	
LITERATURA 145	
Pyetësor për bisedë grupore: Multikulturaliteti dhe të drejtat Kulturore 154	
Pyetësor për vetëvlerësim rreth shkallës së arritur të multikulturalitetit brenda OJQ-ve 157	
Pjesa hyrëse e planit strategjik afatshkurtër të Qendrës për Artin Bashkëkohor, Sarajevë 158	
Pyetësori vlerësues i seminarit "Mediacioni interkulturor", mbajtur në Mostar dhe Sarajevë 163	
Mediacioni i artit në periferitë - "FLUX02 - modernizimi gjithandej!", Beograd 167	
Deklaratë për opinion e Institutit Multimedial, Zagreb 169	
Queer Zagreb 174	
Strategjia e zhvillimit të kulturës në Kosovë 178	

HYRJE

KUJT I DREJTOHET DHE ÇFARË QËLLIMI KA NJË MANUAL I KËTILLË?

Zhvillimi i pasluftës i Bosnjës e Hercegovinës e ka hapur në masë të plotë çështjen e komunikimit dhe medacionit interkulturor, si në kontekstin e Ballkanit, ashtu edhe në suazat më të gjera evropiane. Mungesa e procesit të dialogut dhe komunikimit midis grupeve etnike të këtij vendi, padyshim, mund të konsiderohet si një pengesë themelore shoqërore, por edhe zhvillimore. Që nga përfundimi i luftës ka kaluar mjaft kohë, por megjithatë mund të konstatohet se problemi jo vetëm që nuk po zgjidhet, por po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm dhe po fiton në fuqi. Për këtë arsy, UNESCO e ka iniciuar një projekt të edukimit interkulturor, duke dashur që pjesëtarët e gjeneratës më të re të aktivistëve kulturorë lokalë, në tërë Bosnjën e Hercegovinën, t'i ndërlidhë, informojë dhe stimulojë që të bëhen kreatorë të projekteve të medacionit kulturor në mjedisin e vet, duke i tejkaluar kufijtë e komuniteteve etnike dhe të shteteve nacionale. Kështu, është imponuar komponenti regional, si një kornizë relevante jo vetëm për konceptimin, por edhe për implementimin e mundshëm të përpjekjeve dhe projekteve bazike në këtë fushë.

Seminaret në Mostar e Sarajevë, të mbajtura gjatë vitit 2002, nga njëra anë kanë përfaqësuar bazën konceptuale të projektit të edukimit, ndërsa në anën tjetër ato kanë ofruar mundësinë e vërtetimit praktik të shkallës së suksesit së metodës së medacionit në themelimin e programeve konkrete interkulturore.

Duke patur parasysh se në Bosnje e Hercegovinë akterët themelorë të politikës kulturore shumë rrallë vendosin një komunikim dhe bashkëpunim të drejtëpërdrejtë, kemi vendosur që pjesëmarrësit në seminar të janë aktivistë të organizatave

joqeveritare, të cilat me punën e tyre të gjertanishme kanë vendosur bashkëpunim midis tyre nëpërmjet nismave të ndryshme në mjeshtirë lokal dhe atë regional më të gjerë. Pjesëmarrësit vinin kështu nga fusha të ndryshme veprimi: puna sociale, ekologjia, mediat, aktivizmi femëror, arsimi, kultura dhe arti. Edhe pse kryesisht shumë të rindërtuar, ata i kanë fituar përvojat e caktuara në organizimin dhe veprimin e sektorit civil duke iu falenderuar trajnimeve të organizatave ndërkombëtare. Gjatë përgjedhjes i është kushtuar një vëmendje e veçantë faktit që pjesëmarrësit të vijnë nga vise të ndryshme të Bosnjës e Hercegovinës (Banja Lluka, Bërçko, Dobojs, Magllaj, Srebrenica, Sarajeva, Mostari, Tuzla, Zenica...), si dhe nga shtetet fqinje (Sllovenia, Kroacia, Serbia).

Puna në seminar ka treguar se ekziston një nevojë dhe dëshirë e madhe për vendosjen e dialogut dhe komunikimit interkulturor, por që para së gjithash mungojnë informacionet, dijet, kontaktet e drejtpërdrejta dhe programet mbështetëse për projekte interkulturore. Në këtë kuptim, seminari ka ofruar mundësitet për një numër të caktuar pjesëmarrësish që të marrin informacione dhe njohuri filiste, të domosdoshme për konceptim të pavarur dhe për udhëheqjen e projekteve të këtilla, mirëpo ata kanë theksuar nevojën për të pasur edhe një mbështetje të përhershme në punën e tyre të ardhshme – një doracak ose libër që do t'i përbante si informacionet, ashtu edhe udhëzime më të gjera për presupozimet, suazat dhe metodat e veprimit në këtë domen.

Literatura e këtij lloji është jashtëzakonisht e rrallë edhe në botë, ndërsa në këto hapësira ekzistojnë të botuar vetëm ese dhe artikuj sporadikë, më tepër të njohur për opinionin shkencor sesa për atë kulturor apo më të gjerë, të cilët e themelojnë teorikisht këtë fushë, por vështirë që mund të jenë të dobishëm për aktivistët - praktikantët.

Për këtë arsy, ky manual përpinqet t'i përfshijë si kornizat e përgjithshme kulturore-historike të komunikimit interkulturor në Ballkan (mitet, paragjykimet, simbolet...),

ashtu edhe presupozimet referente bashkëkohore (politika kulturore, sistemi informativ medial, baza institucionale e kulturës...), si dhe dijet dhe mundësitetë praktike (metodat e animimit, rrjetet e kulturës, menaxhmenti i projekteve, fundraising-u, etj.).

Manuali u dedikohet të gjithë atyre që fushëveprimin e vet e shohin në hapësirën e gjerë të komunikimit interkulturor në komunitetin e tyre lokal, në Ballkan dhe në Evropë, nëpërmjet rrjeteve, institucioneve të kulturës, organizatave joqeveritare, projekteve artistike, aktivizmit social, etj. Edhe vetë shkurtësia e publikimit flet përfaktin se ky është vetëm i pari në vargun e atyre që do ta trajtojnë këtë fushë në mënyrë sistematike dhe gjërësisht.

Meqenëse autorët e doracakut shkruajnë në gjuhë të ndryshme, domethënë në gjuhën kroate gjegjësisht serbe, kanë vendosur që do të ishte më së miri që doracaku të botohet në gjuhën boshnjake për arsyet e harmonizimit të tij gjuhësor.

Autorët do të dëshironin në mënyrë të veçantë t'i shprehnin falenderimin e tyre Jasmina Bashiqit, koordinatore për programet kulturore në Zyren e UNESCO-s në Sarajevë, për ndihmën e ofruar në organizimin e të gjitha aktivitetave në këtë projekt, si dhe për mbështetjen dhe stimulimin e vazhdueshëm për shkrimin dhe botimin e këtij manuali. Po kështu i falenderojmë edhe Janka Vukmirin, Damir Shimiçiqin, Zhelko Mërkshiçin, Gordana Lubiç Savinin, Millan Lluçiqin, Svetllana Joviçiqin dhe Violeta Simjanovskan për mirëkuptimin dhe ndihmën në gjetjen e dokumenteve dhe kontributave me rëndësi për përbajtjen e këtij publikimi.

Milena Dragiqeviq Sheshiq, rektor i Universitetit të Artit, është profesoreshë e Menaxhmentit në Kulturë dhe Teorisë së Masmedias pranë Fakultetit të Artit Dramatik në Beograd. Është konsulente e shumë organizatave ndërkombëtare në fushë të politikës kulturore dhe menaxhmentit kulturor (Council of Europe, UNESCO, European Cultural Foundation...), po ashtu është ligjëruese në kurset ndërkombëtare.

bëtare të studimeve postdiplomike (Bruxelles, Lyon, Paris, Dijon, Krakov, Moskë, etj.). Është anëtarë e Board-it ELIA. Ka botuar një numër të madh librash dhe studimesh nga këto fusha, të përkthyera në më shumë gjuhë të huaja.

Sanjin Dragojeviq, është ligjërues i Sociologjisë së Kulturës, Sociologjisë së Komunikimeve Masive dhe Politikës Kulturore pranë Fakultetit të Shkencave Politike në Zagreb. Është konsulent i shumë organizatave ndërkombëtare në fushën e politikës kulturore, menaxhmentit kulturor dhe sistemeve informative në kulturë (UNESCO, Council of Europe, European Cultural Foundation...). Është anëtar i Këshillit Ekzekutiv të rrjeteve Culturelink dhe CIRCLE. Është ligjërues në shumë kurse ndërkombëtare (Vjenë, Krems, Dubrovnik, Amsterdam, Beograd, etj.). Ka botuar një numër të madh publikimesh në këtë fushë.

Të dy këta autorë bashkëpunojnë një kohë të gjatë, si në projekte hulumtuese ndërkombëtare, ashtu edhe në formësimin dhe realizimin e kurseve edukative, programeve trajnuese në mjediset multikulturore. Marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e krijimit të politikave kulturore dhe strategjive të zhvillimit kulturor në Serbi dhe Kroaci, si dhe në definimin e strategjive kulturore të qyteteve.



KONTEKSTI KULTUROR I BALLKANIT,
RESPEKTIVISHT I EVROPËS JUGLINDORE:
DIVERSITETI DHE STIGMATIZIMI

Mozaiku multikulturor i Ballkanit krijohet pikësëpari rreth këtyre elementeve përcaktuese:

- shumësisë së kulturave që u përkasin etnive të ndryshme në themel të lidhura me këtë territor: etnia sllave (kultura sllovene, kroate, serbe, boshnjake, malazeze, maqedone, bullgare); etnia romane (kultura rumune, kultura e grupit etnik vllah), kultura greke, kultura turke dhe kultura shqiptare...
- kulturat e grupeve etnike më të vogla (romët, hebrejtë, ukrainasit, rusinët, hungarezët, sllovakët, çekët, vllehët, etj.)
- religjioneve të ndryshme (krishterimi: katolikët, ortodoksët, protestantët), myslimanët, hebrejtë...
- vendeve multikulturore (Bosnja e Hercegovina), regjioneve (Vojvodina, Istria, Kosova) dhe viseve që definoohen nëpërmjet jetës së përbashkët të më shumë komuniteteve (p.sh. Boka e Kotorrit, Sanxaku...)
- qytetet dhe lokalitetet, të cilat në më shumë kultura kanë një domethënë specifike për identitetin kulturor dhe ndjenjën nationale (Mali i Shenjtë në Atos për besimtarët ortodoksë, Ohri për maqedonët dhe bullgarët, Prizreni për serbët dhe shqiptarët, Shkodra për malazezët dhe shqiptarët, Kotorri për malazezët dhe kroatët, etj.).
- diversiteti i gjuhëve dhe alfabeteve. Përveç gjuhëve që lidhen me etni të veçanta, diversiteti nënkupton edhe përdorimin e alfabetit latin, cirilik dhe grek, ndërsa deri në shekullin XX është përdorur edhe alfabeti arab.


Krahas kësaj, edhe historia politike ka ndikuar në krijuimin e kufijve të brendshëm dhe të jashtëm të regjionit, njësoj edhe në fragmentarizimin dhe homogenizimin e kësaj hapësire. Që nga fillimi i shekullit XIX deri sot, regjioni ka pësuar

ndryshime të mëdha. Nëpërmjet luftërash janë krijuar shtetet nacionale në pjesën e parë të shekullit XIX (Greqia, Serbia, Bullgaria), me proceset paqësore janë ridefinuar kufijtë (Kongresi i Berlinit – aneksimi i Bosnjës), me luftërat ballkanike janë zgjeruar kufijtë e shteteve nacionale atëbotë ekzistuese, që me Paqen e Versajës regjioni të dekompozohej, çfarë pati si pasojë krijimin e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Pas Luftës së Dytë Botërore, Lufta e Ftohtë e vendosi një kufi të fortë midis Ballkanit Perëndimor dhe atij Lindor, njësoj sikur ndaj Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Periudha tranzitore dhe pësimet e luftës do të sjellin krijimin e shteteve të reja të pavarura (Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia e Mali i Zi, Maqedonia) dhe ndarjen territoriale mbi baza të reja (Kosova, Republika Serbe). Me këtë, regjioni gjatë viteve nëntëdhjetë i fitoi tiparet e hapësirës politikisht më jostabile në Evropë.

Të gjitha këto arsyen kanë kushtëzuar që në përmasa kontinentale evropiane të mos ekzistojë një region me më shumë diversitet kulturor, i cili edhe historikisht, edhe gjeografikisht, në mënyra aq të ndryshme është definuar si në shkencë, ashtu edhe në praktikën e përditshme të politikës. Që këndej nuk çudit fakti që në përdorim janë dy terma, të cilët vetëm parimi shpesh përfshijnë territorin e njëjtë: Ballkani dhe Evropa Juglindore. Edhe pse shpesh Evropa Juglindore duket si një eufemizë për Ballkanin, ajo megjithatë ka një përfshirje shumë më të gjërë territoriale, prandaj në këtë kontekst shumë shpesh presupozohet që edhe Hungaria, Sllovenia dhe Molldavia i përkasin këtij regjioni, ndërsa rëndom ato nuk gjenden në listën e vendeve ballkanike.

Komunikimi i Ballkanit me Evropën, si dhe komunikimi i vendeve, shteteve dhe popujve ballkanikë midis tyre, jo vetëm që është kompleks për shkak të diversitetit të tij të brendshëm, por është i ngarkuar me paragjykime, stereotipa të shumtë, si dhe me probleme të pazgjidhura nga e kaluara e afërt dhe ajo më e largët.

Meqenëse Tjetri dhe i ndryshmi nga vetvetja shihet shumë shpesh si një kërcënim dhe pengesë, Ballkanin e karakterizon “handikapi i heterogenitetit”, i cili është



Erzen Shkolollli, Pejë: Transicioni 2001 (Synetimi, Pioneri, Evropiani)

thellësisht në kundërshtim me tendencat bashkëkohore të integrimeve evropiane. Kështu edhe fjala “ballkanizim” filloi të shenjojë fragmentimin, shpërbërjen, konfliktitat, ndërprerjen e komunikimit dhe bashkëpunimit. Në këtë kuptim identiteti ballkanik merr një konotacion negativ të trashëgimisë që rëndon (Todorova), tiparin e stigmës, dhe gradualisht shndërrohet në një faktor kufizues zhvillimor në përmasa regjionale dhe kontinentale.

Rëndom tri metafora ballafaqohen në përshkrimin dhe shpjegimin e thelbët të Ballkanit: URA, UDHËKRYQI dhe KUFIRI. Edhe pse të kundërtë në domethënien e tyre themelore, ato i pasqyrojnë fare mirë të gjitha kontraverzat, si dhe stereotipat pozitivë dhe negativë për Ballkanin si një hapësirë ku takohen/ndahen Lindja

Fjala “ballkanizim” përdoret shumë në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore për cilindë rajon në botë ku shfaqen proceset dezintegruese: “I filluar me Kongresin e Berlinit në shekullin XIX, ballkanizimi i Afrikës Perëndimore po vazhdon edhe sot” (gazeta e përditshme “Kjo ditë”, Lagos, Nigéri, janar 2003, me rastin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare në Hagë me të cilin siujdhesa Bakasi i merret Nigerisë dhe i jepet Kamerunit).

dhe Perëndimi, Orienti dhe Oksidenti, bota myslimanë dhe e krishterë, latiniteti dhe tradita bizantine... hapësirë, e cila është njëkohësisht edhe pikëtakim dhe vijë ndarëse e botëve të ndryshme.

Kur flitet për vështrimin nga brenda është e rëndësishme të thuhet se përkatësia në të gjitha regjionet tjera evropiane ose ka një dimension pozitiv ose të paktën një dimension vlerësues neutral (identiteti mediteran, skandinav, i Evropës Qendrore, baltik etj.), ndërsa kur është fjalë te identiteti ballkanik ai me vete bart edhe një konotacion negativ: egërsinë, ndotjen, mjerimin, primitivizmin, prapambetjen, fatalizmin, ekskluzivitetin.

Në vetidentifikimin pozitiv do të bënin pjesë vlerat që lidhen me kulturat tradicionale, si trimëria, nderi, karakteri liridashës, mikpritja, krenaria, si dhe emocionaliteti i theksuar, karakteri pasionant (që përfshin edhe urejtjen), temperamenti, energjia, etj. Për shkak të këtij karakteri dysor, shumica e popujve ballkanikë ka nevojë jo aq për ta pranuar, sa për ta tejkaluar këtë identitet ("Deri kur më do të mbetemi ballkanas!"). Disa prej tyre themelët e një vetidentifikimi të ri do të përpilen t'i gjejnë pikërisht te distanca ndaj identitetit ballkanik (sllovenët, kroatët). Të rrallë janë ata, si bullgarët, që nuk shohin asgjë kontestuese te vetidentifikimi me Ballkanin.

Vështrimi nga jashtë e përjeton Ballkanin po ashtu në dy mënyra: si një "fuçi baroti", një hapësirë konfliktesh nga njëra anë, por edhe si një hapësirë mitike ku jetojnë njerëz emocionesh të lira, pasionesh të theksuara, karakteresh të forta në skajin ekzotik të Evropës. Ndryshe nga Ballkani, termi Evropa Juglindore thekson (pa)mundësinë e zbatimit të një modernizimi të thellë në regjion, duke e çliruar ashtu konceptin nga pjesa më e madhe e stereotipave romantizues, pastaj edhe të atyre pozitivë a negativë. Mirëpo, madje as ai term nuk është në tërësi pa konotacione vlerësuese negative, sepse është përdorur për emërtimin e regjionit në kohën e regjimit totalitar dhe vrastar të Hitlerit.

Megjithatë, është me rëndësi të madhe të theksohet se të gjitha vendet e Evropës Juglindore krahas identitetit ballkanik përmbyjnë edhe identitetin e tjera regionale (Kroacia edhe atë të Evropës Qendrore edhe atë mediteran, Serbia atë të Evropës Qendrore, Mali i Zi – atë mediteran, Bosna e Hercegovina – të Evropës Qendrore dhe të mediteranit, Greqia – atë mediteran dhe evroperëndimor, Bullgaria – identitetin e Detit të Zi dhe Shqipëria – identitetin mediteran). Aq më tepër, është e pazakontë që pjesa më e madhe e këtyre vendeve e konsideron veten peng të identitetit ballkanik, i cili kështu, është fare e qartë, theksohet në mënyrë hierarkike si tepër i fortë ose si më i fortë.

KUJTESA KOLEKTYVE DHE KONSTRUKSIONI I IDENTITETIT

Historia e përbashkët e Ballkanit praktikisht nuk ekziston, sepse u nënshtrohet interpretimeve që e përjashtojnë njëri-tjetrin. Edhe pse që nga ardhja e sllavëve në Ballkan ngjarjet historike kanë ndikuar njëkohësisht te të gjithë popujt të vendosur këtu, pesha dhe vlera e tyre për secilin popull veç e veç është krejtësisht e ndryshme. Mbyllja në historiografitë nacionale dhe posaçërisht mitet nacionale të konstruktuara gjatë shekullit XIX, kanë vendosur kufij më të fortë për komunikimin e brendshëm në Ballkan se kufijtë politikë të Luftës së Ftohtë ose të sistemit të tashëm të vizave.


Mitet nacionale çelës, si:

- miti serb i Kosovës
- miti mesjetar kroat shtetformues e nacional
- mosmposhtja dhe burrëria malazeze
- fugjtë imperiale të shtetit mesjetar bullgar

- superioriteti intelektual i grekëve, të cilët e themelojnë identitetin e tyre mbi trashëgiminë e drejtpërdrejtë të vlerave të Greqisë antike
- lidhjet e maqedonëve bashkëkohorë me shtetin dhe territorin nga koha e Filipit dhe Aleksandrit të Maqedonisë (dielli nga Vergina në flamurin bashkëkohor maqedon)
- miti boshnjak mbi krijimin e kombit

i kontribuojnë mbijetesës së paragjykimeve të shumta nationale (etnike) – ndjenjës për drejtësinë qellore të serbëve, për respektimin e të drejtave të vjetra te kroatët, për kodeksin e pacuneshëm të nderit te malazezët etj., po njëkohësisht edhe të paragjykimeve të shumta ndaj popujve të tjerë në fqinjësi, si popuj "pa histori", pa trimëri, krenari, nder, etj. Që këndej, nuk është çudi pse praktikisht nuk kemi heronj historikë të përbashkët dhe, natyrisht, ndaj heronjve dhe vlerave "të huaja" që ata i mishërojnë ne thellësisht distancohemi. Përjashtim në këtë sens është Sibinjanin Janko (Janos Hunyadi,...), po deri diku edhe Marko Kraleviq, të cilët te disa komunitete etnike trajtohen si heronj të tyre. Është interesant fakti se madje edhe brenda komuniteteve nationale vazhdimisht bëhet rivlerësimi i person-aliteteve historike, kështu që riemërtimi i rrugëve ose rrënimi dhe ndërtimi i sër-ishëm i përmendoreve të "heronjve nacionalë" janë më tepër rregull se përjashtim.

Njëkohësisht, zakonet dhe jetën e përditshme të njerëzve në këtë region i karakterizojnë në një masë më të madhe njashmëritë sesa dallimet: vlerësimi i lartë i vlerave familjare, mënyra e rritjes së fëmijëve, relacionet midis gjeneratash, relacionet midis gjinive dhe rolet e burrit dhe gruas, si dhe kultura e jetesës: mënyra e banimit, mënyra e të ushqyerit, mënyra e shoqërimit dhe e dëfrimit, gjer te rapporti ndaj punës. Këto domene i karakterizojnë, kështu, vlera dhe tipare të njëjta. Kështu, për shembull, komunikimi ndërnjerëzor zhvillohet para së gjithash brenda



Antun Maraciq, Përbajtjet e zhdukura 1991-1994, Ozalska 30, Zagreb, 1994.

Përshkrimi: Pas përfundimit të vitit të parë të luftës, në vitin 1991, Antun Maraciq filloi në Zagreb me regjistrimet e kornizave të zbrazura, në fasadat ku më parë ishin të vendosura pllakat që shënonin veprimtarinë e dikujt: një agjencie për pasuri të paluajtshme, një kancelarie avokature, tregtie... Në vargun e ndryshimeve të shpejta që ndodhnin duke sjellë gjithmonë ndonjë situatë të re, ai punën e vet, në mënyrë inverze, e fokusonte te zhdukja e atyre të mëparshmeve. E botuar me lejen e autorit. Vërejtje: Ruga Ozalska, në të cilën është gjiruar kjo kornizë e zbrazur më parë quhej Rrugë Rade Konçar.

grupesh më të mëdha dhe e thekson ndarjen kolektive të vlerave dhe identitetin kolektiv (shoqërimi brenda rrethit farefisnor – tribalizmi, banorët e fshatit – afërsia fqinjësore, dashamirët e sportit – tifozët, aktivizmi politik – bashkëmendimtarët...). Në të njëjtën kohë, ekziston mostoleranca ndaj të gjithë personave me individualitet të theksuar, prej të cilëve pritet që t'i ndrydhin ose të paktën të mos i shprehin nevojat, shprehitë dhe dëshirat e tyre specifike.

**UDHËZIME METODOLOGJIKE PËR PUNË
DHE EDUKIM NË KOMUNIKIMIN INTERKULTUROR**

Qëllimet:

- të njihet kompleksiteti i identiteteve kulturore ballkanike
- ndërgjegjësimi për ekzistencën dhe ndikimin e paragjykimeve dhe stereotipave të ndryshëm ndërretnikë
 - përvetësimi i mjeshtërive komunikuese në kontekstin multikulturor
 - njohja e vlerave të tjerëve dhe zhvillimi i tolerancës
 - të shquhen tek identiteti vetjak elementet e identitetit të tjetrit (overlapping identities)

Metodat dhe qëllimet:

Detyrat individuale në kontekstn lokal:

1. Cekini të gjithë stereotipat që i dini për popujt dhe kulturat e Ballkanit! Pse mendoni të jenë krijuar ata dhe çfarë është veprimi dhe ndikimi i tyre sot? Si të tejkalojen?
2. Cilën ngjarje historike e konsideroni relevante për historinë tuaj nationale, ndërsa të jetë e një rëndësie themelore, pozitive a negative, edhe për popuj të tjerë ballkanikë? Shpjegojeni arsyen!
3. Cilat zakone dhe vlera i keni të përbashkëta me pjesën më të madhe të banorëve të Ballkanit?

- A është e mundshme të shtrohet sofra tipike ballkanike?
- Çfarë është tipi i shoqërimit në Ballkan (hapësira, koha, rolet...)?

4. Cekini tri fjalët çelës që e simbolizojnë çonjëren nga kulturat nacionale ballkanike.

Udhëzim për udhëheqësin e punëtorisë:

Pjesëmarrësit përgjigjen me shkrim në mënyrë të pavarur, ose në trajtë brainstorming-u. Pjesa e dytë e sesionit nënkupton analizën e përgjigjeve dominuese. Pjesa përfundimtare e punëtorisë përpiqet të zbulojë shkaqet e paragjykimeve dhe moskuptimeve nëse identifikohen nëpërmjet përgjigjeve, duke theksuar argumentimin, mënyrën dhe tonin e të folurit për problemet, si dhe atmosferën e përgjithshme.

Detyrat e grupeve interkulturore (konteksti regional):

Inskenimi dhe simulimi

1. Organizojeni një projekt punëtorie dramatike, në të cilën do të zgjidhet një çështje ose një problem që shkakton mosmarrëveshje interkulturore, ashtu që pjesëmarrësit do të luajnë rolet e grupeve etnike të tjera. Një situatë e imagjinuar do të ishte, fjala vjen, themelimi i teatrit në një mjedis multietnik dhe inskenimi i pjesës së parë. Si do të quhet teatri? Çfarë repertori do të ketë? Me cilën shfaqje do të hapet teatri? Ku do të mbahen shfaqjet mysafire dhe cilat shfaqje? Prej nga vjen regjisori-mysafir?
2. Zgjedheni një problem aktual dhe përpiquni që me ndarjen e roleve (ministri, akterët e ngjarjeve, pushteti lokal, etj.) të ofroni vizione për zgjidhjet e mundshme

të konfliktit interkulturor. Problemi mund të jetë i lidhur me: festat/manifestimet tradicionale të një grupei etnik, ngritja e përmendores së një personaliteti që është kontraverz nga pikëpamja e grupeve të ndryshme etnike, etj.

Puna me artefaktet

1. Analizojeni fotografinë e dhënë si një shembull të urbanitetit multikulturor. A mund ta regjistroni në mjedisin tuaj një fotografi me përbajtje të ngjashme? Çfarë do të paraqiste ajo dhe pse? (Mund të organizohet edhe një foto sesion i "zbulimit të elementeve multikulturore të qytetit" në vendin ku zhvillohet punëtoria. Punëtoria mund të realizohet nëpërmjet shkrimit të eseve ose nëpërmjet debatit duke marrë për bazë fotografitë).

Debatet

1. Lexojeni tregimin e Ivo Andriqit "Letër e vitit 1920", si dhe "Letra e dytë e vitit 1920" e autorit Muharem Bazdul, ose tregimin e Irfan Horozoviqit "Demi boshnjak" në relacion me "Plepi" i Petar Koçiqit. Shpjegojini dallimet përbajtësore që theksohen në këto vepra, por që e prekin temën e marrëdhënieve interkulturore.

2. Përvojat e paragjykimeve dhe moskuptimeve interkulturore. Punëtoria fillon me një rrëfim nga përjetimi/përvoja personale.

Nacionet çelës:

Multikulturaliteti – njojja dhe ruajtja e një shumësie kulturash dhe tipareve të tyre në një hapësirë, si dhe sigurimi i mundësive të njëjtë kulturore e shoqërore për se cilën sosh.



Foto : Astrit Ibrahim

Interkulturaliteti – relacion dinamik, bartja dhe shkëmbimi i vlerave kulturore, si dhe veprimi reciprok i kulturave të ndryshme dhe përfaqësuesve të tyre mbi njërit-tjetrin.

Mediacioni (Ndërmjetësimi) – ndërmjetësimi në dialogun interkulturor nëpërmjet aktivizmit artistik, programeve të animacionit socio-kulturor, projekteve mediale. Mund të shenojë edhe përkthimin e vlerave, ideve dhe mesazheve të realizura në formë të ndryshme kulturore dhe artistike në një gjuhë të afërt me një grup shoqëror dhe opinionin e gjerë.

Stereotipi – marrja e një bashkësie lehtësisht të kuptueshme të karakteristikave a veçantive, të cilat konsiderohet se i përkasin një grupei, prej nga pastaj krijohet një cilësi dalluese reprezentative që i veshet tërë grupit.

Stigma – tipar negativ ose bashkësi karakteristikash negative që i veshen një individi ose grupi dhe që shkaktojnë izolim ose përjashtim më të madh a më të vogël social dhe kulturor. Stigmat mund të jenë fizike, materiale ose simbolike dhe përfaqësojnë bazën e mungesës së komunikimit interkulturor. Në momente dhe mjedise të caktuara mund të stigmatizohen edhe popuj të tërë.

Identiteti kulturor – vetëdija kolektive dhe ndjenja e përkatësisë e bazuar te njojha e disa përcaktuesve të përbashkët (gjuha, raca, territori, religjioni, zakonet...), të cilët në situatën e dhënë përfaqësojnë bazën e identifikimit.

Miti – gojëdhënë ose një varg rrëfimesh të cilave u besohet, po që shprehin përfytyrimet kolektive që nuk i nënshtrohen verifikimit shkencor. Mitet gjenden në themel të konstruksionit të identiteteve kolektive, veçanërisht atyre nationale, sepse reprezentojnë vlera, besime, marrëdhënie dhe synime të përhershme të anëtarëve të komunitetit.

Simboli – në komunikimin interkulturor është më së shpeshti një figurë, personalitet, ngjarje ose tekst, i cili nuk shenjon pikë së pari atë që e paraqet, por kulturën brenda së cilës është krijuar, dhe kështu përfaqëson një element të identifikimit individual a grupor. Simbole të caktuara janë pranuar zyrtarisht si reprezentë të identitetit nacional (shqiponja e zezë në fushë të kuqe – simboli shqiptar), ndërsa të tjerët marrin domethënien e simbolit në mënyrë spontane në procesin e komunikimit publik (fesi, si shenjë dalluese e popullatës boshnjake, opinga – e asaj serbe etj.).

Artefakti – është një objekt, produkt i punës njerëzore, i cili mund të përfaqësojë edhe një identifikues kulturor, nëse në vete sintetizon përvojat e stilit specifik të jetës dhe mënyrës së prodhimit. Në historinë e kulturës dhe civilizimit është i tillë çdo objekt artistik ose i formësuar artificialisht, ndërsa në historinë e artit është ai objekt material që ushton mbi ne një efekt estetik.

Literatura:

Marija Todorova. *Imaginarni Balkan (Ballkani imaginari)*. XX vek, Beograd, 1999.

Trajan Stojanovic. *Balkanski svetovi, prva i poslednja Evropa (Botët ballkanike, Evropa e parë dhe e fundit)*.

Equilibrium, Beograd, 1997.

Sanjin Dragojevic. *Multikulturalizam, interkulturalizam, transkulturalizam, plurikulturalizam: supratstavljeni ili nadopunuju? i koncepti (Multikulturalizmi, interkulturalizmi, transkulturalizmi, plurikulturalizmi: koncepte të kundërvëna a përplatësuse)*. Te: Kultura, etnicnost, identitet (Jadranka Cacic-Kumpes, ur.). Institut za migracije i narodnosti; Jesenski i Turk, Zagreb, 2000.

POLITIKA KULTURORE DHE ZHVILLIMI KULTUROR

PSE BOSNJA E HERCEGOVINA NUK KA NJË POLITIKË KULTURORE SHTETËRORE?

Procesi i harmonizimit dhe i miratimit të qëllimeve të politikës kulturore, njësoj edhe definimi i funksionimit të saj në nivel të shtetit në tërësi mund të konsiderohet, pa dyshim, si një tip tepër kompleks i medacionit kulturor. Kjo është më se e saktë në rastin e Bosnjës e Hercegovinës, sepse: "Nuk ekziston një vend tjetër në Evropë ku politika kulturore ka më tepër rëndësi. Kultura është në të njëjtën kohë edhe burim edhe zgjidhje e problemeve. Zënkat kulturore janë shfrytëzuar për ndarjen e vendit. Megjithatë, kultura do të mund ta bashkonte përsëri popullin nëpërmjet iniciimit të programeve dhe aktivitetave kulturore për zhvillimin e mirëkuptimit të ndërsjellë" (Charles Landry, Raporti i ekspertëve, Këshilli i Evropës, 2002.).

Politika kulturore mund të përfaqësojë kështu, potentialisht, një mjet me të cilin akterë nga më të ndryshmit nga skena kulturore dhe zhvillimi shoqëror vendosin një dialog qëllimor, konstruktiv dhe të përshtatshëm. Me të mund të arrihet përbashkësia në dallime, çka përfaqëson jo vetëm qëllimin më të rëndësishëm të të gjithë zhvillimit kulturor të vendit, por edhe parakushtin e mbijetesës së përhershme të tij, po edhe të vendosjes së komunikimit interkulturor të përditshëm. Në këtë sens, mund të thuhet se mosekzistenza e një politike kulturore shtetërore, gjithëpërfshirëse dhe aktive, është një shenjë serioze e pamundësisë së autoriteteve çelës për ta konsoliduar jetën kulturore të vendit, dhe kështu ndarjet t'i tejkalojnë me bashkëpunim. Pasojat janë, gjithsesi, tepër serioze.



COUNCIL
OF EUROPE CONSEIL
DE L'EUROPE

Një rast për studim: Programi i vlerësimit të politikave kulturore të Këshillit të Evropës, në të cilin janë përfshirë deri tani më shumë se 20 vende, nânkupton një varg veprimtarish të ndërvarura dhe të zbatuara detalishët: diagnostikimi i bazës analitike dhe shkencore-hulumtuese të politikës kulturore të një vendi; mundësia e formimit të një ekipi ekspertësh vendas për analizën e saj, si nga pikëpamja e qëllimeve dhe prioriteteve, ashtu edhe nga pikëpamja e instrumenteve dhe masave themelore; analizën sipas sektorëve të fushave kulturore të veçanta; organizimin e një varg takimash të drejtpërdrejtë të ekspertëve të Këshillit të Evropës me akterët dhe autoritetet kulturore lokale në të gjitha nivelet dhe fushat kulturore, etj. Për projektin e plotë të evaluimit të politikës kulturore të një vendi rezultati më i rëndësishëm janë dy publikime që prezantohen dhe arsytohen publikisht në Strasbourg – selinë e kësaj organizate më evropiane të kontinentit – mu para përfaqësuesve të përhershëm të Komitetit për Kulturë të të gjitha vendeve-anëtare. Publikimi i parë është Raporti Shtetëror për Politikën Kulturore, të cilin e përpilon vetë vendi dhe përfaqëson analizën e gjendjes; ndërsa publikimi i dytë është Raporti i Ekspertëve të Pavarur të Këshillit të Evropës për një vend, i cili e ka karakterin dhe domethënien e evaluimit të saj. Bosnja dhe Hercegovina është vendi i parë që u obligua të përpilojë Raportin Shtetëror, por nuk e bëri këtë përkundër shumë përpjekjeve. Madje, edhe vetë përpjekja përfshi strukturat e tij kornizë më të vrashta, në nivelin shtetëror si tërësi, ka shkaktuar rezistenca dhe kundërshtime të fuqishme që e paralizuan një herë e mirë tërë projektin. Megjithatë, në mbledhjen publike të mbajtur në Strasbourg më 11 tetor të vitit 2002 – e cila i kushtohej vetëm prezentimit të Raportit të Ekspertëve (të autorit Charles Landry) dhe jo, përfat të keq, edhe të atij shtetëror – delegacioni zyrtar i Bosnjës e Hercegovinës premtoi edhe një herë se do ta përmblushë obligimin të nënshkruar edhe me kontratë, si një detyrë prioritare për tërë lëminë e kulturës në gjithë hapësirën e vendit. Më gjëresisht përfshin:

www.coe.int

Për shkak të fragmentarizimit të përgjithshëm, mosekzistimit të koordinimit dhe bashkëpunimit brenda rregullimit politik të tashëm, vetëm ata më të informuarit, të cilët janë shumë të paktë në numër, e dinë se si funksionon sistemi si tërësi, nëse funksionon fare si i tillë. Që këndej edhe mungesa e ekspertëve, para së gjithash në çështjet juridike dhe financiare. Një çështje tepër e vështirë është ajo që ka të bëjë me numrin, detyrat, veprimtaritë, si dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve kulturore shtetërore të rëndësishme për të tre popujt konstitutivë në vend, si dhe çështja e kompetencave të autoriteteve publike mbi to. Rreth efekteve sistemore dhe strategjike të politikës kulturore të shtetit as që mund të flitet fare, ndërsa për të njëjtat efekte në nivelin subshtetëror (i cili, të jemi objektivë, është i vetmi që i ka autorizimet dhe resurset për zbatimin e politikës kulturore) nuk ka as të dhëna, as tregues, as që bëhet ndonjë formë e evaluimit.

Aktualisht, përpjekjet dhe pjesa më e madhe e resurseve në nivel vendi janë të orientuara te rikonstruktimi dhe ruajtja e infrastrukturës ekzistuese dhe trashëgimisë kulturore, ndërsa puna për zhvillimin dhe ridefinimin e roleve, si të veprimtarive kulturore ashtu edhe të institucioneve dhe organizatave kulturore, është lënë anash. Me këtë, për fat të keq, mjetet edhe ashtu modeste për zhvillimin kulturor nuk investohen në programe dhe projekte themelore, të cilat për një kohë të shkurtër do t'i kontribuonin rritjes së kualitetit të jetës dhe komunikimit në tërë hapësirën e Bosnjës e Hercegovinës. Fusha që konsiderohet si kulturë pikë së pari ka të bëjë me të ashtuquajturin art i lartë, ndërsa spektri i gjërë i kulturës popullore dhe bashkëkohore, njësoj edhe potenciali i saj social, ekonomik dhe turistik, nënvlerësohet, ç'gjë i kontribuon vlerësimit të ulët të rolit të kulturës përgjithësisht. Për më tepër, me këtë ajo bëhet mjet i rritjes së distancës sociale midis pjesëtarëve të grupeve etnike të ndryshme, po mjaft shpesh edhe një argument për mungesën e çdo komunikimi, përveç se ndoshta atij më të nevojshmit.

KOMUNIKIMI INTERKULTUROR DHE PROCESI I KONCEPTIMIT DHE MIRATIMIT TË POLITIKËS KULTURORE (SHTETËRORE)

Fakti që në nivel shtetëror nuk ekziston ministria e kulturës, edhe pse përfaqëson pa dyshim një rrethanë vështirësuese në përpjekjet për definimin e politikës kulturore, me një aksion të koordinuar dhe të menduar mirë ky fakt mund të shndërrohet në përparësi. Krijimi i mundshëm i saj mund të nisë ashtu me hapjëm e debateve të gjera dhe të një dialogu të hapur rreth sistemit të përgjithshëm kulturore të vendit në të ardhmen, për qëllimet dhe prioritetet e jetës dhe të zhvillimit kulturore, njësoj edhe për masat dhe instrumentet e dëshirueshme dhe produktive të politikës kulturore. Në këtë mënyrë sistemi/et tanimë ekzistues/e mund të transformohen në një mënyrë më të lehtë, graduale dhe pa dhembje, ndërsa veprimi i përgjithshëm i politikës kulturore shtetërore dhe të tjerave mund të shtronhet, koordinohet dhe të harmonizohet në mënyrë strategjike.

Fundja, kjo është mënyra e vetme që në tërë territorin e vendit, të paktën për një kohë më të shkurtër a pak më të gjatë, të mundësohen dhe respektohen të drejtat kulturore, si të drejta themelore të njeriut, me të cilat çdo qytetari i garantohet qasja te përbajtjet kulturore dhe mundësia e shprehjes kreative të ideve, nevojave dhe identitetit kulturor vetjak.

Si kornizë relevante dhe e mundshme e vendosjes së politikës kulturore në nivel shteti mund të shërbejë, pa kurrrafë dyshimi, Raporti i Ekspertëve: Politika Kulturore në Bosnjë e Hercegovinë, i bërë në kuadër të projektit të Evaluimit të Politikave Kulturore Nacionale të Këshillit të Evropës. Ky dokument është sajuar në bazë të nxitjeve dhe dëshirës së shprehur nga Qeveria e Bosnjës e Hercegovinës dhe, si në rastin e vendeve të tjera, përfaqëson një si obligim në sensin e diskutimit dhe zbatimit për pushtetet kulturore të vendit. Qëllimi i dokumentit është

zbatues, d.m.th., me të diagnostifikohen jo vetëm problemet dhe mangësitë çelës, por propozohen edhe qëllime dhe masa konkrete të politikës kulturore në të ardhmen. Kështu, janë propozuar tri rrugë për arritjen e një ardhmërie kreative në trajtën e tri programeve për veprim, të cilat vetveti mund të konsiderohen prioritetë të politikës kulturore:

T'u jepet shpresë të rindje

Ndjenja e përkatësisë: agjenda interkulturore

Bosna e Hercegovina kreative: strategjia e realizimit të potencialeve të industrive kulturore.

Në kuadër të programit të parë: T'u jepet shpresë të rindje, theksohet dobësia e qendrave kulturore ekzistuese, roli dhe funksioni i të cilave do duhej të rishikohej. Ato do të bëhen vende që ofrojnë mësim "sy më sy", me mundësinë e shndërrimit në qendra virtuale si "aula qyteti", ose thjesht do bëhen qendra të aktivitetit shoqëror dhe politik. Një theks i veçantë është vënë te zhvillimi i resurseve artistike e mediale, ku bën pjesë hapja e studios për film, sallave për prova, ateliieve artistike, dhe krijimi i resurseve multimediale. Pastaj, themelimi i një qendre kryesore për inteligjencinë civile dhe kreative, si një vendtakim i kapitalit intelektual me njerëz të rindje, si udhëheqës të projekteve. Një qendër e këtillë do të fuqizohej me bashkimin e iniciativave të tjera të ngjashme nga gjithë BeH dhe regjioni nëpërmjet rrjeteve dhe forumeve të debatit.

Nga pikëpamja e këtij doracaku, programi i dytë që përmendet në dokumentin e Keshillit të Evropës është i një rëndësie të veçantë, sepse e thekson ndërtimin e ndjenjës së qytetarisë unike në Bosnje e Hercegovinë nëpërmjet mbështetjes së projekteve interkulturore. Rolin kryesor do të mund ta merrte rrjeti ekzistues dhe i ardhshëm i bibliotekave, por edhe organizatat e shumta joqeveritare, dhe pikërisht me aktivitetet vijuese:

Fushatat publike (bilbordet, posterët, debatet, etj.) për pranimin e definicionit vetjak të identitetit boshnjak-hercegovas dhe të identitetit të qytetarëve të saj, si dhe formave dhe mënyrave të shprehjes dhe njohjes së tyre;

Projektet interkulturore, siç janë ekspozitat historike-dokumentare, këshillimet dhe projektet hulumtuese;

Krijimin e institucioneve të reja interkulturore si: foto dhe audio arkivat, hapësirës ekspozuese, teatrit interkulturor, etj.

Me programin e tretë Bosna e Hercegovina Kreative do të krijojeshin parakushtet për shfrytëzimin maksimal të potencialeve të industrive kulturore. Në këtë sens është propozuar krijimi i Fondit për Veprimtarit Botuese, si dhe instalimi i një mbështetjeje të veçantë për zhvillimin e projekteve interdisiplinare dhe multimediale.

**POLITIKA KULTURORE, SI MJET I MEDIACIONIT INTERKULTUROR:
QËLLIMET METODIKE DHE DETYRAT E PUNËS**

Qëllimet:

të zhvillohet nevoja përfshirjen e organizatave joqeveritare, grupeve dhe individëve në procesin e konceptimit dhe definimit të politikës kulturore në të gjitha nivelet

të pozicionohen organizatat joqeveritare në pikëpamje të veprimit të tyre konkret participues në këtë fushë

të zhvillohet vetëdija përendësinë e bashkëpunimit, partneritetit dhe krijimit të rrjeteve me qëllim të veprimit të njëkohshëm dhe gjithëpërfshiës të sektorit joprofitabil, në radhë të parë ndaj autoritetet publike

të inicohet zbatimi i projekteve, të cilat mund ta dinamizojnë dhe transformojnë jetën kulturore të vendit, po ashtu edhe të vendosen themellet për një tip të ri vendimmarrjeje në kulturë

Detyrat:

Përpinquni ta bëni një paraqitje grafike të relacioneve midis subjekteve të politikës kulturore në Bosnjë e Hercegovinë. Në mënyrë të veçantë theksojeni nivelin dhe subjektet që për ju janë relevante, po ashtu shpjegojini arsyet.

Propozojini mënyrat dhe format e veprimit (propagandimi, lobimi, organizimi i debateve publike e të ngjashme) tuaj dhe të organizatës suaj me qëllim të definimit të politikës kulturore në të gjitha nivelet që i konsideroni të rëndësishme.

Parashtrojeni idenë për një projekt të mundshëm që organizata juaj do të mund ta realizonte në njërin nga tri programet e ofruara nga Këshilli i Evropës.

Fjalët çelës:

Politika kulturore është rregullim i ndërgjegjshëm i interesave në fushë të kulturës dhe vendimmarrjes për të gjitha çështjet të ndërlidhura me zhvillimin kulturor të një komuniteti shoqëror. Shfaqet në trajtë të trefishtë:

nëpërmjet premisave teorike dhe definimit të kompetencave (zakonisht janë këto: krijimtaria artistike e kulturore; trashëgimia kulturore dhe participimi, d.m.th. sa janë në dispozicion të popullatës të mirat dhe praktika kulturore)

nëpërmjet qëllimeve dhe detyrave të defnuara saktë të politikës kulturore, dhe nëpërmjet sistemit të metodave dhe instrumenteve për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të politikës kulturore.

Instrumentet e politikës kulturore janë legjislationi, mekanizmat financiarë dhe planifikimi i veprimtarive kulturore.

Masat e politikës kulturore përfaqësojnë formë konkrete veprimi që rrjedhin nga instrumente të caktuara. P.sh., mekanizmat financiarë, siç janë blerja, shpërblimi, stimulimi e të ngjashme, përfaqësojnë një mënyrë shfrytëzimi të këtij instrumenti të politikës kulturore.

Zhvillimi kulturor është shfrytëzim i tërësishëm i potencialeve të një komuniteti me qëllim të rritjes së kualitetit të krijimtarisë artistike, për mbrojtjen sa më të mirë të të mirave kulturore, si dhe ngritjen e nivelit të përgjithshëm të jetës kulturore, por duke i respektuar specifikat e nevojave dhe shprehive kulturore të individëve dhe grupeve.

Të drejtat kulturore janë pjesë e të dejtave të njeriut dhe mund të kuptohen edhe si të drejta individuale edhe si grupore, ato presupozojnë pjesëmarrje të lirë në

jetën kulturore, duke i respektuar traditat nationale dhe traditat e tjera kolektive, të gjuhës së tyre dhe preferencave (parapëlqimeve) individuale. Ato njëkohësisht shënojnë edhe obligimin e shtetit që të mundësojë kushtet institucionale për praktikat kulturore të grupeve minoritare.

Kështu, të drejtat kulturore e përfshijnë në vete luftën për arsimim gjithëkulturor dhe të drejtën për arsimin fillor, posaçërisht për gratë; luftën për mundësinë e krijimit në gjuhën e grupit të vet etnik dhe në kuadër të traditave kulturore të grupit të dhëni, gjithnjë deri te lufta për mundësinë e shprehjes së lirë kreative, të papenguar nga kanonet, barrierat ideologjike, paragjykimet fetare.

Industritë kulturore përfshijnë: veprimtarinë botuese dhe veprimtarinë botuese të muzikës, sektorin audiovizuel medial dhe filmin, disenjin dhe modën, përfshirë aty edhe turizmin kulturor. Këto janë, pra, të gjitha ato veprimtari që realizohen nëpërmjet produktit që mund të multiplikohet (shumëfishohet).

Literatura

Charles Landry. *Kulturna politika u Bosni i Hercegovini: Ekspertni izveštaj. Zajedništvo u razlikama: Kultura na raskräsnici u Bosni i Hercegovini. Vijeće Europe, Strasbourg, 2002.* (Charles Landry. *Politika kulturore në Bosnje e Hercegovinë: Raporti i ekspertëve. Uniteti në dollime: Kultura në udhëkryq në Bosnje e Hercegovinë. Këshilli i Evropës, Strasbourg, 2002*).

Vojin Dimitrijević et al. *Kulturna prava. Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999.* (Vojin Dimitrijević et al. *Të drejtat kulturore. Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Beograd, 1999*).
Javne i kultume politike (zbornik, ur. Milena Dragičević Šešić?). PALGO centar, Beograd, 2002. (Politikat publike dhe kulturore /përmëledhje punimesh. Red. Milena Dragičević Šešić/, Qendra PALGO, Beograd, 2002).

SEKTORI CIVIL DHE ROLI I TIJ NË JETËN KULTURORE

TRE SEKTORË NË ZHVILLIMIN KULTUROR

Të gjitha shoqëritë e zhvilluara perëndimore i kanë njësoj të zhvilluar tre sektorët, të cilët funksionojnë në ndërveprim, sepse secili prej tyre nxit, mbështet dhe kryen detyra shoqërore të ndryshme. Në vendet e ish-Jugosllavisë, të cilat gjatë viteve nëntëdhjetë kaluan nëpër luftë dhe shkatërrime lufte, ndodhi një rrënëm i njëkohshëm si i sektorit publik (shtetit), ashtu edhe i ekonomisë, përderisa sektori i tretë – sektori i vetorganizimit qytetar pësoi ndryshime tepër të mëdha dhe një ristrukturim tërësor. Kështu, sistemi i bashkësive kulturore-arsimore, të cilat i tubonin intelektualët, artistët dhe aktivistët e kulturës në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë, në vitet nëntëdhjetë gati e ndërprenë punën, ndërkaoq u formuan organizata joqeveritare të tjera, të shumta, por pa lidhje me njëra-tjetrën, të cilat, të paktën pjesërisht, i morën rolet e lobimit, organizimit dhe angazhimit për debate publike rreth problemeve të kulturës.

Për ta kuptuar pozitën dhe rëndësinë e sektorit “të tretë” është e domosdoshme që të definohet më parë roli dhe funksioni i dy të parëve.

Institucionet e sektorit publik përfaqësojnë në të gjitha vendet evropiane bartësit themelorë të politikës kulturore dhe implementimit të qëllimeve dhe prioriteteve të saj. Ato njëkohësisht përfaqësojnë edhe pjesën më të rëndësishme të infrastrukturës kulturore, pa të cilën nuk mund të ekzistojë një jetë kulturore e zhvilluar. Fjala është për një sektor me strukturë jashtëzakonisht të përdegezuar, e cila gjithnjë, në një masë më të madhe a më të vogël, funksionon si një sistem (funksionalisht) dhe si një rrjet (territorialisht). Kjo, shkurt, do të thoshte se sektorin publik të kulturës zakonisht e përbëjnë këto institucionë:

Parlamenti dhe Qeveria

Ministria e Kulturës dhe ministri të tjera të ngjashme (e shkencës, arsimit, turizmit, komunikimit, etj.), trupat dhe shërbimet e tyre profesionale

Institucionet e kulturës të një rëndësie shtetërore/nacionale

Institucionet e kulturës të rëndësishme për regjionet dhe qytetet

Institucionet e kulturës në nivelin komunal

Legjitimiteti i marrjes së vendimeve në sektorin publik rrjedh nga dy kriteret: ai zgjedhor (parlamenti, qeveria dhe ministrat) dhe ai profesional (këshillat, komisionet dhe komitetet e ministreve, si dhe menaxhmenti i institucioneve të kulturës).

Kornizat, dinamikën dhe funksionimin e tërë sistemit të kulturës në një masë të madhe e përcakton kualiteti i përgjithshëm dhe efikasiteti i sektorit publik. Dy sektorët tjerë mund t'i kontribuojnë zhvillimit të sistemit të kulturës vetëm nëse sektori publik është i konstituuar në mënyrë demokratike dhe stabile. Vetëm në këto kondita ata do të kenë edhe nxitje, edhe bashkëbisedues, edhe partnerë përmesimin e veprimitarisë së tyre, qoftë në drejtim të përfshirjes ose të ridefinimit të sistemit kulturor në tërsësi.

Sektori (i dytë) privat ka funksion të trefishtë. Ai krijon të ardhura dhe, duke paguar tatimet, e mbush buxhetin shtetëror nga i cili financohet kultura. Ai mund t'i ndihmojë me veticinativë projektet kulturore dhe institucionet nga arsyen filantropike (donacionet) ose afariste (sponsorizimi). I krijon edhe institucionet dhe programet kulturore të vetat, të tipit profitabil dhe joprofitabil, siç janë galeritë, teatrot, muzetë, fondacionet, etj. Në këtë domen më të shumtët në numër janë libraritë, si sipërmarrje afariste, siç është libraria Buybook në Sarajevë, ose kinematë multiplex në tërë territorin e Kroacisë. Më së paku ka projekte kulturore korporative, prej të cilave më të njohurat janë p.sh. Galeria “Miroslav Kraleviq” e

kompanisë INA në Zagreb, ose projektet e kompanisë Zepter nga Beograd: shtëpia botuese Zepter BOOK World, si dhe libraria, galeria dhe Fondacioni "Madlena Janković" për mbështetjen e projekteve artistike.

Sektori i tretë, sektori joprofitabil ose shoqëria civile ka po ashtu tri funksione themelore. Ai garanton, mbron dhe e mundëson të drejtën e bashkimit të lirë të njerëzve rreth interesave të përbashkët: të tipit personal (p.sh. filatelistët) ose të tipit të përgjithshëm (shoqatat e ekologëve). Ai i promovon vlerat dhe idetë, parimet etike dhe politike, fut iniciativa të reja në sistemin kulturor ekzistues. Njëkohësisht, ai e kontrollon shkallën e realizimit të interesit publik në institucionet e sistemit dhe mënyrën e shpenzimit të mjeteve publike (sektori i parë), dhe kështë pjesërisht e ruan besimin e qytetarëve te shoqëria dhe institucionet e saj. (Si një shembull i rëndësishëm së parimeve etike e politike në veprimtarinë e një OJQ shih Deklaratën për Opinion të Institutit Multimedial të Zagrebit kundër luftës në Irak te Shtojca 7., në faqen 170, si dhe jehonën e saj në opinionin kroat dhe atë ndërkombëtar.)

Duke patur parasysh fushën jashtëzakonisht të gjerë të veprimit të shoqërisë civile, është e domosdoshme që ajo të vendosë lidhje të drejtpërdrejta dhe komunikimin me organizatat masmediale, me institucionet arsimore (posaçërisht me universitetet), institucionet fetare, organizatat ndërkombëtare dhe me shumë të tjera.

Edhe sektori i tretë strukturohet në mënyrë komplekse. E përbëjnë:

Shoqatat e qytetarëve të bashkuar rreth interesave të përbashkët: shoqatat e hobia, shoqatat e lobimit (invalidët e luftës, prindërit e nxënësve, dhe të ngjashme)

Organizatat joqeveritare (shoqatat aktiviste dhe lëvizjet shoqërore, të cilat e mbrojnë interesin publik, siç janë shoqatat ekologjike, kulturore, minoritare, lëvizja antiglobaliste, etj.)

policiesforculture.org Policy Resources for Culture in South East Europe

info

ABOUT US
OUR TEAM
OUR NETWORK
FEEDBACK

action projects

GRANT MAP - SEE
PROJECTS IN SE
BEYOND SEE

research

TALK FORCE
SYMPOSIUM
FORUM

publications

D-PERIODICAL
PRINTED EDITION
DOWNLOADED

e-library

ARTICLES & REPORTS
LINKS

Një rast për studim: Programi Policies for Culture është një program regional partneriteti i nisur në vitin 2000 me iniciativën e Fondacionit Kulturor Evropian (Amsterdam) dhe të organizatës joqeveritare ECUMEST (Bukuresht). Ai nënkupton vendosjen e marrëdhënieve midis organizatave të shoqërisë civile, Ministrisë së Kulturës (organeve ekzekutive të pushtetit publik) dhe Parlamentit (pushtetit legjislativ) rreth konceptimit të modelit të vendimmarrjes në kulturë dhe strategjive të politikës kulturore, ç'gjë e simbolizon edhe shenja e logos së projektit në tërësi. Programi bazohet mbi presupozimin se politika kulturore mund tă jetë efektive dhe efikase vetëm nëse edhe sektori civil merr pjesë në krijimin e saj. Në shtete të ndryshme programi ka mbështetur krijimin e intrumenteve të ndryshme të politikës kulturore: në Bullgari decentralizimin, në Rumania politikën kulturore regionale, në Kroaci e Serbi proceset e krimjimit të strategjive të zhvillimit kulturor të qyteteve, etj.

Organizatat profesionale, klasore (shoqatat e artistëve, muzeologëve, bibliotekistëve...)

Shoqatat që funksionojnë si organizata kulturore e artistike

Shoqatat mirëbërëse, fondacionet, themelatat testamentare (të cilat themelohen brenda sektorit të tretë, me iniciativën e qytetarëve)

Shteti, respektivisht sektori publik, duhet që në mënyrë sistematike të krijojë kushte për një zhvillim të volitshëm të sektorit civil nëpërmjet instrumenteve gjegjëse dhe mekanizmave të politikës kulturore (legjislacionit, lehtësimeve financiare, etj.). Por, është detyrë e vet sektorit civil që të zhvillojë programet dhe iniciativat vetjake të veprimit, dhe që me kualitetin e punës së tij të sigurojë një vend për veten dhe ndikimin në shoqëri.

I një rëndësie të veçantë është vendi i sektorit civil në sistemin e kulturës, si segment i opinionit publik kritik, si bartës i iniciativave për pluralizimin e skenës kulturore, posaçërisht në mjeshtërinë e komunikimit dhe te të cilat ka humbur besimi reciprok midis komuniteteve të ndryshme.

Për arsy se në sistemin e mëparshëm shteti e kishte marrë mbi vete vendimtarjen rrith formave dhe trajtave të solidaritetit (programet sociale, banesat e solidaritetit, mëditjet e solidaritetit, aksionet e punës, etj.), institucioni i solidaritetit qytetar nuk është zhvilluar, po edhe sot e gjithë ditën përgjegjësia për zgjidhjen e çështjeve më të vështira në sferën socio-kulturore hedhet te shteti dhe pritet që ai t'i gjejë instrumentet dhe zgjidhjet adekuate.

Po bëhen përpjekje graduale që kjo mungesë veticinitiative e qytetarit, si individ, të tekalohet me punën e organizatave joqeveritare të shumta të themeluara rishtas, të cilat fusin në këtë hapësirë aktivizmin social dhe idetë e përgjegjësisë për orientimin e ndryshimeve shoqërore. Shumë nga ato janë krijuar me iniciativën e sektorit civil të Evropës Perëndimore (Instituti PRONI, Qendra Nansen Dialogu, Qendrat

për Artin Bashkëkohor – SCCA, qendrat mediale, etj.), sipas një modeli të dhënë që më parë, krahas me trajnimin e kuadrit "prijës" lokal.

Me rëndësi të theksuar në hapësirat e Evropës Juglindore janë pikërisht ato organizata joqeveritare që merren me proceset e pajtimit dhe vendosjen e mirëbesimit midis komuniteteve etnike të ndryshme nëpërmjet programesh të aktiviteteve socio-kulturore. Aq më parë që programet e këtilla mungojnë në sektorin publik, dhe përfaktin se ende nuk vërehen institucione të sistemit që do t'u përkushtohen këtyre çështjeve në mënyrë të gjithanshme dhe afatgjate. Nuk çudit, prandaj, pse pjesa më e madhe e organizatave joqeveritare në Bosnje e Hercegovinë veprojnë në këtë lëmi dhe shënojnë rezultate të admirueshme, madje edhe atëherë kur që në nismë janë themeluar në rend të parë për projekte artistike-kulturore (p.sh. MIFOC, Mostar).

Format e punës të këtyre organizatave joqeveritare janë jashtëzakonisht të llojullojshme dhe sillen që nga seminaret dhe konferencat, mbledhja dhe përhapja e informacioneve, deri tek organizimi i diskutimeve dhe debateve, ekspozitive, programave edukative dhe punëtorive, etj., por edhe të festivaleve tepër ambicioze, si ai që e organizon Qendra Nansen e Dialogut, e cila programet e veta të krijuimtarisë filmike ndërkombëtare i organizon jo vetëm brenda Bosnjës e Hercegovinës, por edhe nëpër disa qendra të vendeve fqinje (p.sh. në Zagreb, Osijek dhe Beograd).



Programi i Festivalit Filmik të Qendrës Nansen të Dialogut në Mostar

E enjte, 21.11.2002.

Qendra Muzikore Pavarotti

11:00 – 14:00

Çizmet e kuqe prej gome, Jasmina Zebaniq, BeH, 18min

Djaloshi që ngutej, Bilana Cakiq – Veseliq, Kroaci, 52min

Njeriu që e kishte ngatërruar shtëpinë me tunelin, Elmira Jukiq, BeH, 18min

A të kujtohet Sarajeva, Sead e Nihad Kresevlakoviq dhe Nedim Alirkadiq, BeH, 52min

Lidhja bosnjake në Kanada, Millan Triviq, Kanada, 42min

17:00 – 18:00

Alegria, Vlladimir Peroviq, Serbi, 11min

Mbrapa përpara, Jasmina Zebaniq, BeH, 9min

Kërcimi i trefishtë, Sërgjan Vuletiq, BeH, 16min

724, Dino Mustafiq, BeH, 22min

Shtëpia e sigurt, Kristian Miliq, Kroaci, 30min

Jeta prej Millutinit, Dejan Strika, BeH, 14min

Rrethoja ferrash, Anita Killi, Norvegji, 13min

Kinema "Croatia"

19:30 Hapja e festivalit

20:00 Rrethi i përsosur, Ademir Kenoviq, BeH/Francë, 108min

22:00 Fuçi e barotit, Goran Paskaleviq, Serbi, 100min

E premte, 22.11.2002.

Qendra Muzikore Pavarotti

11:00 – 14:30 h

Fusha e vdekjes?????????????????, Damir Çuçiç, Kroaci, 20min

Ikja nga Serbia, Slobodan Simojloviq, Serbi, 21min

Nuk është serbe të heshtësh, Dragan Galiq, BeH, 11min

Filmi i humbur, Marko Mamuziq, Serbi, 25min

Dofarë emrash për disa çamarrokë të mplakur, Filip Remunda, BeH, 39min

Kështjella, Zvonimir Juric, Kroaci, 28min

Jeta në ajër të pastër, Danko Volariq, Kroaci, 60min

15:30 – 18:30

Shihemi, Ivan Sallaj, Kroaci, 60min

Treni, Goran Kostiq, Serbi, 13min

Taxi, Marko Sopiq, Serbi, 8min

Ashensori, Marko Sopiq, Serbi, 14min

Natalia, Marko Sopiq, Serbi, 24min

Trojka, Millosh Gjukeliq, Serbi, 24min

Gandori – Gjahu i Nirdalës, Marko Sopiq, Serbi, 15min

Pazari i çuditshëm, Daniella Gogiq, BeH, 19min

Mostar sevdaja reunion, Pjetër Zhalica, BeH, 25min

Galeria "Kosaça" në Pallatin e Herceg Stjepan Kosaçës

14:00 Tavolinë e rrumbullakët "Gjuha filmike e autorëve në veprat që kanë të bëjnë me luftën"

Kinema "Croatia"

20:00 Qielli satelitët, Llukas Nolla, Kroaci, 90min

22:00 Tokë e askujt, Danis Tanoviq, Francë/Itali/Belgjikë/Sloveni, 108min

E shtunë, 23.11.2002.

Qendra Muzikore Pavarotti

10:00 – 11:30

Stuhia mbi Krainën, Bozhidar Knezheviq, Kroaci, 52min

Tensioni i lartë, voltazhi i dobët?, Erol Çollakoviq, Spanjë, 25min

Drejt e deri në fund, Goran Kulenoviq, Kroaci, 30min

12:00 – 13:00 Programi përfëmijë i filmave të vizatuar

Muno, Bouli Lanners, Belgjikë, 20min

On the road, Marko Simiq, Çeki, 23min

Duck children, Sam Walker, UK, 8min

Anty Cryst, Adam Guzinski, Poloni, 25min

Jackyl&Hyde, Paul Bush, UK, 12min

Cry for Bobo, David Chaims, UK, 9min

Che Guevara, Eric Gandini, Suedi, 59min

17:00 Shihemi, Ivan Salaj, Kroaci, 60min

18:00 – 18:30 Ushtrimet e gjirimeve të FAMU, 30min

19:00 – 20:30

Shtëpia, Andriana Stojkoviq, Serbi, 8min

Muzeu punon vetëm në festat shtetërore, Andriana Stojkoviq, Serbi, 80min

Kinema "Croatia"

16:00 Mareshali, Vinko Breshan, Kroaci, 97min

18:00 Serbia në vitin zero, Goran Markoviq, Serbi, 80min

21:00 Ceremonia e mbylljes së Festivalit në QM Pavarotti

ZHVILLIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E SEKTORIT CIVIL NË REGJION

Qëndrueshmëria e organizatave joqeveritare dhe shoqatave të qytetarëve është një ndër çështjet celës të zhvillimit të sektorit civil. Edhe pse në parim këto organizata financohen nga anëtarësia, donacionet dhe puna vullnetare e anëtarëve të tyre, të gjitha ato që dëshirojnë të realizojnë projekte paksa më të rëndësishme në komunitetin lokal ose në regjion, janë të detyruara të punojnë jashtëzakonisht shumë përi ripërtëritjen e mjeteve (fundraising), çka përfshin edhe fitimin e mjeteve vjetake, mbledhjen e donacioneve dhe mjeteve sponsoruese, si dhe subvencionet dhe hyrjen në partneritet.

Fatkeqësisht, qëndrueshmëria e tërë këtij sektori – posaçërisht në Bosnje e Hercegovinë – shpesh varet në mënyrë vendimtare nga vullneti, iniciativa dhe mbështetja e organizatave ndërkombëtare. Kjo krijon një jostabilitet mjaft të lartë në funksionimin e organizatave joqeveritare (çfarë u dëshmua pas largimit të pjesshëm nga skena të Fondacionit Sorros, kur shumë organizata joqeveritare ranë në një krizë ekzistenciale të njëmendtë). Një qëndrueshmëri më e lartë e këtij sektori do të arrihej me mbështetjen legislative sistemore përi organizatat joqeveritare, jo vetëm me dhëni e të drejtës përi lehtësimi tatimore përi donatorët e këtij sektori, por edhe me dhëni e të drejtës që këto organizata të zhvillojnë aktivitete komerciale, dhe përi këtë sektori civil do të duhej të lobojë në Parlament dhe Qeveri.



Një rast për studim: Teatri EXIT

Është themeluar në vitin 1993 në Zagreb, si organizatë joqeveritare, me qëllim të kultivimit të teatrit alternativ dhe eksperimental. Me punën e tij ka arritur të transformojë strukturën e publikut duke u përpjekur të afrojë kryesishë spektatorët e rinj, duke kultivuar një shprehje dhe stil të afërt për ta. Duke shfrytëzuar hapësirat e një ish-kinemajë në përbërje të Qendrës për Kulturën, ka dëshmuar mundësinë e rivitalizimit të hapësirave të qytetit që në vetëdijen e qytetarëve konsideroheshin jotërheqëse dhe të largëta nga qendra e qytetit. Pasi mori shpërblime të shumta vendëse dhe ndërkombëtare, ai doli në krye të teatrove kroate, duke fituar ashtu gjithnjë e më shumë statusin e teatrit të qytetit me të drejtë të plota, i cili ua imponon kriteret e suksesshmërisë edhe institucioneve të tjera të këtij tipi, posaçërisht në pikëpamje të vetëfinancimit nga publiku.

VEPRIMI I SHOQËRISË CIVILE NË KULTURË: QËLLIMET METODIKË DHE DETYRAT PËR PUNË

Qëllimet:

të përcaktohen fushat dhe format e veprimtarisë interkulturore ku organizatat joqeveritare janë më të suksesshme dhe ku ushtrojnë ndikimin më të madh në tërë komunitetin

të zhvillohet nevoja e vetorganizimit për zgjidhjen e nevojave urgjente të një komuniteti apo grupi

të thyhet ndjenja e pafuqisë, pasivitetit dhe e mungesës së perspektivës, posaçërisht të brezit më të ri, për zhvillimin e aftësive, interesave, dijeve dhe mjeshtërive individuale me rëndësi për komunitetin më të gjerë

të mundësohet njohja me rëndësinë që ka rrjetëzimi dhe lidhja e organizatave joqeveritare të ndryshme dhe nismave të tyre për një veprim më efikas, në bashkëpunim me sektorin privat dhe atë publik

Detyrat:

Numërojini organizatat joqeveritare më të rëndësishme në mjedisin tuaj.

Vlerësojeni rëndësinë e veprimtarisë së akëcilës organizatë nga pikëvështrimi i dialogut interkulturor dhe argumentoni pse është ashtu?

Vlerësoni (në përqindje) sa njerëz nga komuniteti juaj dhe në çfarë mase marrin pjesë në punën e nismave dhe organizatave civile?

Në çfarë mënyre organizata juaj joqeveritare do të mund të hynte në relacione partneriteti ose në dialog me dy sektorët tjerrë? Çfarë do të kërkonit prej tyre dhe çka do t'i u ofronit?

Fjalët çelës:

Shoqëria civile (shoqëria qytetare, sektori joprofitabil, sektori i tretë) – është shoqëri e qytetarëve dhe e shoqatave të tyre, po edhe si asociacione shoqatash (rrjetet). Termi shoqëri civile i ndërlidh të drejtat e njeriut, shoqatat qytetare dhe opinionin në një fushë të përbashkët.

Shoqata e qytetarëve – bashkimi i lirë i njerëzve rreth një projekti, ideje a aktiviteti të caktuar, i cili regjistrohet dhe vepron si një person juridik i pavarur.

Organizatat joqeveritare – i tubojnë po ashtu qytetarët rreth një projekti, ideje a aktiviteti të caktuar, por rëndësia e tyre i tejkalon interesat e njerëzve të tubuar dhe hyn në fushën e interesit publik. Zakonisht formohen në domenet në të cilat edhe shtetet zhvillojnë një politikë programore të caktuar (shëndetësia, ekologjia, kultura, etj.), pikërisht me qëllim që të ndikojnë tek ajo ose të realizojnë projekte në fushat që kjo i lë pasdore.

Literatura

Adolf Bibić. *Civilno društvo i politički pluralizam (Shoqëria civile dhe pluralizmi politik)*. Omladinski kulturni centar, Zagreb, 1990.

Federacija Bosna i Hercegovina: dr avo i civilno društvo (Federato e Bosnjës e Hercegovinës: shteti dhe shoqëria civile (red. Ivo Žanić). Erozmus Gild, Novi Liber, Zagreb, 1995.

Patrice Canivez. *Odgjiti grozino?* (Të edukohet qytetari?) Durieux, Zagreb, 1999.

MENAXHMENTI STRATEGJIK DHE PROJEKTET INTERKULTURORE

QASJA STRATEGJIKE ZHVILLIMIT TË ORGANIZATAVE JOQEVERTARE

Futja e menaxhmentit dhe metodave të marketingut në punën e organizatave joqeveritare që kanë të bëjnë me kulturën është kërkesë e kohës bashkëkohore, e cila si kulturës ashtu edhe sektorit civil ia imponon arritjen e suksesit tek opinioni, po edhe qëndrueshmërinë, respektivisht efikasitetin dhe ekonominë e veprimit. Për këtë arsy, aktivistët e sektorit joqeveritar duhet të marrin dije gjegjëse për planifikim strategjik, pozicionim në opinion, mediacione dhe animacione socio-kulturore, etj.

Për krijimin e strategjive afatgjata është e domosdoshme që të kryhet hulumtimi i mjesdit, problemeve dhe nevojave të komunitetit shoqëror, si dhe të sektorit në tërësi, për t'i shprehur ashtu dyfishimet programore, por edhe për t'i zgjedhur partnerët adekuatë, komplementarë. Po ashtu, është e domosdoshme që të hulumtohen edhe tendencat në zhvillimin kulturor, programet ndërkombëtare, iniciativat dhe idetë, dhe e gjithë kjo për një përfshirje sa më adekuate në proceset dhe bashkëpunimin më të gjërë regional.

Me planifikimin strategjik organizata joqeveritare duhet t'u përgjigjet pyetjeve në vijim:

çfarë do të jetë orientimi ynë programor (profil programor, identiteti...)?
çfarë do të jenë programet, aksionet dhe aktivitetet që mund të realizohen me forcën tonë?

kujt i dedikohen programet tonë dhe cilat nevoja i përbushin?
çfarë marrëdhënie shqiptare do të vendosen me sektorët tjera dhe çfarë presim ne nga ata?

Në planifikimin strategjik elemente çelës janë vizioni / misioni; qëllimet; programet dhe aktivitetet; si dhe kriteret dhe metodat e evaluimit.

VIZIONI: është konstatim i vlerës, aspiratave, vlerësimeve të grupit që e përbën organizatën joqeveritare dhe me të cilin përcaktohet caku i dëshiruar afatgjatë i të arriturave. ("Të shihet dhe ndjehet ardhmëria")

MISIONI: definimi i kuptimit themelor të organizatës joqeveritare, shumë rrallë pëson ndryshime. Misioni përfaqëson bazën nismëtare për përcaktimin e qëllimeve dhe detyrave.

Nocioni i misionit të organizatave joqeveritare duhet të përfshijë në vete:

Filozofinë themelore të organizatës, e cila shprehet me një fjali konkize ose një pasazh të shkurtër;

Duhet të jetë unik dhe distinktiv, i papërshtatshëm për cilëndo organizatë tjetër;
Duhet të jetë eksitues dhe fryshtues, si për aktivistët ashtu edhe për opinionin.

Të kuptuarit e misionit bën që të arrihet koheranca e brendshme e organizatës, po edhe të përqafohet organizata nga mjesdi.

QËLLIMET: konstatime të rezultatit të fundmë, pika që dëshirojmë t'i arrijmë. Qëllimet ofrojnë kornizën brenda së cilës merren vendime për programet dhe aktivitetet. Qëllimet gjithmonë deklarohen për një periudhë të caktuar dhe përfaqësojnë bazën nismëtare për matjen dhe evaluimin e të arriturave. Mund të jenë afatgjata dhe afatshkurtra.

Konceptet zhvillimi strategjik dhe plani strategjik duhet të jenë bazë në procesin e marrjes së vendimeve, sepse politika programore dhe aktivitetet e organizatave joqeveritare në kulturë shtrojnë kërkesën për të zgjedhur midis opsjoneve të ndryshme dhe detyrave të ndryshme që duhet realizuar në një periudhë kohore më të gjatë. Secila metodë pune dhe përbaltja programore duhet të jenë në përputhje me strategjitë themelore të organizatës joqeveritare.

Plani strategjik duhet të pasqyrojë:

raportin ndaj kulturës dhe krijuimtarisë artistike

raportin ndaj komunitetit lokal dhe nevojave të tij

raportin ndaj pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësve potencialë në programet e organizatës

raportin ndaj administratës (pushteteve) shtetërore, lokale ose regionale

marrëdhëniet midis organizatës dhe bashkëpunëtorëve të tjera të përkohshëm a të përhershëm: organizatave të tjera, institucioneve të kulturës, shoqatave të artisteve, masmedias...

Gjatë bërjes së planit strategjik zakonisht rekomandohet zbatimi i ndonjërs nga metodat e analizës strategjike, me qëllim të përcaktimit të vendit që zë organiza në mjeshtësi e saj dhe për zhvillimin e strategjisë së qëndrueshmërisë. Metoda më e njoftuar e analizës strategjike është analiza SWOT.

Fjala SWOT përfaqëson një shkurtesë (shkronjat fillestare) të katër fjalëve angleze: Strength – forca, Weaknesses – dobësitë, Opportunities – mundësitet, Threats – kërcënimet. Për t'i përcaktuar forcat e brendshme dhe dobësitë e organizatës, si dhe mundësitet e kërcënimeve që mund t'i vijnë nga mjeshtësi që e rrethon, krahës evaluimit të punës dhe programit të organizatës, si dhe arsyeshmërisë së veprimtarisë së saj – analiza përpinqje edhe në pyetjen se cili është kontributi thjesht konkret i OJQ-së në një moment të caktuar në mjeshtësi konkret.

Njëkohësisht, është e nevojshme të definohen shumë faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, si objektivë ashtu edhe subjektivë, të cilët do t'i nënshtrohen analizës.

Faktorët e jashtëm:

mjeshtësi kulturor tradicional (opioni publik, niveli kulturor i pjesës më të madhe

të popullatës, modelet kulturore dhe stilët e jetesës së popullatës...) oferta kulturore, programet e sektorit joqeveritar mënyra e funksionimit dhe reputacioni i sektorit të tretë identiteti i qytetit dhe kapacitetet (resurset) e komunitetit lokal: resurset natyrore dhe ambientale të tjera, resurset ekonomike, mediat, rrjeti arsimor, burimet financiare, etj...

Faktorët e brendshëm objektivë janë:

potenciali teknik (pajisja kompjuterike, pajisjet prodhuese audio-vizuale, e të ngjashme)

potenciali finanziar

kushtet hapësinore (lokacioni i selisë së OJQ-së, madhësia e tij, pozita në inđin e qytetit, etj.)

Faktorët e brendshëm subjektivë janë:

kuadrot ekzistues – kompetenca e tyre, dija dhe aftësitetë

marrëdhëniet reciproke dhe mënyra e komunikimit dhe e funksionimit qëndrimet, vlerat dhe opinionet e aktivistëve.

Plani strategjik duhet të marrë në konsideratë tërësinë e problemeve dhe marrëdhënieve në komunitetin shoqëror: që nga sistemi publik i pushtetit (kuvendi dhe qeveria lokale), pastaj sistemi arsimor, i cili përfaqëson bazën për përfshimin e nevojave dhe shprehive kulturore dhe të mirëkuptimit interkultural dhe të tolerancës, gjë te sistemi i masmedias – si mjeti më i fuqishëm për ushtrim influence dhe përbartjen e mesazheve.

Në Shtojcën nr. 3, të këtij doracaku gjenden 8 tabela strategjike që mund t'ju shërbjnë për definimin e planit zhvillimor strategjik. Në bërsen e tij duhet të përfshihen të gjithë aktivistët e organizatës joqeveritare, sepse ai duhet të pasqyrojë vler-

at dhe synimet e shumicës, si dhe aftësitë dhe mundësitetë reale të organizatës në tërësi. Ky është njëkohësisht edhe një element çelës që e mundëson edhe realizimin e asaj që është thënë aty, sepse të gjithë do ta ndiejnë përgjegjësinë për implementimin e tij.

Plani strategjik duhet t'i vëre në pah qartë strategjitet çelës, si të zhvillimit (capacity building) të organizatës joqeveritare vetë (përvetësimi i teknikave të fundrasing-ut, të drejtimit, lidershipit, të delegimit të përgjegjësisë, etj.), ashtu edhe të strategjisë çelës të veprimit programor (krijimi i rrjeteve, partneritetet, programet edukative, zhvillimi i programeve dhe shërbimeve komerciale, etj.). Një theks i veçantë është e domosdoshme t'i kushtohet futjes së logjikës projekteve, pastaj formësimi zhvillimor të aktivitetave interkulturore dhe dialogut, të cilat do të jenë sa më shumë që të jetë e mundshme participuese, respektivisht të përfshihet një numër sa më i madh individësh nga grupe të ndryshme shoqërore.

Në Shtojcën nr. 4, në fq.158 gjendet pjesa hyrëse e planit strategjik afatshkurtër të Qendrës për Artin Bashkëkohor në Sarajevë, si një nga shembujt e mundshëm të hartimit të tij dhe më vonë të përdorimit të tij në punën praktike.

KONCEPTUALIZIMI DHE FORMËSIMI I PROJEKTEVE INTERKULTURORE

Menaxhmenti projektues

Projekti është një ide, e menduar në trajtë procesi që na shpie te një rezultat i caktuar.

Cilat janë karakteristikat e përbashkëta të projektit, pa marrë parasysh thelbin e tij konceptual?

Të gjithë janë të orientuar drejt realizimit të një qëllimi të caktuar (kjo do të thotë se është e domosdoshme hierarkia dhe struktura e qëllimeve dhe e detyrave).

Projekti është një sistem – presupozon ndërmarrjen e aksioneve reciprokisht të ndërlidhura (të cilat janë në tërësi të lidhura me identitetin e përgjithshëm të organizatës, por në çaste të caktuara projekti mund të jetë një ngarkesë tepër e madhe për organizatën, nëse me vëllimin dhe rëndësinë e tij fillon t'i tejkalojë mundësitet e saj).

Ato kanë një kohëzgjatje të caktuar – e kanë fillimin dhe fundin e përcaktuar saktësisht (në Kartogramin e Gantit duhet të saktësohet fillimi dhe përfundimi i saktë i çdo aktiviteti të paraparë, ashtu siç burojnë njëri nga tjetri).

Çdo projekt është në një shkallë të caktuar unik dhe i veçantë (në kohën e ndryshimeve të pandërprera, si të organizatave ashtu edhe të mjedisit, asnjë projekt nuk guxon të përsëritet pa zgjidhje adekuate me të cilat jep përgjigje ndaj situatave të krijuara rishtas). Prej këndej nuk ka projekte dhe zgjidhje tipike, të cilat mund të rimerren në mënyrë mekanike nga një vit në tjetrin, ose nga një mjedis në tjetrin.

Çdo projekt nënkupton njësoj procesin dhe rezultatin – ndërsa shpesh procesi në vetvete është edhe qëllim edhe rezultat (posaçërisht kur bëhet fjalë për dialogun

QELLIMET		Plani i realizimit		Koha reale e realizimit	
Detyrat	Aktivitet				
.....
.....
.....
		Java 1	Java 2	Java 3	Java 4
		Java 5	Java 6	Java 7	

interkulturor, vetë procesi i nisjes së projektit, rrjedha e realizimit të tij, mund të jenë më të rëndësishëm nga vetë prezantimi publik i rezultateve në formë libri ose ekspositez).

Projekti i një OJQ presupozon një rëndësi më të madhe të menaxhmentit efektiv (të jehonës publike dhe ndryshimit të gjendjes në rrëthinë) se sa një këmbëngulje tek efikasiteti, i cili është primar në industritë e kulturës.

Cikli jetësor i projektit

- | | |
|----------------|--|
| 1.Koncepcioni | 7.Entuziazmi |
| 2.Planifikimi | 8.Pritjet |
| 3.Realizimi | 9.Zhgënji, pastaj paniku |
| 4.Kontrolli | 10. Kërkimi i fajtorit |
| 5.Evaluimi | 11.Dënim i të pafajshmëve |
| 6.Terminacioni | 12.Lavdatat dhe nderimet për ata që nuk kanë marrë pjesë |

Nuk ekziston një teori që mund të na mësojë si të bëhet koncepcioni – si të bëhem autor i një projekti. Mirëpo, menaxhmenti projektues na mëson si ta drejtojmë projektin, qoftë kur ne jemi krijues-autor i tij, qoftë kur i ndihmojmë një grupi aktivistësh për realizimin e idesë së tyre. Operacionalizimi i idesë është fusha themelore e menaxhmentit projektues. Në fazën e operacionalizimit është e domosdoshme të definohen: misioni (kuptimi i projektit), qëllimet e tij themelore, por edhe qëllimet afatgjata që do të lënë hapësirë për projekte të reja në të ardhmen, elementet bazike programore të projektit.

Në kuadër të kësaj faze ka disa nënfasa:
 identifikimi i problemit
 përcaktimi i qëllimeve të projektit
 evaluimi i mundësive vetjake
 definimi i detyrës së projektit.

Ndërsa, nëse projekti është më kompleks, atëherë kjo fazë do të ketë edhe disa nënfasa të tjera:

përcaktimi i procedimeve metodike

zhvillimi i fazës provuese a eksperimentale (aksioni pilot) përcaktimi i zgjidhjeve – definimi përfundimtar i projektit.

Planifikimi i projektit presupozon zhvillimin e detajuar të kornizës institucionale të projektit (statusi juridik, raporti ndaj institacioneve me të cilat vendoset bashkëpunimi), zgjedhja e opsoneve themelore strategjike dhe metodave të realizimit të projektit. Pastaj e definojmë se me çfarë mjetesh disponojmë (kadrorike, materiale, hapësinore, kohore), i parashikojmë pengesat e mundshme dhe mënyrën e tejkalimit të tyre.

Planifikimi i projektit, siç u tha tashmë, mund të bëhet me metodologjinë e planifikimit strategjik, ose me zbatimin e ndonjërs nga metodat e planifikimit kohor, ashtu që kuadrot, nevojat materiale, buxheti, dhe në harmoni me këto edhe ripërtëritja e mjeteve (fundraising), planifikohen në ritme të caktuara në harmoni me planin themelor të realizimit të veprimitarisë.

Pra, për t'iu qasur realizimit, është e domosdoshme që t'i sigurojmë mjetet – respektivisht ta bëjmë fundraising-un e projektit. Për këtë qëllim koordinatori i projektit shkruan kërkesa të shumta (Ministrisë së Kulturës, administratës së qytetit për kulturë, fondacioneve, etj.) dhe letra sponsorizimi dhuruesve potencialë.

STRUKTURA E KËRKESËS PËR DOTACION – LETËR FONDACIONIT OSE MINISTRISË

rezymeja (e parashtron projektin qartë dhe në mënyrë koncize, në një pasazh: emri i projektit, vendi i veprimit, koha e realizimit, bartësit dhe grupet që iu dedikohen projektit),

hyrja (e përshkruan kualifikimin dhe besueshmërinë e propozuesit të projektit), **parashtrimi i problemit** (i përshkruan mangësitë në shoqëri dhe jetën kulturore dhe parashtron propozimin për mënyrat e evitimit të tyre me anë të projektit), **qëllimet e projektit** (bashkë me theksimin e pajtueshmërisë me qëllimet e atij nga i cili kërkohen mjetet),

metodat e realizimit të projektit (përshkruhen strategjitet e realizimit të projektit, me ose pa ndihmën e financuesit),

evaluimi (parashtrohet plani - kur dhe si do të vlerësohet realizimi i projekteve – indikatorët e evaluimit),

buxheti dhe burimet e ardhshme të financimit (definohen qartas të gjitha shpenzimet, burimi dhe mënyra e sigurimit të mjeteve në të ardhmen, krahas dationeve të këtij trupi).

Realizimi i projektit presupozon një kulminacion të punës ekipore dhe është peruidha me më shumë strese në jetën e koordinatorit të projektit. Ai, paralelisht, e përfshin edhe kontrollin, prandaj gjatë fazës së realizimit, posaçërisht në fazën e tij përfundimtare (në kohën e zhvillimit të festivalit, disa ditë para dhe pas hapjes së ekspozitës, etj.), organizohen brifing-takime të përditshme të gjithë ekipit. Kjo është njëkohësisht edhe një nga mënyrat e kontrollit permanent të procesit të realizimit. Që nga momenti i përfundimit të projektit – me prezentimin publik – nuk ndërpritet edhe vetë puna në projektin. Mu në këtë kohë është e domosdoshme të kalohet te detyra vijuese: evaluimi i projektit.

Evaluimi i projektit interkulturor

Qëllim i evaluimit është të bëjë vlerësimin, në mënyrë sa më sistematike dhe objektive që të jetë e mundshme, e relevancës së projektit për jetën kulturore dhe artistike dhe për dialogun ndëretnik të njedisit ku është konceptuar dhe realizuar ai. Do të hetohen detajisht efektiviteti i projektit në relacion me qëllimet e parashtruara të tij, posaçërisht ndikimi i tij te grupet që u dedikohej.

Evaluimi i projekteve socio-kulturore dhe kulturore-artistike, prandaj, ka të bëjë në radhë të parë me kualitetin e programeve të projektit dhe me efektivitetin e tij, dhe vetëm më vonë me efikasitetin e menaxhmentit dhe ekonomizmin e arritur të projektit. Në evaluimin e programit dhe të kualitetit të tij do të merret parasysh në mënyrë të veçantë:

ndikimi i arritur në kualitetin e komunikimit, dialogut dhe zhvillimit të tolerancës efektet te grupet primare të synuara
efektet te grupet sekondare të synuara – analiza e jehonës mediale dhe shkallës së suksesit të veprimtarisë PR (relacioneve me opinionin),
kualiteti kulturologjik dhe artistik i programit (inovacioni në qasje, metodë...),
kuantiteti dhe balanci i programit në raport me atë që ishte planifikuar,
realizimi i qëllimeve specifike të projektit.

Evaluimi i menaxhmentit të projektit ka të bëjë rëndom me parametrat në vijim:
planifikimin – efikasitetin kohor (mënyra e shfrytëzimit të kohës)
balancin buxhetor (cost-effectiveness)
llojshmërinë e burimeve të financimit
sigurinë e burimeve...
punën ekipore dhe efikasitetin e saj

kualitetin e punës ekipore
shpërndarjen adekuate të roleve dhe detyrave
kënaqësinë në punë
kontributin e anëtarëve të ekipit.

Në shtojcën nr. 4 është dhënë shembulli i pyetësorit të shfrytëzuar pikërisht për evaluimin e projektit të edukimit në bazë të të cilit edhe është shkruar ky libër. Ky evaluim, i cili ka bërë përpjekje të vlerësojë jo vetëm kualitetin e projektit (seminarit) në vetvete, por edhe të vlerësojë nevojat dhe interesat edukative si të këtij grupi të synuar, ashtu edhe të grupeve të ardhshme, ka ndikuar në masë të madhe te zgjedhja e temave dhe përbajtjeve, respektivisht mbi strukturën e përgjithshme të librit.

Të jetosh në ardhmëri: qëllimet metodike dhe detyrat

Qëllimet:

të vihet re rëndësia e menaxhmentit strategjik dhe planifikimit për stabilitetin zhvillimor të organizatave joqeveritare, posaçërisht në kushtet e ndryshueshme politike, ekonomike dhe shoqërore
të aftësohen aktivistët e organizatave joqeveritare për të bërë strategji afatgjatë të zhvillimit, si dhe të planit strategjik afatgjatë
të zhvillohen aftësitë e të menduarit projektor në bazë të njoftes së tendencave më të gjera të zhvillimit kulturor, të nevojave dhe resurseve të komunitetit lokal, si dhe të aftësisë dhe kapacitetit të vet organizatës
të krijohen parakushtet për realizimin e evaluimit të funksionimit të organizatës në tërësi, të programeve dhe projekteve të saj, pikërisht si një instrument themelor për ruajtjen dhe ngritjen e kualitetit

të fitohen dije themelore të domosdoshme për procesin e ripërtëritjes së mjeteve (fundraising), si dhe të atyre të rëndësishme për sigurimin e kapitaleve shtesë, si për projekte të veçanta, ashtu edhe për funksionimin e rregullt të gjithëmbarshëm të organizatës, p.sh. me fitimet vetjake (me bileta, shërbime, aktivitete shtesë, etj.).

Detyrat:

Bëjeni një analizë SWOT – pozicionojeni organizatën tuaj në komunitetin lokal. Shkruajeni një propozim projekt interkulturor të OJQ-së suaj në formë të Kërkesës së dhënë për donacion. Bëjini dallimet me rastin e drejtimit te:

komuna a ministria

fondacioni

një subjekt ekonomik.

Evaluojeni një nga projektet tuaja duke shfrytëzuar parametrat e përmendur (me plotësimet e domosdoshme në raport me veçantinë e projektit tuaj).

Fjalët çelës:

Efektiviteti – shkalla në të cilën një projekt dhe aksion i caktuar e arrin qëllimin për të cilin realizohet. Rezultati mbresëlënës, efekti i një aktiviteti, i një rëndësie të madhe për popullatën ose një grup shoqëror të caktuar.

Efikasiteti – shpejtësia dhe saktësia e realizimit të qëllimeve, rezultatet e arritura të planifikuara dhe të dëshiruara, posaçërisht në raport me mjetet e investuara, kuadrot, pajisjet teknike, paratë dhe kohën.

Evaluimi – vlerësimi kritik – sistemor dhe objektiv – i shkallës së realizimit të qëllimeve të dëshiruara të organizatës, të projektit zhvillimor të organizatës ose të ndonjë programi të veçantë – efektivitetin po edhe efikasitetin e saj, si dhe të kualitetit të menaxhmentit të përgjithshëm.

Buxheti – plani financiar i zhvillimit të programit ose aktivitetit, në një periudhë kohore të caktuar (më së shpeshti për një vit). Plani ekonomik i sistematizuar për një periudhë të caktuar. Në menaxhment buxheti shënon shpërndarjen precise të resurseve të organizatës, e cila tregon për mënyrën, ose përdorimin, e përdorimit të mjeteve, përbërjen e mjeteve të ndara dhe parimet e zbatuara në sigurimin e resurseve dhe shpërndarjen e tyre.

Qëllimi (goal, objective, target, aim) - qëllimi afatgjatë që synohet (goal), respektivisht gjendja e dëshiruar ku janë orientuar aktivitetet dhe mjetet, po që nuk duhet medoemos të arrihet;

qëllimi që mund të arrihet pjesërisht gjatë periudhës së planifikuar (objective), ka të bëjë me një gjendje paksa më specifike se i mëparshmi dhe përfshin përshkrimin e gjendjes së dëshiruar, vëllimin në të cilin do të duhej arritur kjo gjendje, periudhën kohore në të cilën pritet arritura e gjendjes së dëshiruar, vendi dhe personat me të cilët ka të bëjë kjo gjendje;

rezultati intermediar (target) - gjatë arritjes së qëllimeve afatgjate dhe afatmesme (goal, objective) është më specifik dhe zakonisht i kuantifikuar, me një periudhë kohore të caktuar në të cilën pritet të arrihet.

Marrja e vendimit, vendimmarrja (decision making) – funksioni drejtues i menaxhmentit dhe administratës publike, pjesa më e rëndësishme e të gjitha funksioneve të tjera të menaxhmentit. Marrja e vendimit është zgjedhje midis mundësive.

sive të ndryshme dhe zhvillohet në disa faza: identifikimi, evaluimi i mundësive, si dhe zgjedhja definitive që materializohet me vendimin. Për procesin e marrjes së vendimit në organet e administratës publike, që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm, është e domosdoshme që puna të bëhet e hapur për opinionin dhe që vetë procesi të jetë transparent (mekanizmat, komisionet, etj.).

Planifikimi – marrja e vendimeve në dritën e efekteve të tyre në të ardhmen.

Planifikimi, prandaj, mund të definohet si një proces vendimmarrjeje lidhur me mënyrën se si e ardhma të bëhet më e mirë se e tashmja, si definim i ndryshimeve të nevojshme për t'u arritur përmirësimë të caktuara dhe përcaktimi i mënyrës së zbatimit të këtyre ndryshimeve në praktikë.

Strategjia (strategy) – një spektër i gjerë aktivitetesh të ndërmarra për arritjen e qëllimeve afatshkurtra dhe/ose afatgjata. Strategjia përfshin identifikimin e momenteve të volitshme për intervenim; përcaktimi i mënyrave me ndihmën e të cilave sigurohet përfshirja e sektorëve të tjera – posaçërisht të opinionit në terësi; përcaktimi i spektrit të faktorëve politikë, shoqërorë, ekonomikë, drejtues dhe teknikë, të rëndësishëm për arritjen e qëllimeve, kufizimet që mund të hasen, si dhe gjetja e mënyrave për tejkalimin e tyre.

Planifikimi strategjik – një bashkësi metodash e teknikash me të cilat një organizatë planifikon zhvillimin e vet afatgjatë, duke u nisur nga nevojat dhe potencialet e mjedisit, si dhe i mundësive vetjake, por duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet shoqërore të ardhshme që mund ta rrezikojnë atë, po edhe dobësítë e veta. Ai i parashev qëllimet e arritshme, të lidhura mes vetes, si dhe strategjitë, mënyrat dhe resurset e realizimit të tyre.

Literatura:

Milena Dragicevic Šešic e Branimir Stojkovic, *Kultura, menad ment, animacija, marketing* (Kultura, menaxhmenti, animacioni, marketingu). CLIO, Beograd, 2000.

Tomislav Šola. *Marketing u muzejima ili O vrlini i kako je obznaniti* (Marketingu në muzetë ose Mbi virtytin dhe si të shpallet ai). Hrvatsko muzejsko društvo, Zagreb, 2001.

Giep Hagoort. *Art Management: Entrepreneurial Style*. Eburon Publishers, Delft, 2000.

MEDIACIONI INTERKULTUROR DHE DIALOGU
NË KOMUNITETET MULTIELTNIKE

Organizatat joqeveritare në mjediset multietnike e kanë detyrë të veçantë dhe të përhershme të promovojnë dialogun dhe komunikimet midis grupeve të ndryshme. Prandaj, është e domosdoshme që të gjithë aktivistët e organizatave joqeveritare t'i zoterojnë metodat dhe teknikat e medacionit interkulturore. Qëllimi i tij është që të krijojë parakushtet për mirëkuptim reciprok, shkëmbimin e informatave, por edhe të artefakteve dhe vlerave, dhe si qëllim përfundimtar të mundësojë projekte të përbashkëta, ku diversiteti kulturore (llojlojshmëria kulturore) do të promovohet si një vlerë e veçantë.

Në kontekstin e Bosnjës e Hercegovinës kjo presupozon punën për thyerjen e paragjykimeve dhe moskuptimit të Tjetrit, pranimit të vlerave, nevojave dhe aspiratave të tij, si dhe t'i krijojë kushtet dhe një atmosferë bashkëpunimi të grupeve etnike të ndryshme. Nga ky bashkëpunim, me një medacion të suksesshëm do të zhvilloheshin më tej projektet e përbashkëta, të cilat nuk do t'i zhvlerësonin dallimet kulturore midis grupeve dhe individëve, por do të vendosnin midis tyre marrëdhënie tolerance të ndërsjellë.

Pra, medacioni interkulturore merret me:

relacionet brendagrupore në kuadër të organizatës joqeveritare multietnike ndërmjetësimin e vlerave dhe ideve, të cilat ky grup dëshiron t'i promovojë në komunitetin lokal midis grupeve të ndryshme të popullatës nëpërmjet gjallërimit të jetës socio-kulturore
diagnostifikimin e problemeve dhe vendosjen e dialogut për zgjidhjen e tyre nëpërmjet proceseve të komunikimit publik (*raising awareness*) – me krijimin e një platforme publike
presionin mbi pushtetet publike dhe autoritetet shoqërore me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve konkrete dhe futjes së procedurave gjegjëse në proceset e vendimmarrjes

në të gjitha nivelet

krijimin e kushteve për tejkalimin e identiteteve etnike dhe mundësimin e debatit për problemet e një rëndësie më të gjerë regionale, po edhe evropiane përfshirjen konstruktive të komunitetit ndërkombëtar në proceset regionale dhe lokale të komunikimit interetnik, posaçërisht në vendosjen e standardeve lidhur me metodat e marrjes së vendimeve dhe të komunikimit.

Në këtë mënyrë, aktivistët e organizatave joqeveritare mundësojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e pjesëtarëve të grupeve etnike të ndryshme, me rëndësi për komunitetin më të gjerë, pa diskriminim mbi çfarëdo bazë qoftë (etnike, kulturore, sociale, gjinore, arsimore, të gjeneratave...).

Që medacioni t'i arrijë efektet e tij të plota në komunitet, organizatat rëndom si hapësirë të veprimit të tyre e zgjedhin hapësirën qendrore publike të komunikimit, ose e shfrytëzojnë hapësirën mediale, si një platformë për takimin e grupeve etnike të ndryshme, posaçërisht në fazën e parë të punës së tyre, kur ende ekziston një mosbesim midis grupeve etnike, ndërsa institucionet e sektorit publik janë të ndara mbi baza etnike. Kështu, problemet e vërejtura jo vetëm që i nënshtrohen hulumtimit në procesin e punës, dhe analizohen nga aspektet e të gjitha grupeve, por publikisht shpërfaqen, bëhen të dukshme, dhe pushtetet publike nuk kanë mundësi më që t'i injorojnë dhe t'i lënë pasdore. Në këtë mënyrë, konfliktet shoqërore të ndrydhura – të cilat shkaktojnë apati, fatalizëm, pafuqi, madje edhe frikë – nxirren në hapësirën publike, bëhen të dukshme dhe nëpërmjet procesit të negocimit benda sektorit civil nxisin gjetjen e propozimeve dhe zgjidhjeve, dhe vetëm kështu ato mund t'u imponohen pushtetëve publike dhe komunitetit më të gjerë.

Që këndeje, si instrumente dhe metoda të medacionit hasen shumë shpesh teatrot e rrugëve, karnevalet, projekte instalimesh, muralesh dhe skulpturash në hapësirën publike, pastaj fejtonet mediale, debatet, seritë e intervistave dhe të ngjashme.

Nga ana tjetër, atyre u paraprijnë ose i përcjellin punëtori të shumta – respektivisht ato forma veprimi të organizatave joqeveritare që ofrojnë mundësi kontaktesh të drejtpërdrejta, këmbim informatash, por edhe ballafaqim të mendimeve rreth problemeve të përbashkëta. Në procesin e mediacionit nuk ka forma të pastratë difuzionit kulturor, si ekspozita, shfaqje, projeksione filmike, por ato duhet përplotësuar dhe gërshetuar me punëtori, tribuna, diskutime, aksione animimi, forma teatrore participuese (ngjashëm me teatrin e të shtypurit të Boalosë – teatrin e konfrontimit), ndërsa në kohën më të re edhe me teknikat e marketingut, siç janë fushatat publike, shpalljet dhe të ngjashme. Këto metoda mund të shfrytëzohen edhe në edukimin për njohjen dhe pranimin e dallimeve (diversity awareness training), me të cilat, gradualisht, një komunitet nga refuzimi i të Tjerëve shpihet deri te një shkallë e komunikimit interkulturor, dialogu i barabartë dhe bashkëpunimi me Tjetrin.

Shkallët e kompetencës interkulturore të individëve dhe grupeve

Integrimi social

Sjellja interkulturore dhe qëndrimet, ia mundësojnë individit që t'i integrojë dallimet

Adaptimi

Mundëson empatinë me individët, pjesëtarë të grupeve etnike të tjera, aftësinë e marrjes së perspektivës së Tjetrit, për t'i kuptuar vlerat e Tjetrit

Pranimi

Pranimi i dallimeve në sjellje dhe theksimi i dallimeve vlerore. Njohja e validitetit të mënyrës së të menduarit dhe perceptimit të botës të Tjetrit.

Minimizimi i dallimeve

I fsheh dhe banalizon dallimet kulturore. Fokusimi te ngjashmëritë midis grupeve.

Qasja mbrojtëse


I shfrytëzon stereotipat negativë, presupozon që kultura e tij është superiore, ndërsa tjetrin e sheh si kërcenim.

Refuzimi

Konsiderimi i kulturës së Tjetrit si krejtësisht të parëndësishme, "johistorike", anticivilizuese, etj.

(Burimi: M. Bennett. The developmental approach to training of intercultural sensitivity. International Journal of Intercultural Relations, nr. 10, 1986, fq. 179-196)

www.danas.org



RADIO EUROPA E LIRË


Një rast për studim: Emisioni "Ura" ("Most") i Radios Evropa e Lirë nga Praga, të cilin e redakton Omer Karabeg, është një shembull tipik i medacionit që nuk shterret në formën fillestare, saktësisht të përcaktuar, të një emisioni radiofonik. Për të arritur efektin e vërtetë, emisioni ribotohet në median e shtypur në mjedise të ndryshme të ish-Jugosllavisë (Zarez, Zagreb; Danas, Beograd, etj.), pastaj inicohen debate, biseda panel dhe projekte të reja në të cilat diskutohet më tej pér problemet e evidentuara. Kështu, pér shembull, ky emision i pari e ka trajtuar temën e ndjenjës së fajit kolektiv të popujve të caktuar pér krimet e bëra në konfliktet luftarake. Pas kësaj, të nxitura nga reagime të shumta të dëgjuesve dhe lexuesve të gazetave, shumë institucione dhe organizata joqeveritare i shtrojnë këto çështje në kuadër të punëtorive, tribunave, kështu që kjo temë bëhet gjërësisht e pranishme dhe, përfundimisht, e nxit reagimin e pushtetit (kështu, asohere Qeveria e RFJ-së e pati krijuar Komisionin pér të Vërtetën dhe Pajtimin).

Medacioni socio-kulturor dhe zvogëlimi i distancës sociale

Në periudhën transitore ndodh një varfërim dhe shtresëzim i shpejtë shoqëror. Grupet shoqërore të varfëruara (pensionistët, punëtorët pa punë ose me paga të vogla, nëpunësit, punëtorët e arsimit...) tërhiqen nga skena publike, nuk janë më të dukshme dhe aktive në jetën shoqërore, sepse luftojnë pér të mbijetuar ose madje kanë një ndjenjë turpi pér shkak të pozitës së tyre shoqërore të degraduar dhe ndjenjës së pafuqisë. Nga ana tjetër, pasanikët e rinj, shumë shpesh pa dije dhe aftësi pér të dalë në opinion, aq më pak pér participim të njëmendtë në jetën

publike, e iritojnë opinionin me demonstrimin e paskrupullt të fuqisë së tyre ekonomike. Në shumë mjedise, me blejen e mediave dhe shtëpive të produksionit muzikor, ata e promovojnë kicin dhe mungesën e shijes, ndërsa njëkohësisht përfitojnë një fuqi shoqërore të madhe. Paradoksi është aq më i madh nëse merret në konsideratë fakti që ky produksion në të vërtetë është i orientuar drejt shtresave më të varfëra të popullatës, duke ua ofruar ashtu mundësinë pér ikje të përkohshme nga përditshmëria.

Rritet distanca sociale dhe ndjenja e marginalizimit dhe ndarjes sociale. Zduken manifestimet dhe solemnitetet që i organizon sektori publik, ku do të merrnin pjesë të gjithë banorët e një mjedisë pa dallim. Prandaj, është përgjegjësi e sektorit civil që të zhvillojë programe të reja mediacioni, të cilat jo vetëm do t'i tubojnë grupet e ndryshme shoqërore dhe do ta integrojnë komunitetin, por njëkohësisht do ta zhvillojnë vetëdijen kritike dhe do t'uaj jepin mundësinë grupeve të deprivilegjuara që ta thonë qëndrimin e tyre, të bëhen të dukshme dhe të angazohen në mënyrë aktive, të çlrohen në proceset e komunikimit shoqëror.





Fotografia: Ivan Ballazheviq, Novi Vinodolski

Vërejtje: Ditën e fundit të karnevaleve, mu para agjërimit të krezmimit, vendësít e Novi Vinodolski e zhveshin Mesopustin (simbolin e karnevalit, vërejtje e përkth.) për ta gjykuar atë (pastaj edhe për ta djegur) për të gjitha fatkeqësítë që i ka sjellë gjatë vitit të kaluar

Një rast për studim: Karnevali në Novi Vinodolski

Karnevali e ka tubuar gjithë qytetin dhe të gjitha grupet shoqërore në solemnitetin e begatë, nga njëra anë, me elemente të kritikës shoqërore (kryesisht të një rëndësie lokale), ndërsa nga ana tjetër, me paturpshmëritë gazmore që njerëzit e tubuar në procesion, meshkuj, gra, pleq e të rinj, i këndojnë zëshëm dhe i shprehin me pamjen dhe sjelljen e tyre.

Si mjete themelore për mediacion rëndom shfagjen:

Resurset informative dhe mediale

Themelimi i projekteve

Këmbimi i drejtpërdrejtë i përvojave (seminaret, punëtoritë, këshillimet, debatet)

Intervenimet artistike

Shfrytëzimi i hapësirave të qytetit dhe paralagjeve

Organizimi i manifestimeve dhe solemniteteve

Format e mediacionit interkulturor dhe socio-kulturor

Mediacioni i orientuar drejt grupeve më të gjera të popullatës

Ka për qëllim që idetë e tolerancës sociale dhe interkulturore, të shoqërisë së hapur, pastaj të dialogut ndëretnik, t'i promovojë me shfrytëzimin, më së shpeshti, të atyre mediave që janë më të pranishmet në opinion, siç janë radiot dhe rrjetet TV lokale dhe regionale, bilbordi, intervenimet artistike në hapësirën publike.

Një rast për studim: Kështu, në Sarajevë u zhvillua aksioni "Meeting point", i cili në hapësirën e depos së Hamamit të Vjetër, të shndërruar në Art Qendrën Kopshti

Veror Qulhan, ua mundësoi dhjetëra artistëve të shprehin vizionet e tyre të jetës në Sarajevë në kontekstin e kujtesës kolektive të banorëve të saj. Në këtë mënyrë, vizitorët, të cilët u përkasin grupeve nga më të ndryshmet, komunikojnë me njërit-tjetrin në platformën publike të instaluar rishtas dhe e riaktualizojnë ashtu relationalin e vet ndaj qytetit, historisë së tij dhe populatës, ndërsa ballafaqohen njëkohësisht me problemet çelës të vendit në tërësi. Një nga punimet, instalimi i Alma Suleviq: Anulimi i të Vërtetës, merret me faktin se në BeH ekzistonjë 3 milionë mina, të cilat ajo dëshiron t'i asgjësojë në mënyrë simbolike duke i hequr nga hartat origjinale të fushave të minuara, të shtruara në hapësirën e Qulhanit.

Autorja mbi ato harta shënon në mënyrë rituale kujtimet e saj traumatike, i rrethon shtëpitë ku kanë jetuar miqtë e saj, kushëritët dhe të njohurit. Fjala është për një projekt afatgjatë të artistes, e cila tërë konceptin e radikalizon me shkuarjen në fushat e minuara të njëmenta ku e mbledh dheun, e paketon në thasë të vegjël dhe e shet atë në favor të zgjidhjes së këtij problemi kaq të madh dhe të rezik



Alma Suleviq, Sarajevë: Anulimi i të vërtetës

Mediacioni i orientuar drejt vendosjes së dialogut dhe këmbimit kulturor në një situatë kur janë të ndërprera lidhjet ndëretnike në regjion

Ka të bëjë, para së gjithash, me ndërlidhjen e aktivistëve të OJQ-ve, intelektualëve dhe artistëve, të cilët në mëdise të ndryshme u përkasin rrëtheve komplementare intelektuale dhe artistike, ndërsa janë të lidhur edhe me interesin e përbashkët të orientuar drejt tejkalimit të paragjykimeve, urrejtjes, izolimit dhe të gjitha penge-save të tjera të vendosura gjatë këtyre dhjetë vjetëve të shkuara të transisionit dhe luftërave në këto hapësira.

Kjo ndërlidhje shpesh realizohet nëpërmjet projekteve ngushtësisht profesionale, p.sh. me lidhjen e botuesve rrëth prodhimit dhe plasmanit të librave. Shembull i një nisme të këtillë është bashkimi i tre botuesve (Buybook nga Sarajeva, Durieux nga Zagrebi dhe Forumit të Hapur Kulturor nga Cetina) rrëth botimit të veprave letrare të nga një autori nga të katër vendet (Muharem Bazdulit nga Bosnja e Hercegovina, Dalibor Shimpragës nga Kroacia, Ballsha Bërkoviqit nga Mali i Zi dhe Bilana Sërblanoviqit nga Serbia), në një botim të përbashkët në vitin 2002. Në këtë sens janë po aq të rëndësishëm edhe panairet e librit, festivalet e flmit dhe të teatrit, punëtori dhe seminare të ndryshme dhe të ngjashme. Një numër projekteve, ndërkaq, e ka ndërlidhjen regionale si qëllim ekskluziv të ekzistencës së vet (p.sh. dalCanis, revistë për kulturën e regjionit që del në Lubjanë, Balkan Umbrella, revistë për artet figurative që e shtyp Remont nga Beograd, etj.).

Një rast për studim: "Ideja për Fletoret Sarajevase...u shfaq si fryt i iniciativës së një grupi të shquar letrarësh dhe intelektualësh nga e gjithë hapësira e ish-Jugosllavisë. Shpërbërja e shtetit të përbashkët ishte e përcjellë edhe me ndërprenjen e plotë të komunikimit midis qendrave të saj të dikurshme kulturore. Elitat nacionaliste, të cilat si ideologë të tyre i kishin pikërisht qarqet letrare, e imponuan "ligjërimin e urrejtjes" si një model të dëshiruar ndaj kulturave të popujve fqin-

jë, deri dje të ashtuquajturi vëllazëror. Pas mbarimit të luftërave në këtë troll po mbahet edhe më tej një gjendje e "luftës së ftohtë" në planin e lidhjeve kulturore: po vendoset ngadalë tregu kulturor, me masa të ndryshme legjislative restrikтиве (aq më tepër me praktikën restrikтиве) intencionalisht pengohet qarkullimi i librave, shfaqjeve teatrore, filmave, bartësive të zërit, shtypit; vizitat e artistëve janë të vështirësuarë për shkak të regjimit rigoroz të vizave dhe lejeve për punë.


Qëllim i shkrimitarëve të tubuar rrëth iniciativës për botimin e Fletoreve Sarajevase (Sarajevske sveske) është mospajtimi me idenë, sipas së cilës identiteti autentik nacional dëshmohet vetëm me theksimin e dallimeve midis kulturave fqinje dhe me krijimin e barrierave artificiale ndaj lëvizjes së ideve dhe njerëzve. Angazhohen për një komunikim normal midis kulturash dhe individësh, të bindur se ashtu ata e begatojnë identitetin kulturor vetjak, po edhe ndihmojnë në krijimin e kushteve që hapësira e ish-Jugosllavisë të bëhet një regjion i gërshetimit frytdhënës, bashkëpunimit e tolerancës, e me këtë të neutralizohen rreziqet e përsëritjes së konflikteve.

Fletoret Sarajevase kanë për qëllim t'i analizojnë proceset që i kanë shënuar vitet e shkuara: tema e luftës dhe e përgjegjësisë për krimet është e pamundshme të anashkalohet. Mirëpo, edhe pse debati rrëth fajt për luftën dhe krimet, posaçërisht rrëth përgjegjësisë së letrarëve, është një presupozim i pashtangshëm i çdo tubimi rrëth një platforme të përbashkët për një revistë, ajo nuk do të guxonë të jetë e vëtmja temë e këtij publikimi. Synojmë, para së gjithash, të merremi me aspektet afirmative të komunikimit të kulturave të sllavëve të jugut: me prezantimin e punimeve letrare të shkrimitarëve më të mirë nga kjo hapësirë: të atyre, librat e të cilëve i njobim mirë, që i kemi lexuar me gëzim dhe pasion, i kemi ndjerë si një pjesë të rëndësishme të formimit tonë kulturor, por do t'i botojmë edhe ata më të rinj, midis të cilëve ka edhe një varg shkrimitarësh që janë afirmuar si yje ndërkombëtare letrare, të përkthyer në shumë gjuhë, për të cilët në mjediset kulturore fqinje, për shkak të barrierave të vendosura për ta penguar komunikimin kulturor, nuk dihet shumë.

Kontributet autoriale botohen në gjuhën burimore të autorit (në gjuhën boshnjake, malazeze, kroate dhe serbe), ndërsa autorët slovenë, maqedonë dhe shqiptarë, përvèç në gjuhën burimore, do të përkthehen në njëren nga katër gjuhët e përmendura më sipër."

Velimir Visković

Kryetar i Këshillit Redaktues të Fletoreve sarajevase




Mediacioni i orientuar drejt thyerjes së paragjykimeve dhe ekskluzivizmave ndëretnikë dhe ideologjikë

Lufta dhe konfliktet e vendosën regjionin e Evropës Juglindore në qendër të vëmendjes botërore, si kur është fjala për teoritë gjeopolitike dhe filozofike, ashtu edhe për interpretimet artistike-ideore të ngjarjeve reale. Ngjarjet në Ballkan e kanë aktualizuar si teorinë e Fukujamës mbi "fundin e historisë", me të cilën konstatohet përmbyllja e fitores së paradigmës zhvillimore liberale e demokratike dhe se më asgjë qenësore në përmasa botërore në kuptimin historik nuk do të ndodhë, ashtu edhe teorinë e Huntingtonit mbi konfliktin e civilizimeve, me të cilën sugjerohet se midis tyre në nivelin global ekzistojnë hendeqe të patejkalueshme, prandaj ato janë burim i tendosjeve dhe konflikteve të vazhdueshme.

Një numër i madh intelektualësh dhe artistësh edhe në regjion dhe në botë, kanë bërë përpjekje që nëpërmjet projekteve të tyre t'i vënë në pikëpyetje si këto teori, ashtu edhe paragjykimet e ngulitura rreth konfliktit të kulturave, ideologjive, po edhe t'ia nënshtrojnë dyshimit përfytyrimet dhe figurat rreth dominimit botëror dhe shpërndarjes së fuqisë.

Një rast për studim: Grupi AES nga Moska, kështu, në të gjitha qytetet e botës gjatë performanseve të tyre përfton pamje virtuale të "ardhmërisë", duke i pasqyruar fantazmat, frikën dhe paragjykimet ndaj "Tjetrit" (më së shpeshti frikën nga islam i në civilizimin perëndimor: Qendra Georges Pompidou – Bauborg në Paris e mbuluar me qilima arabë, Statuja e Lirisë në Nju Jork që mban vellon, etj.), për të bërë në Beograd një seri kartolinash që pasqyrojnë frikën e serbëve nga nataliteti shqiptar dhe zgjerimi territorial i tyre.


Nga ana tjetër, artistët si Mërgjan Bajiq përpilen që t'i rishqyrtojnë vlerat ideologjike dhe postulatet mbi të cilat qëndronte Jugosllavia e Titos, si dhe transformimin e tyre gjatë të nëntëdhjetave. Në kuadër të projektit Yugomuzeu, ai



AES, Beograd

"ndërton" rreth tridhjetë artefakte – objekte muzeale, me të cilat i rikujton bartësit themelorë simbolikë të idesë së socializmit vetëgoverisës, siç është dinari me portretin e Alia Sirotanovicit, zdrukthi nga Brionet në të cilin ka punuar Shoku Tito, Jovanka Broz, një relief në allçi i maleve e lumenjve të RSFJ-së, punim i nxënësve të klasës VII3 të SHF "Gavrillo Princip" i dhuruar Josip Broz Titos me rastin e zgjedhjes anëtar nderi i SANU (ASSHA), reagimet e fudbollistëve të Hajdukut e Crvena Zvezda-s në stadiumin Polud në Split pas marrjes së lajmit përvdekjen e Titos. Nga ana tjetër, të gjitha këtyre artefakteve u janë shtuar edhe


simbolet gjegjëse të kohës së shpërbërjes së vendit, siç është veshja në të cilën Slobodan Milosheviq e kishte vizituar Kosovën për të fundit herë, makina e shkrimit në të cilën është shtypur Memorandumi i SANU, trungjet e bartura nga rruga Obrovac-Knin, trarë të djegur kulmesh të shtëpive nga rruga J.J. Strossmayer në Vukovar, etj.




Mediacioni midis modelesh kulturore të ndryshme

Është i orientuar te vendosja e lidhjeve mes individëve e grupeve që i përkasin dhe përfaqësojnë rëndom një nga tre modelet kulturore dominante. Nga njëra anë, ata janë individë që në mënyrë aktive, pra kreative, i kontribuojnë rritjes së fondit të përgjithshëm të të ashtuquajturate forma elitare të artit e kulturës, ose të paktën janë të lidhur me receptimin e saj. Nga ana tjetër, janë këta individë dhe grupe për të cilët më të rëndësishmet janë format e kulturës së masave (filmi, muzika popolare, krijimtaria, video, stripi, moda, etj.), përderisa nga ana e tretë janë ata që janë ende në një masë më të madhe a më të vogël të lidhur me format e të ash-

tuquajturës kulturë tradicionale (festat popullore, krijimtaria folklorike, zakonet popullore, gojëdhënat e të ngashme me këto). Me këtë tip mediacioni rëndom bëhen përpjekje të arrihet jo vetëm ndërlidhja e formave të gatshme të të tri modele brenda një koncepti të vetëm, por edhe hibridizimi i tyre, pra përfitimi i një kolazhi, gërshtimi simultan, citimi, dekontekstualizimi ose rikontekstualizimi inventiv. Qëllim përfundimtar është, zakonisht, ndërlidhja komunikuese dhe hapësinore e individëve dhe grupeve rreth përbajtjeve ndaj të cilave, të paktën potentialisht, secili prej tyre ndjen një afëri dhe njohje. Risia dhe e papritura, "distanca e perspektivës" do të duhej të shpinin te një të kuptuar më të mirë të modelit dominant, të cilit individi ose grupi i përkasin, por njësoj edhe te pranimi i bashkekzistencës dhe vlefshmërisë së modeleve të tjera, të cilat në kohën e sotme as që janë të patra as të ndara.



Mërgjan Bajiq: Makina në të cilën është shtypur memorandumi



Një rast për studim: Biblioteka 'Vlladimir Nazor' në lagjen periferike zagrebase, Vrapçe, ka organizuar në mars të vitit 2003 ekspozitën "Traperice!" ("Pantallonat jeans", vër. e për.). Ekspozita është përpjekur të prezantojë aspekte të ndryshme kulturologjike të këtij elementi të veshjes: rruga e pantallonave nga pantallonat e punëtorëve deri te tavolina disenjatore e modës së lartë; pantallonat në letërsi (e ashtuquajtura prozë në pantallona) dhe në art (Andy Warhol, Peter Blake, Vlado Martek, Stefan Lupino); pantallonat sot (Type 1 Jeans i Levis-it, tipi më i ri), pantallonat si objekt i kreativitetit individual (intervenimet në pantallona – ngjyrosja, prerja, vizatimi, etj.); jeans-pantallonat në muzikën pop. Moto e ekspozitës ishin fjalët e shkrimitarit gjerman, Ulrich Plenzdorfit: "Jeans-at janë një botëkuptim, e jo thjesht pantallona!" Autore e ekspozitës ishte Ruzhica Cindori, ndërsa përgatitjen e eksponateve për ekspozitën e ka bërë Zelko Vrhovski.

Një rast për studim: Skulptorja zagrebase, Sanja Sasho, në veprën e saj merret në mënyrë sistematike me relacionet midis riteve, ritualeve dhe zakoneve popullore. Kështu, në muajin prill të vitit 2003, në malin Talashçak në Hrushçevac Pushqanski pranë Zagrebit, e organizoi happening-un "Zjarri i Kuçedrës". Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë shumë njerëz nga vetë ai vend me rrethinë, përderisa vizitorët nga Zagrebi kishin ardhur me autobusë të posaçëm.

"Njerëzit masivisht po i nënshترون përsëri ngasjes së meditimit, antropozofisë, biobukës, eko-mishit, etnomuzikës dhe kampeve të mbijetesës. Një fuqi primigjene e fishkur brenda nesh këlthet dhe do të na nxjerrë nga kjo xhungël disharmonie, dhune, vrazhdësie, izolimi, vdekjeje. Shumë thjesht: mali, zjarri, po afrohet data e Shën Gjergjit; Shën Gjergji e ka vrarë kuçedrën. Në tempereturë prej 1-5 gradë Celsius i premë shelqjet e verdha, pranë përrenjve rrëzë malit Talashçak, dhe i bartëm në majë. I futëm tetëmbëdhjetë hunj prej akacieve në dhe rrëth tyre e ndërtuan një bishë, ashtu sic thureshin dikur shportat. E mbaruan pas dy ditësh, të

ndjekur nga një erë e stuhishme, të dielën, para nate, kur filloi edhe borë të bjerë. Dhe pastaj gjithçka mori zgjidhje me një rregullsi natyrore: pushçanasit ndeznin zjarre për Shëngjergj, anëtarët e SHKA Hrushçevic Kuplenski u binin rrotull zjarreve të veshur në të bardha, me degë të gjelbra, për ta sfiduar Gjergjin e gjelbër. Jozha Fa lozta në kuruzë; kësaj here ka luajtur me miqtë e tij këngë cigane të Shëngjergjit. Zoran Vukiq dhe "Vrtileti"-të mjeshtërisht lozin e bëjnë akrobaci me zjarrin, ndërsa vendasit dhe Boshku janë të lumtur që në malin e tyre u shfaq kuçdra. Kuçedrën, ndërkaq, duhet djegur për ta asgjësuar ashtu të kegen dhe për të hyrë ashtu të pastër në verë. Sanja Sasho."

Format terapeutike të mediacionit

Format terapeutike të mediacionit janë të orientuara më së shpeshti drejt individëve te të cilët ekziston një defekt i caktuar shëndetësor, psikologjik, emocional, një problem, ngecje në zhvillim. Ndonjëherë bëhet fjalë për trauma të rënda dhe çregullime të shkaktuara nga shkaqe të jashtme: lufta, familja e shkatërruar, rrrezkimi social a material, nga forma të ndryshme të dhunës a keqtrajtimit fizik, psikik, seksual. Nga ana tjetër, shkaqet mund të jenë edhe të natyrës së brendshme: ngecje në zhvillimin intelektual dhe emocional, të meta dhe çregullime të të folurit, mospërshtatshmëria sociale, sëmundjet psikike. Në të dy rastet shfrytëzohen metoda të ndryshme të punës individuale e grupore, të cilat rëndom përdorin edhe forma artistike të shprehjes (p.sh. pikturnimin, lojën me vegla muzikore, shkrimin, aktrimin) për ta kthyer ndjenjën e sigurisë, të pranimit, çlirimtë emocional, por edhe për diagnostifikimin e shkallës dhe natyrës së dëmtimit, po edhe për zhvillimin e aftësive të individit që me ekspcionin kreativ ai vetë ta ndriçojë, pranojë ose ta tejkalojë problemin themelor ose traumën. Për fat të keq, lufta dhe pësimet e luftës e kanë aktualizuar këtë formë mediacioni posaçërisht në hapësirat e Bosnjës e Hercegovinës dhe Kroacisë (fëmijët – viktima luftë; gratë e dhunuara;

UNESCO report

The Music Therapy Department at the Pavarotti Music Centre (PMC) offers a clinical music therapy service to the community of Mostar and surrounding areas. The children and young people who attend music therapy come from all over the Mostar area regardless of their ethnic or cultural background.


Each week, approximately 85 children, adolescents and young adults attend music therapy sessions. The music therapists work with all parts of the community receiving referrals from psychologists, social workers, speech therapists, teachers and parents. Close collaboration with various local institutions, organisations and projects is held.

The music therapy services include individual and group therapy sessions for children, adolescents and young adults aged 2-35 to address psychological trauma, challenging or aggressive behaviours, emotional/psychological disorders, psychiatric disorders, learning disorders, developmental delays, mental/physical disabilities, hearing/visual impairments, etc.

The music services also include family therapy, self-support groups for professionals, counselling and education of professionals. The therapists act as ongoing advisors, providing support to professionals, teachers and caregivers on matters relating to Post-Traumatic Stress Disorder (PTSD) and other areas.

Music therapy is based on the understanding that everyone has the potential to respond to and express themselves through music. Everyone can be drawn into active music-making to form a musical relationship with another person.

The music therapy techniques used include clinical improvisational models. Music improvisations are used as the chief means of assessment and treatment, whereby clients are encouraged to express themselves non-verbally through the spontaneous creation of music. In improvised music-making, the therapist will often accompany the client's music to provide containment and structure in the client's musical expression.



In the progress of therapy, the clients will be supported to verbally reflect on the created music, to acknowledge and express their emotions and to share their experiences with the therapists. The musical relationship will continue to help maintaining the essential trust for therapeutic processes between the client and therapist.

The therapists address the individual needs and strengths of their clients to encourage emotional healing and appropriate re-integration of coping mechanisms. Research has shown that the positive experiences that occur in a music therapy setting can lead to an increase in the client's self-esteem, an improved ability to have meaningful relationship with others, an increase in independence and growth in emotional expression.

Clients are seen in either individual or group settings. In group settings, the clients may develop their ability and learn with the therapist's support of how to communicate with others, to interact and relate with others, to listen to others and to develop their leadership skills.

All music therapists abide to ethic codes of confidentiality. What occurs during music therapy sessions remains confidential between the client, therapist and assistant. This confidentiality is crucial in order to build a trusting relationship through which therapy can develop.

personat që vuajnë nga PTSD – çrregullimet e stresit posttraumatik, personat e zhvendosur dhe të dëbuar). Mediacioni i dedikuar këtyre individëve shpesh ka tipare tepër të theksuara interkulturore, sepse është i orientuar te pranimi i bashkëjetesës së përhershme të grupeve etnike të ndryshme dhe pjesëtarëve të tyre, qoftë të kenë qenë pjesëmarrës në konflikt ose të janë viktima lufte. Me të, po ashtu, bëhen përpjekje që t'u lehtësohet këtyre individëve që ta gjejnë veten në mjjedise thelbësishët të ndryshuara kulturore, etnike dhe sociale ku ata aktualisht jetojnë.


Një rast për studim: Programi terapeutik muzikor i Qendrës Muzikore Pavarotti në Mostar

Është një rast më i rrallë i shfrytëzimit të mediacionit terapeutik në kushtet grupore, ku pikërisht komunikimi grupor, si dhe vendosja e kontakteve midis grupeve, është qëllim dhe synim themelor i mediacionit. Me të, problemet e "ndrydhura" të komunitetit, frustrimet grupore dhe individuale, si dhe temat e lëna mbas dore ose të heshtura, shpërfaqen dhe bëhen të pranishme. Njëkohësisht bëhen përpjekje për gjetjen edhe të zgjidhjeve konkrete për probleme më të gjera shoqërore, zakonisht me simulime dhe inskenime, me të cilat synohet thellimi i ndjenjës së vetëbesimit tek akterët e veçantë shoqërorë ose te grupe të tëra, si dhe të arrihet qasja kritike dhe objektive në hulumtimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e po atyre problemeve. Gjithsesi, si një formë më e njojur mediacioni të këtillë tashmë është përmendor Teatri i të Shtypurit i Boalosë.

Një rast për studim: Cultural Confrontation Workshop is the long term project that joins together cultural, political, legal and civic activism and collective theatre therapy. The project started on November 15th 2001 when the first Cultural Confrontation Workshop was held. Since then, the project has been going on approximately once a month in Theater EXIT in Zagreb. However, as the goal of the project is to introduce structural and practical changes both within cultural

institutions and in people's way of understanding theatre as one means in achieving changes in society, the workshop have spread into other towns in Croatia (Tupole, Rijeka, Karlovac, Plashki) and Bosnia and Hercegovina (Mostar).

The Workshop participants, all volunteers and theater amateurs from different professions and various age, ethnic, gender and religious groups, during three days of preparation together with theatre professionals like actors Vili Matula, theatre directors (Goran Golovko, Matko Raguzh, Ivica Boban and Rene Medveshek), also with the project director and theatrologist Natasha Govedic, meet to prepare and stage various collective social/political dramas or injustices occurring mostly in Croatia. These mini-dramas are directly negotiated from the participants' experience and existential and/or political problems and they are articulated through the process of theatrical methodology. The methodology is specifically transferred from



100

Augusto Boal, the civic activist and theatre director with twenty five years of international experience. In this kind of social performance, the audience itself turns into active participants in the event, by choosing and staging the traumatic events they find the most painful points of contemporary Croatian political, social, economical and cultural life. The audience learns how to negotiate social and personal conflicts and how to solve them without "magic" or violence. Therefore, the trauma is confronted, discussed and oftentimes turned into healing experience. Public debate over collective problems also includes interdisciplinary collaboration within the groups of participants and from the theatre audience itself. Everybody is invited and welcomed to join the workshop, regardless of sex, age, class, ethnic background or theatre experience.

Mediacioni i lidhur me grupet me nevoja të veçanta

Mediacioni i lidhur me grupet me nevoja të veçanta ka për qëllim që grupe të ndryshme – të cilat në Evropën Juglindore rëndom janë jashtëzakonisht të marginalizuara dhe të padukshme – siç janë ato me handikape fizike ose psikike, të integrohen nëpërmjet proceseve të animacionit socio-kulturor në komunitetin lokal, dhe që gradualisht t'u ofrojë mundësinë që të përfshihen edhe në veprimtari më të gjera shoqërore.

Një shembull më i thjeshtë e një angazhimi të këtillë është ndërtimi i platformave që shpiejnë në vendvotime, që personave me të meta fizike t'u mundësohet që nëpërmjet votimit të ushtrojnë ndikim në formësimin e komunitetit shoqëror ku jetojnë, që do të duhej të ishte një detyrë e pamohueshme e politikës publike dhe pushtetive publike. Megjithatë, pa lobimin e sektorit civil në asnjë mëjdis kjo e drejtë nuk do të aktualizohej dot.

Qasja te përbajtjet kulturore ndonjëherë është e vështirësuar jo vetëm nga barri-

erat hapësinore, por, si në rastin kur kemi të bëjmë me persona me dëgjim të dëm-
tuar, edhe me pamundësinë për t'i përcjellë ato të arritura artistike dhe programe
mediale që bazohen mbi mesazhet verbale. Prandaj, tetarot dhe mediat TV do të
duhej ta mundësojnë përkthimin simultan për shurdhmemecët, që është praktikë në
botë të paktën në ditë të caktuara, ndërsa kur është fjala për lajmet – përkthehet
të paktën një emision në ditë.

Një hap tjetër edhe më i rëndësishëm i mediacionit është të mundësojë që këto
grupe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e krijimtarisë, duke realizuar
projekte artistike individuale dhe kolektive, siç janë muralet, qeramika, tapiceria,
ngjarjet muzikore dhe teatrore e të ngjashme, në komunitet me artistët që kanë



102

ndjeshmëri ndaj punës ekipore dhe ndaj mundësive nga më të ndryshmet të kësaj
popullate aq diverse.

Një rast për studim: Rruga 5a, teatri feminist i Zorica Jevremoviq, në aparta-
mentin e Qendrës Autonome të Grave, ka shfaqur gjatë viteve 1997-1998 shfaqjen
teatrorë "Vajzat pëshpëritëse", në të cilën pjesëmarrëse ishin vetëm vajzat-invalide
në karrocë. Kështu, ato janë përfshirë në procese të ndryshme shoqërore, që nga
ato kulturore-artistike (pjesëmarrja si mysafirë në festivalin në Slloveni), gjer tek
ato sociale (integrimi në ekipin e plotë të teatrit feminist dhe mundësia për të
punuar jashtë rrethit të myllur të invalidëve). Me t'u bërë publikisht të dukshme
nëpërmjet shumë shkrimesh në shtyp dhe media, ato e bënë të ditur tërthorazi
marginilizimin dhe përjashtimin nga shoqëria të personave me të meta trupore.

Mediacioni i lidhur me grupet me identitet minoritar dhe specifik

Mediacioni i lidhur me grupet me identitet minoritar dhe specifik ka për qëllim t'i
bëjë me dije pushtetit publik dhe opinionit të gjithmbarshëm se ekzistonjë grupe
të popullatës për të cilat nuk dihet ose nuk dëshirohet të dihet, të cilave (në
mënyrë aktive a pasive) nuk u njihet e drejta për çfarëdo forme të mbështetjes sis-
temore dhe afirmimit, dhe kështu atyre u mohohen të drejtat themelore njerëzore
dhe kulturore.

Aty para së gjithash kemi të bëjmë me pjesëtarët e subkulturave të veçanta (siç
janë grupet punk, rap, heavymetal, pjesëtarët e techno subkulturës, etj.), pastaj
me pjesëtarët e të ashtuquajturave minoritete seksuale (homoseksualët, lezbiket,
biseksualët, transvestitët, transesksualët), por edhe me pjesëtarët e grupeve
etnike, të cilat janë shumë të vogla në numër ose ndaj të cilave shprehet një qen-
drim i marginizimit të fuqishëm social (p.sh. vllehat, cincarët, romët), e gjer te
pjesëtarët e cilitdo grupi tjetër në krijim e sipër, që ndërgjegjësohet dhe dëshiron




Pamje nga parada gay në Beograd
30 qershor 2001. e diel

ta fitojë të drejtën e shfaqjes publike, të veprimtarisë dhe afirmimit shoqëror (p.sh. antiglobalistët, narkomanët që i janë nënshtuar trajtimit mjekësor dhe të tjerët).

Paradat gay në Beograd e Zagreb që janë mbajtur gjatë vitit 2001, respektivisht 2002,

ishin të përcjella me skena mosdurimi e dhune, kështu që akterët kryesorë ishin policët, të cilët në Beograd nuk arritin të pengojnë dhunën e huliganëve mbi pjesëmarrësit në paradë, përderisa në Zagreb, duke mësuar nga përvaja beogradase, ishin ndërmarrë masa të posaçme që një gjë e tillë të mos ndodhë.

Edhe këtu të bërit publikisht i dukshëm është një nga qëllimet primare të media-cionit. Për këtë qëllim shfrytëzohen mjete që kanë jehonë të fuqishme mediale,



Pamje nga parada gay në Zagreb
29 qershor 2002. e shtunë

pjesëmarrës të shumtë ose publik të gjerë, siç janë për shembull parada gay, koncerte pop e rock, rave party, performimi muzikor në rrugë. Mirëpo, të tilla mund të janë edhe grafitet, aksionet publike të protestës, paraqitja në media; e gjithë kjo ka për qëllim të arrijë të ashtuquajturin "shok pozitiv" dhe ta pakësojë "panikun moral", me të cilët gradualisht bëhet e mundshme që mësuar nga fashitë refuzimin ndaj grupit, si dhe ndaj sjelljes dhe nevojave që i shprehin dhe i ushtrojnë anëtarët e tij. Është interesante të përmendet se pjesa më e madhe e grupeve subkulturore i ka të definuara, dhe ndonjëherë edhe të zhvilluara, format e shprehjes vetjake, madje edhe të veprimit publik. Megjithatë, menjëherë mbas fillimit të veprimit tarisë, shfaqet nevoja për shfrytëzimin e një infrastrukturë të caktuar (p.sh. të klubeve dhe vendtubimeve), si dhe të një mbështetjeje më të përhershme të disa formave të punës (p.sh. botimi i një magazine të ithtarëve), ç'gjë do të duhej ta mbështeste pushteti lokal, por që gati rregullisht nuk e bën.

Që këndej, për veprimit tarisë e këtyre grupeve janë të një rëndësie të veçantë projektit më ambicioze, të cilat në mënyrë komplekse dhe ambicioze, nga aspekti komunikues të pranueshme dhe të kuptueshme, hedhin drithë mbi problemet e tyre themelore, e theksojnë të drejtën e të qenimit të tyre, si dhe theksojnë kontributin e tyre ndaj pluralitetit dhe diversitetit të shoqërisë dhe skenës kulturore. Si shembull i një aksioni të tillë ambicioz shih Shtojcën nr. 8, në faqen 174 të programit Queer Zagreb. Nëse bëhet fjalë për shkelje ose mohim serioz të të drejtave njerëzore dhe kulturore, jo vetëm që ndërmerrën aksione komplekse që e kombinojnë fushatën publike me projektet artistike dhe kulturore (p.sh. festivalet e filmit gay dhe të lezbikeve), por njëkohësisht organizohen edhe debate publike me kërkesa konkrete për ndryshimin e statusit shoqëror të përgjithshëm të këtyre grupeve. Kërkesat e tillë mund të shkojnë gjë te ndryshimi i legjislativit ekzistues (p.sh. të ligjit mbi familjen ose të ligjit për të drejtat e pakicave nacionale dhe komuniteteve etnike). Qëllim përfundimtar është të sigurohen kushte të volitshme për ekzistencën e tyre të gjithmbarshme, si dhe pranimi i plotë social.

Mediacioni i lidhur me grupet e marginalizuara në hapësirë ose me grupet e izoluara

Mediacioni i lidhur me grupet e marginalizuara në hapësirë ose me grupet e izoluara ka për qëllim më së shpeshti që këto grupe të popullatës, shpesh edhe të tregzikuara nga aspekti social, t'i përfshijë në jetën shoqërore dhe kulturore të komunitetit më të gjerë. Kjo rëndom bëhet nëpërmjet projekteve artistike të community art-it ose programeve të animimit socio-kulturor – sot më së shpeshti të performuara me emrin: arti për ndryshimet sociale (Art for social change).



Artistët dhe aktivistët e organizatave joqeveritare shkojnë në periferi, vendbanime refugjatësh, lagje dhe hapësira urbane të lëna mbas dore, dhe atje hyjnë në interaksion të drejtpërdrejtë me popullatën, duke krijuar projekte me të cilat ua kthejnë dinjitetin si ambientit, ashtu edhe popullatës. Këto projekte, krahas vullnetit të mirë dhe iniciativës së vetë artistëve, kërkojnë edhe njohje të madhe të mjeshtërise komunikuese, sepse grupet shoqërore të marginalizuara shpesh shfaqin edhe rezistencë ndaj atyre që vijnë me "projekte", që për një afat kohor të shkurtër të bëjnë diçka që më shumë i promovon ata vetë se sa komunitetin lokal. Prandaj, mediacioni kërkon një punë afatgjatë me të cilën do të bëhej rikonstruimi i një-mendtë social dhe urban i këtyre hapësirave me qëllim të homogenizimit të populatës dhe hapësirave të komuniteteve lokale. Rreth kësaj të shihet më shumë në Shtojcën nr. 6 mbi projektin FLUX, në fq. 167, i cili ka përfaqësuar punimet e artistëve bashkëkohorë në paralagjet beogradase.

Veçanërisht të shpeshta janë projektet e punëtorive skenike, të arteve figurative dhe muzikore, me të cilat nëpërmjet hulumtimeve (oral history) banorët nxiten për pjesëmarrje aktive në formësimin e aksioneve artistike të ardhshme, ose që ata vetë të marrin vendime lidhur me natyrën dhe metodën me të cilën do të bëhen intervenimet artistike. A duhet që një hapësirë e lënë mbasdore të shndërrohet në

park, vend ku lozin fëmijët ose vendtakim ku do të realizoheshin disa projekte artistike (si p.sh. skulpturat nga hedhurinat, etj.)? Është e rëndësishme edhe nëse një grup banorësh, me ndihmën e artistëve dhe aktivistëve, ka ndonjë ide më të fuqishme si të ndryshojë thelbi i aktivitetit në atë rajon, qoftë me krijimin e qendrave prodhuase të reja (punëtori zejtare artistike të qeramikës, të thurjes, suvenireve, etj.), ose me kërkesën për hapjen e një qendre kulturore, që projekti më pas të vazhdojë si një projekt i lobimit dhe përpjekjeve për t'i bindur pushtetet publike që ta mundësojnë hapjen e një qendre a institucioni të tillë.

Një rast për studim: Maja Bajeviq – instalim procesual në Muzeun e Vendit në kuadër të Ekspozitës III vjetore të Qendrës për Artin Bashkëkohor, "Kujdes! Punime!", Sarajevë, 1999.

Në instalimin shumështesor, ku me tëresinë e projektit përpiquej ta vëré theksin te karakteri i mbyllur i Muzeut për qytetarët dhe nevoja e hapjes së tij ndaj opinionit,



Maja Bajeviq ia ka dhënë një kuptim më të thellë këtij projekti duke përfshirë si akterë të tij edhe gratë e veja, refugjate nga Srebrenica. Ato, në veshjen e tyre të rëndomtë, ditë të tëra kanë thurur punët e tyre të dorës në skelet para fasadës së Muzeut, duke krijuar midis tyre dhe publikut një "perde" që rrëfente për paduksh-mërinë e tyre reale, megjithëse fati tragjik i Qytetit është i njojur për opinionin. Bashkëpunimi i artistes dhe grave të Srebrenicës ka vazhduar tutje dhe ka rezultuar edhe me projekte artistike të tjera (punime në video), duke ua kthyer ashtu vetëdien për veten dhe duke ua kthyer zërin dhe prezencën publike.

Qëllimet metodike dhe detyrat e medacionit interkulturor

Qëllimet:

Pranimi i medacionit interkulturor si "filozofi e sjelljes" qendrore të organizatës joqeveritare, posaçërisht brenda kontekstit shoqëror e kulturor të Bosnjës e Hercegovinës.

Përvetësimi i formave dhe teknikave themelore të medacionit interkulturor, si gjatë konceptualizimit të projektit, ashtu dhe veçanërisht gjatë zbatimit dhe prezentimit të tij para opinionit të veçantë dhe atij të përgjithshëm.

Ndërmarrja e iniciativave që e problematizojnë vëllimin, kualitetin, karakterin e hapur dhe produktivitetin e komunikimit të individëve dhe grupeve, të cilat ndërkaq – pa projekte dhe ngjarje të tillë medacioni – nuk do të binin në kontakt. Shfrytëzimi i medacionit interkulturor për ngritjen e kualitetit të përgjithshëm të jetës, posaçërisht të grupeve të veçuara dhe të marginalizuara.

Analiza e përvojave dhe të arriturave të iniciativave dhe projekteve të medacionit interkulturor për definimin më të mirë të qëllimeve dhe prioriteteve të politikave publike (posaçërisht të atyre kulturore, arsimore, sociale), si dhe të harmonizimit të veprimtarisë së të tre sektorëve për zgjidhjen e çështjeve më të rëndësishme të mjedisit lokal.

Detyrat:

Mendoni, cili grup shoqëror në mjedisin tuaj ka nevojë për ndihmë dhe cilat formë medacionit do t'i propozonit për integrimin dhe afirmimin e tyre social. Në cilën mënyrë dhe në çfarë formash të medacionit do të vërit në kontakt pjesëtarët e grupeve, të cilat pa dëshirë ose fare nuk kanë kontakte të ndërsjella ose komunikim të ndërsjellë.

Përcaktojini format e medacionit që kanë rëndësi të veçantë dhe janë frysëzuese për punën e përgjithshme të organizatës suaj. Shpjegojini arsyet dhe përpikuni që në punën grupore të definoni projektet e ardhshme me të cilat do të realizoheshin idetë tuaja.

Përcaktojini qëllimet që do të duhej t'i arrinte medacioni interkulturor në jetën kulturore dhe shoqërore të komunitetit tuaj lokal.

Fjalët çelës:

Animimi socio-kulturor presupozon punën e përbashkët të artistëve, aktivistëve dhe banorëve të një mjedisit në projektet artistike, mediale dhe të tjera, për zgjidhjen e problemeve të komunitetit ku jetojnë, si dhe për zhvillimin e vetëdijes për nevojën e mendimit kritik dhe vendimmarres në të gjitha fushat e jetës shoqërore, po edhe nevojën e pjesëmarrjes personale – aktive dhe kreative – në jetën kulturore dhe shoqërore të komunitetit. Termi para së gjithash përdoret në Francë.

Animatori është një lloj i tillë i aktivistit kulturor që lëviz nëpër të gjitha nivelet e hierarkisë shoqërore dhe nëpër të gjitha fushat e veprimtarisë. Ai ndihmon që të përmirësohet komunikimi midis sistemeve të ndryshme, i ndihmon partnerët e tij që ta formësojnë identitetin dhe projektet, me një fjalë – i orienton aksionet. Politikat kulturore të regjioneve dhe komunave prodhojnë një varg të tërë animatorësh, siç

janë instruktorët, menaxherët, mediatorët, komunikatorët, etj. Vitaliteti i tyre është një nga çelësat e suksesit të politikës kulturore dhe demokracisë kulturore. Mund t'i falënderojmë, pjesërisht, edhe ata pse politika kulturore nuk është më vetëm një zë që përmban pajisjet, por edhe investim në njerëz.

Community art, respektivisht art for social change është term që përdoret për projektet artistike që kanë për qëllim të ndërtojnë dhe zhvillojnë komunitetin, me pjesëmarrjen e popullatës lokale, me qëllim integrimin e komunitetit rreth zgjidhjes së problemeve të përgjithshme. Termi para së gjithash përdoret në Britaninë e Madhe.

Aksioni kulturor është një varg aktivitetesh të ndërlidhura reciprokisht me të cilat dëshirohet të arrihet një qëllim preciz dhe i matshëm në zhvillimin kulturor. Më së shpeshti zhvillohet në bashkëpunim midis sektorit civil dhe publik, të cilët dëshironë të realizojnë një ndryshim pozitiv shoqëror dhe kulturor.

Punëtoritë: një punë interaktive e intencionale me grupin, e udhëhequr me kompetencë, e cila e ka edhe funksionin e saj edukativ dhe praktik, sepse aty nuk është pikë nismëtare një zgjidhje e caktuar a priori e ndonjë problemi, por te kjo zgjidhje arrihet gradualisht, me metoda të ndryshme (brainstorming, lojëra simulimi, punë kreative, debate, etj.).

Teatri i të shtypurit (Augusto Boal) është një bashkësi metodash teatrore të punës së profesionistëve me publikun dhe jo-publikun, ashtu që problemin, të cilin e definojnë dhe deri në një masë e zhvillojnë aktorët dhe regjisoret, gjatë vetë shfaqjes atë e korrigjon, e ndryshon dhe e përplotëson publiku. Metodat më të njohura të punës të këtij modeli të veprimtarisë teatrore janë: teatri i padukshëm (për publikun e rastësishëm në rrugë dhe sheshe, të pavetëdijshëm se është i pranishëm në një ngjarje pozitive), teatri forum (publiku debaton gjatë shfaqjes që ndërpritet për të diskutuar) dhe dramaturgjia simultane (kur publiku del në skenë, i merr mbi vete rolet dhe e përfundon veprimin sipas vullnetit të tij).

Intervenimet artistike janë ato projekte të artistëve, të cilat në mjetet e realizohen e fusin frymën e provokimit, të vënies në pyetje, sfidës.

Queer teoria përbëhet nga një varg idesh që bazohen te qëndrimi se identitetet nuk janë të fiksuar dhe ato nuk e përcaktojnë çfarësinë e akëcilit. Ajo konsideron se nuk është e mundshme të flitet në një kuptim të përgjithshëm për "mashkullin" ose "gruan", meqenëse identiteti përbëhet nga një shumësi elementesh që nuk mund të reduktohen në çfarëdo forme tiparesh kolektive të përcaktuara që më parë. Në këtë kuptim, me këtë teori edhe përcaktimet që kanë të bëjnë me tiparet për shembull të homoseksualëve ose lezbikeve janë pikë së pari pjesë e zgjedhjes së tyre, prandaj edhe konsiderohen arbitrale. Pjesërisht, ihtarët e kësaj teorie insistojnë në elementet përfshirëse të çdo identiteti, përkundër atyre që janë distinktive.

Nënkulturat përfaqësojnë tiparet e grupeve shoqërore të caktuara, të cilat i karakterizojnë qëndrimet, vlerat, gjedhet e sjelljes dhe karakteristikat stilistike, ndërsa shërbejnë për të bërë dallimin e këtij grupi si nga grupet dominante shoqërore (kulturat elitare dhe kulturat tradicionale), ashtu edhe nga nënkkulturat e tjera. Nënkkulturat kanë filluar të artikulohen si një trend posaçërisht në të shprehurit e grupeve shoqërore rinore që nga vitet gjashtëdhjetë të shekullit XX (hipikët, tedsat, modsat, pankerët, rokerët, raperët, etj.).

Literatura:

- Augusto Boal. *Pozorište potlacenog (Teatri i të shtypurit)*. Gradina, Niš, 1984.
Meeting point. *Katalog i Ekspozitës I vjetore të Saros Qendrës për Artin Bashkëkohor*, Sarajevo, 1997.
Katalog i Ekspozitës II vjetore të Saros Qendrës për Artin Bashkëkohor, Sarajevo, 1998.
Benjamin Perosavic. *Urbana plemena (Fiset urbane)*. Hrvatska sveučilišna naklada, Zagreb, 2001.
Bulletin, Creakm. *Creativite et Handicap Mental*, Liege, www.creakm.be
Brislin R., Yoshida T. *Intercultural communication training: an introduction*. Sage publications, London, 1994.
Fowler M., Mumford G.M. *Intercultural source book: cross-cultural training methods*. USA, Intercultural Press, 1995.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR REGIONAL,
PARTNERITETI DHE RRJETËZIMI

PENGESAT, BLLOKADAT DHE FAKTORËT JO TË VOLITSHËM PËR VENDOSJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR KULTUROR NË REGJION

Gati dhjetë vjet transicioni kanë shkaktuar shtresëzime shumë të mëdha mbinacionale dhe regjionale – posaçërisht midis Evropës Qendrore dhe asaj Lindore, kështu që ishte e domosdoshme të merren në konsideratë edhe identifikimet dhe ndarjet nënregjionale. Në këtë sens duhet theksuar në mënyrë të veçantë Vendet Baltike dhe vendet e Evropës Juglindore. Në rastin e të parave, qëllimi themelor i ndarjes (nga konglomerati i Evropës Lindore) ishte lidhshmëria interregjionale, respektivisht përfshirja në korpusin e vendeve të Evropës Qendrore, të cilat janë vlerësuar si vende me perspektivë nga pikëpamja e integrimeve. Përkundër kësaj, identifikimi i nënregjionit të Evropës Juglindore në themel ishte një indikator i prapambetjes së tyre dhe ndarjes nga shembujt e suksesshëm integrues-transitorë, megjithëse një numër i madh i tyre, qoftë për nga tradita qoftë për nga pozita gjeografike, në një kohë ishin të përfshira brenda konceptit të Evropës Qendrore, posaçërisht Kroacia, po edhe Serbia (Vojvodina), Rumania (Transilvania), por edhe Bosnja e Hercegovina.

Kjo ndarje prej ca kohësh është thelluar edhe më me diversifikimin e mëtejmë të regjionit në Ballkanin Lindor dhe Perëndimor, sipas të cilit vendet e Ballkanit Lindor (Rumania dhe Bullgaria) janë pranuar si anëtarë potenciale me prioritet të Bashkimit Evropian. Meqenëse vendet e tjera, duke përjashtuar këtu Greqinë dhe Turqinë, në një periudhë më të gjatë kohore kanë patur një fat politik të njëjtë, ndërsa gjatë transpcionit ishin të përfshira në konflikte luftarakë ose ishin skena të shkatërrimeve të luftës, të situatave konfliktuale dhe veprimeve terroriste; janë etiketuar si vende me hipoteka politike të rënda, respektivisht si vende që identitetin e tyre e bazojnë para së gjithash te gjendjet e pazgjidhura konfliktuale. Që paradoksi të jetë edhe më i madh, nëse përjashtohet Shqipëria, këto vende kishin me decenie kontakte, këmbime dhe bashkëpunim të përhershëm kulturor. Nuk çudit,

prandaj, që si qëllim primar në regjion (kur është fjala për vendet e Ballkanit Perëndimor) edhe më tej konsiderohen pacifikimi, demilitarizimi radikal dhe afatgjatë, procesi i pajtimit dhe i vendosjes së bashkëpunimit konstruktiv dhe të barabartë.

Parakusht për zhvillimin e programeve regjionale të bashkëpunimit kulturor janë: Vendosja e modeleve shtetërore të qëndrueshme e stabile, krahas respektimit të të drejtave dhe të arriturave të plota demokratike; Të bazuarit e politikave publike themelore (para së gjithash të atyre arsimore, kulturore, sociale, informative, etj.) mbi parimin e respektimit të plotë të diversitetit kulturor të individëve dhe grupeve; Zgjidhja e çështjes së decentralizimit dhe regionalizimit politik brendashtetëror funksional dhe zhvillimor.

Jo vetëm që këto parakushte nuk janë zgjidhur, por ekzistojnë edhe probleme të tjera të shumta midis shteteve në regjion, të cilat edhe më tepër e pengojnë vendosjen e rrjedhave të drejtpërdrejta të komunikimit kulturor, siç janë:

Mosekzistimi i strategjive të bashkëpunimit ndërkombëtar në regjion
Regjimi i vizave
Komunikacioni ndërshtetëror i rënduar, i ngadalshëm dhe jofunksional
Ngecja në bashkëpunimin ekonomik
Ndjenja e pasigurisë personale dhe e mosbesimit, si dhe të barrierave psikologjike të shkaktuara nga ngjarjet e luftës, por edhe nga kriza ekonomike, të cilat i kontribuojnë pakësimit të kontaktave, komunikimit kulturor dhe shkëmbimit në regjion.

Megjithëse objektivisht ekziston një kapital i madh i përbashkët i kujtesës dhe kulturës, afersia linguistike dhe një bazë potenciale resursesh për forma të suksesshme

bashkëpunimi në trajtë njohjesh profesionale, lidhshmërisë së dikurshme institucionale, të formave dhe instrumenteve të bashkëpunimit që ekzistonin deri para pak kohësh (shkëmbimi i studentëve, mundësia e studimit jashtë mjedisit domicil, revistat e të njashme), e gjithë kjo gati sa nuk shfrytëzohet fare, por në pjesën më të madhe mbetet një pjesë e kujtesës individuale dhe kolektive dhe vetëm e një bashkëpunimi sporadik.

Duke pasur parasysh gjithçka që u tha më lart, nuk është e vërtetë që ekziston i njëjtë interes, as përvoja të njëjta, as nevoja të njëjta përvendosjen e bashkëpunimit reciprok me se cilën palë njësoj. Këtë, fundja, e vërtetojnë edhe hulumtimet, siç është ai i bërë nga Laura Shakaja i titulluar "Stereotipat e zgregbasve të rinj për Ballkanin – kontribut për studimin e gjeografisë imagjinare", ku në mënyrë të përbledhur theksohet:


Edhe pse Ballkani në vetëdijen e të rinjve të Zagrebit përgjithësitet dhe thjeshtëzohet, ai në çdo pikëpamje është aq afër përzagrebasit për tu perceptuar në mënyrë homogjene. Në hartën mentale të Ballkanit, të cilën zgrebasit e kanë në vetëdije – Ballkani është i ndarë në zona. Mund t'i identifikojmë këto zona imagjinare: 1. zona e prekjes së drejtëpërdrejtë dhe e kontaktit më të afërt kulturo/gjuhësor – ajo është zonë e Tjetrit jo të plotë. Në atë zonë përftohen marrëdhëniet më emotive, për këtë arsy e ajo është burimi më aktiv i stereotipave (Serbia, Jugosllavia, BeH); 2. zona e injorimit ose indiferencës – për të dihet fare pak, por mbi të përihapet një imazh (i përgjithësuar) negativ i krijuar në zonën e parë (Rumania, Bullgaria, Maqedonia); 3. zona jashtë sistemit simbolik/vlerësues, zona e prishjes së kanoneve – zona e plotësisht Tjetrit (Turqia, Shqipëria); 4. jo-Ballkani në Siujdhesën Ballkanike – e vetmja zonë e perceptimit pozitiv (Greqia). Gjithsesi, zonat imagjinare nuk kanë kufij stabilë. Kufijtë e tyre janë labërguar, ndërsa vetë zonat mund të janë me ndërprerje. (Revija za Sociologiju/Revista për sociologjinë/, vol. 32, nr.1-2, 2001, fq.27)

Njëkohësisht, hulumtimet e të njëjtës autore theksojnë edhe mungesën e përvojës personale të nxënësve të shkollës së mesme të Zagrebit në kontakt, të drejtpërdrejtë hapësirën dhe njerëzit e Evropës Juglindore, ndërsa numri i kontakteve të drejtpërdrejta me vendet e Evropës Perëndimore është relativisht i lartë. (Me hulumtim kanë qenë të përfshirë 395 nxënës të viteve përfundimtare të shkollave të mesme të ndryshme në Zagreb).


Tabela 4. Rolli i përvojës në vlerësimin e një vendi

Nëntë vendet më të dëshirueshme për të jetuar	Pjesëmarja e personave që kanë qëndruar në vend në numrin përgjithshëm të personave që kanë cekur vendin si një nga tre më të dëshirueshmit (%)	Nëntë vendet më të padëshirueshme për të jetuar	Pjesëmarja e personave që kanë qëndruar në vend në numrin përgjithshëm të personave që kanë cekur vendin si një nga tre më të padëshirueshmit (%)
1 Italia	69,8	Jugosllavia	0,7
2 Franca	35,8	Shqipëria	0,0
3 Britania e Madhe	13,9	BeH	11,1
4 Spanja	42,2	Maqedonia	0,0
5 Gjermania	47,8	Bjellorusia	0,0
6 Zvicra	10,0	Rusia	0,0
7 Holanda	3,9	Bulgaria	2,6
8 Austria	56,1	Turqia	0,0
9 Monako	5,4	Ukraina	0,0


6. Hapësira e Evropës si eksperience



1. Vendet evropiane sipas nivelit të dëshirës për të jetuar në to



3. Hapësira që perceptohet si Evropë



PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E INICIATIVAVE NDËRKOMBËTARE NË REGJION

Meqenëse vendet e regjionit objektivisht, përfat të keq, ende nuk janë akterë të vendosjes së bashkëpunimit konstruktiv ndërkombëtar, këtë rol në pjesën më të madhe e merr mbi vete komuniteti ndërkombëtar në formë të ndryshme. Programi Pakti i Stabilitetit pa dyshim që përfaqëson dokumentin kornizë më të rëndësishëm, por edhe strategjinë e bashkëpunimit që duhet të realizohet nëpërmjet dhjetë tryezave të punës, prej të cilave asnjëra nuk e mbulon fushën e kulturës. Megjithatë, nëpërmjet tryezave të punës për arsimin, mediat dhe të drejtat e njeriut, iniciativat e mediacionit interkulturor kanë arritur të fitojnë një mbështetje të caktuar.

Njëkohësisht, organizata të shumta, si Kultur-Kontakti austriak, Pro Helvetia zvicerane ose Fondacioni Kulturor Evropian, UNESCO, Këshilli i Evropës, Fondi për Shoqëri të Hapur në Budapest (programi për kulturën dhe artin), u kushtojnë një vëmendje

të madhe projekteve të bashkëpunimit të ndërsjellë të artistëve, si dhe projekteve të ndihmës për institucionet lokale dhe organizatat joqeveritare në regjion – çfarë përfaqëson një nga priorititetet e tyre themelore të veprimit që nga fundi i viteve nentëdhjetë. Duke iu falenderuar këtyre programeve, një numër i madh artistësh nga i gjithë regjioni kanë arritur të vendosin kontakte, shpesh edhe rreth projekteve që janë shfaqur edhe jashtë këtij territori.

Edhe organizatat tjera të Evropës Perëndimore janë përfshirë në këtë trend, siç janë shumë organizata humanitare, agjenci nationale, Agjencia Evropiane për Rikonstrukcion dhe Zhvillim, të cilat si parakusht të ndihmës së tyre për ndonjë organizatë në regjion shtrojnë kërkesën që projekti, i cili zhvillohet, të marrë karakter regional dhe të përfshijë të paktën disa partnerë nga më shumë vende.


Një rast për studim: Kryeqyteti kulturor i Evropës – Weimar 1999, nëpërmjet programit Kultura dhe Konflikti, ka inicuar një program specifik të vendosjes së lidhjeve midis artistëve ballkanikë, i cili ka rezultuar edhe me aksionin Ballkan art gjeneratori, i zhvilluar në Bruxelles në vitin 2000, i cili atë vit ishte kryeqyteti evropian i kulturës i radhës. Në eksposítë janë prezentuar 16 artistë, si dhe 12 institucione dhe organizata nga 8 vende të regjionit.

Në këtë shembull mund të vërehen mirë edhe përparrësitë edhe problemet që dalin gjatë konceptualizimit dhe realizimit të projekteve të inicuara nga jashtë. Vetë “seleksionimi” i 12 organizatave ishte fryt i rastësisë dhe rrethanave (pjese-marrja në konferencën e Sarajevës në dhjetor të vitit 1999 – Conference for Reinstating Cultural Co-operation in South-East Europe), ndërsa përzgjedhja e artistëve i ka paraprirë konceptit artistik të ekspozitës, i cili është definuar më vonë, si kusht i realizimit hapësinor të saj.

Ky program, për arsyte të mangësive të tilla, nuk e ka arritur në tërësi qëllimin e dëshiruar dhe nuk ka ngjallur interes të mjaftueshëm të opinionit evroperëndimor

për artin e Evropës Juglindore. Organizatori nga Bruxellesi nuk ka vepruar si një partner i vërtetë i rrjetit, të cilin në thelb as që e ka njojur, ashtu që nuk i ka kryer aktivitetet e domosdoshme të marketingut. Njëkohësisht, 12 organizata balkanike as bashkërisht, po as individualisht, nuk i kanë shfrytëzuar madje as resurset e ambasadave të tyre ose të kolegëve të paktën – prandaj edhe kjo qe një nga arsyet pse eksposta kaloi gati e pavërejtur. Megjithatë, projekti i ka fuqizuar lidhjet tanimë ekzistuese midis këtyre 12 institucioneve partnere nga regjioni (pjesa më e madhe kishte që më parë një bashkëpunim dhe një njojje reciproke), prandaj i ka kontribuar zhvillimit të mëtejnjë të marrëdhënieve të partneritetit midis një pjese të organizatave dhe artistëve të përfshirë në projekt.

Si konkluzion mund të thuhet se të rralla janë ato vende si hapësira e Evropës Juglindore ku periudha transitore e ka dëshmuar rëndësinë e organizatave ndërkombëtare për zhvillimin madje edhe të një bashkëpunimi regional më modest. Në të



vërtetë, akterë të tjerë ose nuk kishte, ose nuk kishin dëshirë të bashkëpunonin, ose moduset e bashkëpunimit që disa prej tyre ua propozonin shumë të tjerëve ishin të papranueshme. Në të njëjtën kohë, po kjo periudhë ka treguar se edhe vetë organizatat ndërkombëtare shumë shpesh këtë formë bashkëpunimi e përjetojnë si një mjet kyç për promovimin vetjak, si mundësi fitimi të ardharash shtesë, të cilat nuk do t'i siguronin pa referencën se, ja, po merren me një regjion në krizë, po edhe si një mjet të përshtatshëm për transferin e dijes, e cila nuk është vlerësuar që më parë në një masë kritike të mjaftueshme si e nevojshme dhe adekuate për kushtet lokale. Vendimtare ishte, pra, rëndom strategjia e përgjithshme afariste e vet organizatave ndërkombëtare. Rezultat e kësaj është theksi mbi implementimin e dijeve dhe përvojave që, ç'është e vërteta, ndoshta japid rezultate të mira apo të dukshme në disa mqedise të tjera, por nuk kanë gjasa të mëdha për një efekt të tillë në vendet e këtij regjioni. Mungesa e bashkërenditjes së tyre reciproke më të fuqishme dhe mënyrës strategjike të veprimit ka krijuar paradoksin që mjetet relativisht të rëndësishme që i investojnë të mos i realizojnë as për së afërmri rezultatet e pritura, të mos i zhvillojnë resurset lokale (posaçërisht ato njerëzore dhe organizative) në bazë të përhershme dhe sistemore, si dhe të vendosin bashkëpunimin që më shumë krijohet në baza interesit nga jashtë se nga nevojat e njëmenda dhe dëshirat e akterëve dhe praktikantëve lokalë.

Daljen nga kriza sui generis të iniciativave ndërkombëtare në regjion, e cila, është me rëndësi të përmendet edhe një herë, nuk është aq e natyrës financiare sa e asaj konceptuale dhe e natyrës strategjike-koordinuese-planifikuese, duhet kërkuar, siç duket, para së gjithash te një partneritet dhe bashkëpunim i barabartë, i hapur dhe i orientuar drejt rezultateve. Një sjellje e tillë e ndryshuar, nga të dyja palët, do të duhej të synonte realizimin e parametrave të qëndrueshmërisë dhe kualitetit të lartë të veprimtarive, iniciativave dhe projekteve të përbashkëta kyçë.

PARTNERITETI

Marrëdhëniet e partneritetit mund të zhvillohen në nivele të ndryshme dhe të marrin forma plotësisht të ndryshme. Ato mund të burojnë nga nevoja e organizatës që mangësitë e saj t'i kompensojë duke gjurmuar një partner që i ka pikërisht ato dije, mjete a informacione. Përkundër kësaj, një organizatë mund të dëshirojë që dijet, përvojat, energjinë, kontaktet, por edhe mjetet, t'i shtojë duke i investuar në projekte të reja, edhe më ambicioze, në mqedise ku mungojnë të gjitha këto. Edhe në njërin edhe në rastin tjetër partneriteti presupozon këmbimin dhe fer-plej-in, sepse vetëm mbi këto baza mund të ndërtohet një marrëdhënie e suksesshme afatgjatë, e cila do të rezultojë me projekte kualitative dhe efektive me interes për të dyja palët. Partneriteti është bërë sot një nga format më të dëshirueshme të bashkëpunimit, sepse në fushë të kulturës rritet konkurenca dhe numri i iniciativave, mjetet publike nuk rriten në mënyrë qenësore, ndërsa njëkohësisht organizatat ndërkombëtare, duke dashur të arrijnë efekte sinergjje, insistojnë pikërisht te ky tip i bashkëpunimit. Partneriteti mundëson njëkohësisht transferin e dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale nga një organizatë në tjetrën, që ka një rëndësi vendimtare për zhvillimin organizativ dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin joqeveritar.

Tipat më të njohur të partneritetit janë:

partneriteti reciprok – vendoset më së shpeshti midis organizatash të një ngjashmërie të lartë, të cilat merren me veprimtari të njëjtë (shkëmbimi i shfaqjeve të vallëzimit, p.sh.)
partneriteti komplementar – rëndom vendoset midis institucionesh që janë të ngjashme, por ofrojnë lloje të ndryshme shërbimesh (partner i përhershëm i një organizate joqeveritare që merret me koncerte dhe muzikë mund të jetë, p.sh., një studio grafike)


partneriteti multifunksional – krijohet kur në të gjitha fazat, që nga konceptioni i projektit gjer tek evaluimi i tij, partnerët merren vesh për të gjitha elementet kyç të tij dhe në të janë të përfshirë në baza të barabarta; shumë shpesh fjala është, p.sh., për ekspozita me kërkesa të mëdha - fjala vjen të artit digjital, të cilën mund ta përgatisin dy ose më tepër organizata mbi platformën e përbashkët të seleksionimit, jurisë, shtimit të mjeteve, etj.

partneriteti zinxhiror – zhvillohet rrëth idesë inicuese të një projekti të hapur, ashtu që parashikohet që secili nga partnerët themelorë inicues (të cilët janë të barabartë në projekt) do të gjejë partnerë shtesë për zgjerimin dhe zhvillimin e atij projekti.

partneriteti hierarkik – zhvillohet në situatat kur ekziston një jobarazpeshë midis partnerëve, prandaj njëri ose disa sish e marrin primatin në definimin, kontraktimin dhe udhëheqjen e projektit.

partneriteti i domosdoshëm – rëndom zë fill me kërkësë të një donatori potencial, megjithëse vetë organizatat nuk kanë dëshirë të veçantë ose ndonjë interes për bashkëpunim të ndërsjellë. Partneritetet e këtilla mund të prodhojnë edhe ndonjë projekt të suksesshëm, por ai rrallë rezulton me efekte afatgjata, më të thella dhe më të gjera.

Studimi i rastit të partneritetit zinxhiror: Projekti De valigia ka tubuar dhjetë organizatorë (organizata joqeveritare dhe institucionale të kulturës) nga dhjetë vende të Evropës, qëllim i të cilëve ishte realizimi i projektit të një ekspozite specifike të artit bashkëkohor në tren, i cili me "vagona nacionalë" do të udhëtojë nga Selaniku deri në Stokholm. Në çdo vend partneri lokal është dashur domosdo ta zhvillojë nënrrjetin e vet të partnerëve, i cili diku i përfshinte institucionet e tjera të kulturës, diku organizatën e hekurudhës, diku shtëpinë botuese, qendrën kompjuterike, etj., në varësi nga kapacitetet që mungonin, por të nevojshëm për realizimin e asaj faze të projektit.



Studimi i rastit të partneritetit komplementar:

Studimet e interkulturalitetit, menaxhmentit të artit dhe medacionit në Ballkan Universiteti i Artit në Beograd

Ky studim postdiplomik është zhvilluar me partnerë të shumtë nga regjioni. Universiteti i Artit në Beograd është bartës dhe realizues i proceseve mësimore, ndërsa partnerët e tjerë në këtë projekt ofrojnë shërbime llojesh të tjera – pikërisht ato që Universiteti nuk do të mund ti siguronte vetë. Kështu për shembull, ECUMEST nga Bukureshti, organizatë joqeveritare që është jashtëzakonisht aktive në proceset e vendosjes së lidhjeve midis të gjithë akterëve të kulturës në Rumani, paraqitet si organizator i qëndrimit studimor hulumtues të studentëve në Bukuresht. IMO, Institut i Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Zagrebi, nëpërmjet veprimtarive të rregullta kulturore të rjetit Culturelink (bazat e të dhënave, revista Culturelink, publikimet speciale, shërbime informacioni dhe konsultimi ad hoc) ia

siguron në mënyrë të përhershme mbështetjen informative kursit në tërësi. Nga ana tjetër, UNESCO, me seli në Pariz, jo vetëm që i ka dhënë mjetet për sigurimin e funksionimit të programit në nivelin regional (pjesëmarrja e studentëve nga Maqedonia, Rumania, Bosnja e Hercegovina, etj.), por ngashëm si Culturelinku ka dhënë donacion edhe për literaturën e domosdoshme për formimin e bibliotekës fillestare të kursit.

RRJETET

"Rrjeti nuk është
burokraci
hierarki
lob
iniciativë private
projekt i përkohshëm
asociacion, federatë, union
klub i mbyllur
Manifest e rrjeteve kulturore evropiane, Bruksel, 1997"

Të krijuara si përgjigje ndaj nevojës organike të artistëve dhe aktivistëve kulturore për bashkëpunim, rrjetet e kanë "rrjetëzuar" hapësirën kulturore evropiane gati në tërësi.

Zakonisht ekzistojnë disa qëllime konkrete me rastin e krijimit të rrjetit: ai është më së shpeshti një përgjigje ndaj domosdoshmërisë së ndihmës reciproke, nevojës së shpërthimit të izolimit, vendosjes së kontakteve dhe formulimit të aksionit të përbashkët. Ai shpesh është krijuar nga ndjenja e kufizimeve tek artistët dhe

aktivistët e OJQ-ve në mjedisin lokal, nga bindja se projekte dhe iniciativa të ngjashme mund të gjenden më lehtë jashtë kufijve të kornizave të ngushta nationale a lokale.

Rrjeti funksionon si:

Një sistem - platformë për shkëmbimin dhe përfthimin e qëndrimeve, mendimeve dhe ideve;

Qendër informative,

Sistem që mbron ose promovon interesat e përbashkëta të anëtarëve (lobi ndaj sferës politike, sferës publike, institucioneve profesionale dhe arsimore....);

Platformë për partneritete dhe mbështetje për zhvillimin e projekteve.

Pjesa më e madhe e rrjeteve në fushë të kulturës në Evropë i shpreh si vlera themelore - humanizmin, interkulturalizmin (sensibilitetin interkulturore), të drejtat e njeriut, e posaçërisht të drejtat për kulturë, etikën e punëtorëve të kulturës (artistëve, administratorëve dhe menaxherëve), profesionalizmin, me një theks të veçantë te përsosja permanente profesionale. Gatishmëria për t'i pranuar dallimet dhe toleranca janë komponentë të domosdoshëm për ndërtimin e rrjetit.

Konsiderohet se rrjetet duhet të veprojnë jashtë fushës së marrëveshjeve dhe bashkëpunimit ndërshtetëror, sepse ato janë emanacion i frysës së shoqërisë civile dhe nxitje për zhvillimin e saj. Megjithatë, edhe Këshilli i Evropës edhe Bashkimi Evropian e kanë hetuar te rrjetet një potencial kolosal për zhvillimin e hapësirës kulturore evropiane, po edhe të identitetit evropian. Për këtë arsy, Bashkimi Evropian nëpërmjet programeve të tij të shumta në mbështetje të krijuimtarisë e ka paraparë në mënyrë implicite edhe mbështetjen për rrjetet në kulturë, ndërsa Këshilli i Evropës me krijimin e Forumit të Rrjeteve Kulturore Evropiane, e mbështet zgorërimin dhe programet e tyre. Po ashtu, tanimë një numër politikash kulturore nationale e ka paraparë në instrumentet e veta edhe mbështetjen për participimin e artistëve dhe menaxherëve në kulturë dhe pjesëmarrjen në rrjetet evropiane të

kulturës (të jesh anëtarës shtesë relativisht e thjeshtë, por të jesh pjesëmarrës aktiv për disa organizata të vogla dhe individë shtesë gati e pamundshme nga aspekti financiar pa një fundraising shtesë).

Rrjetet më të njohura në fushë të kulturës në Evropë, por të rëndësishme për hapësirat e Evropës Juglindore janë: IETM (Takimi Joformal Teatror Evropian), MAG-DALENA (trupat teatrore të grave), EFAH (Forumi Evropian për Art dhe Trashëgiminë Kulturore), ENCATC (Rrjeti Evropian i Fakulteteve dhe Qendrave për Arsimitin e Menaxherëve në Kulturë), CIRCLE (Rrjeti Evropian i Qendrave Shkencore-Hulumtuese në Kulturë), ELIA (Liga Evropiane e Instituteve për Art), AMARC (Asociacioni i Radiostacioneve të Lira), Apollonia, european art exchanges, BALKANKULT (Beograd) i tubon aktivistët e OJQ-ve në domenin e zhvillimit kulturor nga hapësira e Evropës Juglindore, SEECAN (SouthEast European Contemporary Art Network), BAN, Balkan Art Network (Shkup), BAP (Balkan association of publishers), TransEvropa Hale (rrjeti i qendrave kulturore alternative në ish-ndërtesat industriale), Rrjeti Evropian i Qendrave Kulturore (qendrat kulturore prestigjioze), etj.

Një rast për studim: Rrjetet krijojnë rrjete – rrjeti Culturelink Culturelink, Rrjeti i të gjitha rrjeteve për hulumtime dhe bashkëpunim në zhvillimin kulturor, me qendër në Zagreb, i tubon të gjitha rrjetet dhe institucionet relevante nga mbarë bota në atë domen. Është krijuar nga kërkesa dhe nevoja e një numri të madh të rrjeteve kulturore në të gjitha kontinentet që ta koordinojnë më mirë punën e tyre, si dhe të ndërmarrin projekte që në një mënyrë më të mirë do t'i shfrytëzonin potencialet e tyre vetjake. Është themeluar në vitin 1989 në Paris, ndërsa themelues janë UNESCO dhe Këshilli i Evropës. Që nga themelimi i rrjetit Instituti për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Zagreb (IMO) është seli e tij.



Culturelink Network

Veprimtaria e rrjetit përfshin hulumtimet ndërkombëtare në kulturë, themelimin dhe zhvillimin e bazave të të dhënave rreth zhvillimit kulturor dhe bashkëpunimit, si dhe dalja e rregullt e revistës Culturelink.

Anëtarët e rrjetit Culturelink, përvèç rrjeteve që merren me zhvillimin kulturor dhe bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar, janë edhe institucionet hulumtuese, universitetet, institucionet kulturore të profileve të ndryshme (muzetë, bibliotekat, teatrot), qendrat informative dhe dokumentare, qendrat kulturore, fondacionet, shoqatat e artistëve, etj. Rrjeti aktualisht përfshin mbi 1000 institucione në 97 vende nga të gjitha kontinentet. Qëllimi i rrjetit është zhvillimi i komunikimit midis anëtarëve; mbledhja, përpunimi dhe diseminimi i informacioneve rreth politikave kulturore dhe zhvillimit kulturor në botë; mbështetja e projekteve të përbashkëta hulumtuese dhe të bashkëpunimit. Veprimtaria e rrjetit Culturelink bazohet te përaparimi i dialogut, shqyrtimi i praktikës kulturore dhe i politikave të zhvillimit kulturor.

Rrjeti më së shpeshti përfaqëson edhe një pikënisje për identifikimin e partnerit të ardhshëm më të përshtatshëm për realizimin e projekteve ndërkombëtare më të mëdha dhe më komplekse. Rrjeti është një stimul edhe për fundraisingun, prandaj jo vetëm që na jep informacione kujt t'i drejtohem, por edhe e rrit kredibilitetin tonë. Që nga momenti kur jemi pjesë e rrjetit, edhe te ne bartet një pjesë e imazhit të tij.

Studimi i rastit:

MIFOC (Mostar Intercultural Festival Organizing Committee), Mostar

MIFOC

Federata e Shoqatave të Qytetarëve

MIFOC është themeluar si një rrjet që përbashkon punën e disa organizatave

joqeveritare nga Mostari: Mladimost, Instituti Aletrnativ dhe ShkArt studio, si dhe dy organizatave joqeveritare nga Franca: Ura e Dytë dhe Gernika dhe njërs nga Spanja – Resources for Intercultural Animation.

Ajo strategjji rrjetëzimi ka mundësuar bartjen e përvojave dhe dijeve që në përpjekjet e para të vendosjes së aktiviteteve çelës të këtyre OJQ-ve të Mostarit. Në të vërtetë, aktivistët nga Franca dhe Spanja kanë ofruar ndihmë për ideimin konceptual dhe programor të veprimitarive të tyre, si dhe për themelimin e menaxhmentit të brendshëm. Vetë fakti që fjala është për një rrjet, e ka rritur kredibilitetin e të gjitha anëtarëve të tij te donatorët e huaj dhe ka mundësuar ashtu financimin, por edhe një program më të mirë të huaj për aksionin e përbashkët: Festivalin Ndërkombetar. Në të njëjtën kohë, aktivistët dhe artistët mostaras kanë patur mundësinë që ta prezantojnë punën e tyre edhe në mjediset prej nga vijnë anëtarët e tjerë të rrjetit, si dhe që në ato manifestime ndërkombe të vendosin lidhje të tjera dhe të gjejnë partnerë edhe jashtë këtij rrethi.

STRATEGJITË ZHVILLIMORE TË RRJETEVE

Strategjitet zhvillimore të rrjeteve presupozojnë disa faza:

Faza e forcimit të mirëbesimit

Zgjerimi i numrit të anëtarëve (prioritet numrit apo kualifikimit të anëtarëve)

Ideimi i strukturave të brendshme formale dhe joformale

Stimulimi i zhvillimit të institucioneve në regjionet dhe vendet ku rrjeti nuk ka anëtarë potencialë adekuatë.

Në punën e deritashme rrjetet kanë kontribuar për identifikimin e problemeve të shumta në jetën kulturore të Evropës, të mangësive në domenin e politikës kulturore, punës profesionale në kulturë, posaçërisht në fushën e bashkëpunimit ndërkombetar. Megjithatë, për një institucion të veçantë, organizatë joqeveritare ose individ i përfshirë në ndonjë rrjet evropian, më qenësor është fakti se rrjeti

është në të vërtetë një "vatër kreativiteti" – ai është nxitje për fryshtën sipërmarrëse, fryshtën e ballafaqimit me rrezikun dhe fryshtën e inovacionit. Natyrisht, rrjeti është edhe modë, por modë që duhet ditur të shfrytëzohet!

Një rast për studim: Cross radio

Cross radio është projekt i 9 radiostacioneve të pavarura nga hapësira e ish-Jugosllavisë, me qëllimin themelor të shkëmbimit të programeve në fushën e kulturës.

Cross territori

Radio 021, Novi Sad, e premte 19:30h (92.2MHz)

Radio Student, Zagreb, e premte 20h (100.5MHz)

Radio B92, Beograd, e premte 22h (92.5 MHz dhe 105.0 MHz - Vojvodinë)

Radio Student, Lubjanë, e shtunë 14:30h (89.3 MHz)

Studentski Radio eFM, Sarajevë, e shtunë 19h (106.5 MHz)

Radio Kojot, Zrenjanin, e shtunë 19h (107.3 MHz)

Radio Balkan, Banja Luka, e hënë 21h (95.9 MHz)

Radio Sombor, e martë 21h (90.9 MHz dhe 666 KHz)

Radio Studio 88, Mostar, e martë 18h (88 MHz)

info@crossradio.org, www.crossradio.org



BASHKËPUNIMI JASHTË KORNIZAVE LOKALE:

QËLLIMET METODIKE DHE DETYRAT

Qëllimet:

të hetohen potencialet themelore të bashkëpunimit ndërkombëtar kulturor të tashëm dhe të ardhshëm, si dhe të bëhet vetëdijesimi rreth pengesave themelore, si dhe përmenyrat e tejkalimit të tyre kur është fjalë për këtë formë bashkëpunimi të bëhet diagnostifikimi i tendencës themelore në bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar, si dhe të njihen jo vetëm kreatorët kyç të dinamikës kulturore evropiane dhe më gjërë, por edhe përbartësit më të rëndësishëm të mëtejshmë të po këtij bashkëpunimi, duke përfshirë programet e tyre dhe menyrat procedurale të funksionimit (p.sh. UNESCO, Këshilli i Evropës, organizatat dhe fondacionet ndërkombëtare dhe të ngjashme) të bëhet ndërgjegjësimi rreth domethënies së partneritetit dhe rrjetëzimit me orientim ndërkombëtar për zhvillimin e përgjithshëm kulturor si të mjedisit lokal, ashtu edhe të të gjitha vendeve të regionit, si dhe të përfshirjes së tyre të barabartë në bashkëpunimin kulturor ndërkombëtar të përgjithshëm evropian dhe jashtevropian
të sigurohet ndërtimi i kriterieve të larta artistike dhe organizative të domosdoshme për një bashkëpunim ndërkombëtar kulturor të suksesshëm

Detyrat:

Përcaktoni cilat kontakte ndërkombëtare dhe cilat forma të bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar i konsideroni posaçërisht të sukseshme në rastin tuaj ose në rastin e organizatës suaj, dhe përmendini arsyet që në këtë pikëpamje kanë qenë vendimtare

Përcaktojini format e partneritetit që janë më të përshtatshme për organizatën tuaj, pastaj bëni një plan vjetor të partneriteteve konkrete të mundshme

A do të kishte arsyet që disa nga organizatat joqeveritare në mjedisin tuaj të merrnin vendim që të lidhen në rrjetet e projekteve tuaja?

Mëndoni, cili nga rrjetet e propozuara evropiane dhe ballkanike do të mund të ishte me interes për t'ju ofruar ndihmë në realizimin e projekteve tuaja?

Fjalët çelës:

Rrjeti (network) – grupim individësh, organizatash, shoqata, i agjencive... të organizuara pa hierarki rreth problemeve, detyrave ose sfidave të përbashkëta dhe që e kryejnë punën e vet në menyrë aktive dhe sistematike, në bazë të përkushtimit të plotë dhe mirëbesimit reciprok.

Partneriteti – formë bashkëpunimi të definuar reciprokisht në menyrë precise, përtë cilin ekziston një marrëveshje paraprake, brenda të cilit zgjerohet edhe më tej baza (financiare, materiale, kadrovike) vetjake e resurseve (ajo ekzistuese ose ajo që ende mungon), kështu që sigurohet një kualitet më i lartë i veprimitarive bazë dhe atyre përcjellëse, si një prani më e gjërë brenda opinionit profesionist dhe atij më të gjërë. Me partneritetin njëkohësisht mundësohet transferi i dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale nga një organizatë në tjetren.

Literatura:

Evropske mire e kulture (Rrjetet evropiane të kulturës). Balkankult, Beograd, 2001.

Guide to the Culturelink Network (ed. Daniela Angelina Jelincic), Institute for International Relations, Zagreb, 2002.

Web sites të disa rrjetave kulturore evropiane:

Apolonia – www.apollonia-art-exchanges.com

Balcanis – www.balcanis.com

BALKANKULT – www.balkankult.org

BAN – personi për kontakt, Melentie Pandilovski, <http://www.scca.org.mk>

Banlieue d Europe – www.banlieues-europe.com

BAP – personi për kontakt, Zoran Harmonic, CLIO, Beograd, www.clio.org

Culturelink – www.culturelink.org

SEECAN

IETM – www.ietsm.com

EFIL (European Federation for Intercultural Learning) – www.afil.org/efil

SIETAR – Shoqëria Ndërkombëtare për Arsimin, Trajnimin dhe Hulumtimin Interkulturor, www.yfu.fi/~sietareu

Magdalena – rrjeti i grave në tetarin bashkëkohor, www.magdalena-project.org

VETËVLERËSIMI: SI TË SHQYRTOHET VETVETJA
DHE ZHVILLIMI VETJAK

PARAMETRAT INTERKULTURORË DHE KRITERET PËR VLERËSIMIN E SUKSESIT TË PUNËS SË OJQ-së

Kuptimi i punës dhe veprimtarisë së një organizate joqeveritare në mjedisin interkulturore është që ajo të arrijë një rezultat – një komunitet të hapur dhe tolerant, komunitetin e dialogut dhe të mirëkuptimit. Por, një rezultat i tillë nuk mund të arrihet në një afat të shkurtër. Për këtë arsy, organizata joqeveritare aktiviste duhet të bëjë një plan dhe program afatgjatë dhe që një herë në vit ta bëjë evaluimin e shkallës së realizimit të tij (*management by objectives*), duke vlerësuar deri në ç'masë realizohen nënqëllimet thelbësore, pa të cilat në të vërtetë as që ka zhvillim dhe përparim.

Evaluimi vjetor është i domosdoshëm, pra, për të vërtetuar nëse organizata joqeveritare është në rrugën e realizimit të detyrave të veta ose, nga arsyet ndryshme (ndonjëherë nën presionin e mbiqetesës: duke punuar në projekte për të cilat donatorët japid para, por të cilat nuk janë medoemos në qendër të interesimit dhe të rëndësishme për thelbin e veprimtarisë së OJQ-së, ose duke punuar në projekte që sigurojnë mjete), kanë shkuar në drejtim krejtësisht të kundërt nga misioni i vet fillestar. Për këtë arsy, do të ishte e dëshirueshme që – duke ftuar në rast nevoje edhe vlerësues të pavarur, të jashtëm – të verifikohet efektiviteti i punës së organizatës joqeveritare nëpërmjet shtatë parametrave çelës të cekur më poshtë, nga të cilët pesë të parët të lidhur me esencën e punës së saj, ndërsa dy më të fundit kanë të bëjnë me zotërimin e zhvillimit vetjak (që nuk është një qëllim në vetvete, por një parakusht që organizata të mund të merret në mënyrë më të lirë dhe më kreative me aktivitetet për të cilat edhe është themeluar).

Brenda çdo parametri është e nevojshme të konstatohet një numër i madh kriteresh, pastaj të përcaktohen treguesit matës të secilit prej tyre. Kështu, për shembull, në kuadër të parametrit të parë: Raporti ndaj komunitetit lokal dhe nxit-

ja e pluralizmit kulturor, kemi identifikuar gjashtë kriterë, për të cilat tanë çdo organizatë joqeveritare do të duhej t'i zhvillonte treguesit e vet. Kriteri i parë: përfshirja në punë e pjesëtarëve të grupeve tjera, posaçërisht atyre etnike, do të mund të vlerësohej nëpërmjet indikatorëve të numrit të pjesëtarëve të grupeve të tjera pakicë në anëtarësinë e OJQ-së, në programet e aktiviteteve të veçanta, si bashkëpunëtorë në aksione, por edhe të publikut në programe. Është më se e qartë se për këtë kriterin e parë do të mund të kishte katër tregues kuantitativë, e të mos flasim përfaktin se me një metodë më komplekse evaluimi do të mund të inkluadroheshin si indikatorë edhe ata që e bëjnë vlerësimin e kualitetit të pjesëmarjes së grupeve minoritare (nëse janë vetëm anëtarë përcjellës ose të tillë që marrin pjesë në krijimin e konceptit të programit dhe zhvillimit, etj.).

Në tekstin në vijim, pra, do të cekim vetëm parametrat dhe kriteret e evaluimit, duke ia lënë mundësinë se cilës organizatë joqeveritare që t'i ridefinojë, përplotësojë ose ndryshojë në pajtim me qëllimet e veta, duke zgjedhur indikatorë me metoda evaluimi sa më precise (të cilat, gjithsesi, duhet të elaborohen gjatë krijimit të Planit Strategjik.

Parametri I: Raporti ndaj komunitetit lokal dhe ndaj nxitjes së pluralizmit kulturor

Kriteret:

përfshirja në punë e pjesëtarëve të grupeve tjera, posaçërisht atyre etnike aktivitetet që e zgjerojnë hapësirën e komunikimit publik dhe dialogut interkulturore definimi dhe imponimi i temave të rëndësishme për zhvillimin e komunitetit lokal në tërësi shfrytëzimi i lokacioneve të ndryshme dhe resurseve hapësinore të komunitetit

puna në përmirësimin e statusit social e kulturor, veçanërisht të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara të popullatës
puna në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e solidaritetit, mirëkuptimit dhe mirëbesimit qytetar për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror

Parametri II: Ndikimi i OJQ në politikën kulturore në të gjitha nivelet

Kriteret:

aktivitetet që shpiejnë në mënyrën participuese të definimit të politikës kulturore, posaçërisht të asaj lokale
puna dhe realizimi i projekteve me qëllim të ndërlidhjes së të tre sektorëve (publik, privat, joqeveritar) në veprimtaritë kulturore
përfaqësimi i qasjes intersektoriale (p.sh. ndërlidhja e kulturës me arsimin, turizmin, mbrojtjen e mjedisit, sipërmarrjen, transportin dhe komunikimet, etj.)
aktivitete që e bëjnë vetëdijesimin e rolit të OJQ në zhvillimin kulturor dhe shoqëror
puna në definimin e qartë dhe zgjerimin e hapësirës së veprimit të pushteteve publike, posaçërisht të atyre nga fusha e kulturës
puna në ndërtimin e parametrave vlerësues dhe kriterieve të veprimit të pushteteve publike, si dhe të sektorit joqeveritar
puna në ndërlidhjen e niveleve të veprimit të politikës kulturore – shtetërore, regionale, lokale

Parametri III: Bashkëpunimi regional dhe ndërkombëtar

Kriteret:

përfshirja në projektet e veta edhe të aktivitetave të individëve dhe grupeve nga vende dhe mjedise të tjera

ndërmarrja e projekteve të përbashkëta me OJQ nga regjioni përfshirja në punë e rrjetet evropiane dhe regionale puna në vendosjen e lidhjeve midis OJQ në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar (projektet, rrjetet, koordinimet, etj.) përfshirja në programe dhe projekte e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe propozimi i programeve vetjake të ngjashme shfrytëzimi i bazës së resurseve regionale që mund të janë në dispozicion (baza kadrorike, informative, teknike) me qëllim të një pozicionimi më të mirë ndërkombëtar

Parametri IV: Realizimi i aktivitetave të decentralizuara

Kriteret:

organizimi i veprimit tarive dhe projekteve jashtë mjedisit të vet përfshirja e individëve dhe grupeve nga mjedise më pak të zhvilluara, pastaj të atyre me barrë të veçanta nga pësimet e luftës dhe konfliktet ndëretnike, në projektet e organizatës aktivitetet edukative në bartjen e dijeve që mund të janë të dobishme për OJQ të tjera, veçanërisht për ato të themeluara rishtazi ndërmarrja e projekteve që i shfrytëzojnë resurset, si të mjediseve më të mëdha, ashtu edhe të atyre më të vogla, ndërsa i dedikohen vendosjes së lidhjeve midis pjesëtarëve të grupeve shoqërore të ndryshme planifikimi i aktivitetave që mund të kenë efekte sistemore në hapësirën e vendit në kuptim të përmirësimit të komunikimit interkultural (një varg seminaresh, turneshë, seri ligjëratastë dislokuara, etj.)

Parametri V: Inovacioni dhe bartja e dijeve

Kriteret:

konceptimi dhe ndërmarrja e projekteve, përbajtja e të cilave i kënaq nevojat kulturnore dhe sociale të grupeve të ndryshme
 shfrytëzimi i formave të ndryshme të medacionit interkulturore
 vendosja e partneritetit dhe bashkëpunimit me OJQ të tjera me fusha të ngjashme
 veprimtarie
 rrjetëzimi në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar
 shfrytëzimi i medias dhe resurseve informative
 organizimi i aktiviteteve edukative nga fusha e komunikimit interkulturore
 ndërveprimi me institucionë të tjera të kulturës, ushtrimi i ndikimit mbi pushtetet publike

Parametri VI: Ngrija e aftësive organizative (capacity building)

Kriteret:

vetëreflektimi organizativ (definimi i vizionit, misionit, qëllimeve, etj.)
 shkalla e interiorizimit të vlerave dhe qëllimeve nga të gjithë anëtarët e organizatës
 kualiteti i komunikimit dhe i punës ekipore
 efikasiteti dhe saktësia në arritjen e qëllimeve
 struktura relevante organizative dhe udhëheqëse, si dhe mënyra e përshtatshme
 dhe e përpunuar mirë e funksionimit
 strategjitet zhvillimore të zgjedhura mirë
 aftësia e analizës së mjesdit, të nevojave të tij dhe tendencave në zhvillimin kulturor

Parametri VII: Arritura e qëndrueshmërisë

Kriteret:

llojillojshmëria e burimeve financiare
 aspekti i vetëfinancimit
 përfshirja e punës vullnetare
 shkalla e zhvillimit të dijeve lidhur me fundraising-un
 ekzistimi i një plani për zgjidhjen e parakushteve infrastrukturore dhe teknike të funksionimit
 ekzistimi i një plani për arsimimin e aktivistëve, si dhe ripërtëritja me anëtarë të rinj dhe me dije profesionale
 ekzistimi i një plani të marrëdhënieve me opinionin, si dhe të një plani marketingu.

Vlerësimi dhe vetëvlerësimi: qëllimet metodike dhe detyrat

Qëllimet:

sigurimi i kushteve për të gjykuar nëse organizata joqeveritare funksionon në pajtim me misionin dhe vizionin e vet, si dhe nëse e arrin efektivitetin dhe efikasitetin në veprimtarinë e saj
 të krijohet vetëdija për rëndësinë e përhershme të evaluimit të punës së përgjithshme të organizatës joqeveritare sipas një vargu të tërë parametresh të pranueshëm për organizatën në tërësi
 të zhvillohet vetëkritika në analizën e problemeve dhe vështirësive gjatë funksionimit, si dhe kultivimi i dialogut brenda organizatës dhe më gjerë për tejkalinin e tyre

të realizohet parimi i funksionimit të një organizate të "hapur" dhe të orientuar drejt ndryshimeve, me një ndjeshmëri për problemet dhe nevojat e komunitetit lokal

të zhvillohet nevoja për inovacione të përhershme në funksionimin e përgjithshëm të organizatës, të cilat do të janë të hapura ndaj propozimeve jo vetëm të anëtarëve të vet, por edhe të individëve e grupeve nga rrethi më i afërt dhe ai më i largët

Detyrat:

Përplotësojini parametrat dhe kriteret ekzistuese të evaluimit me listën e indikatorëve.

Përcaktojini metodat më të përshtatshme të evaluimit (vetevalimi, evaluimi ekstern; anketa, intervista grupore, intervistë me akterët kyç, analiza e shtypit, analiza e ndryshimeve në komunitetin lokal, politikën e saj kulturore, etj.).

Zbatojeni ose, sipas nevojës, adaptojeni pyetësorin për vetëvlerësim rreth shkallës së arritur të multikulturalitetit brenda OJQ-së suaj (shtojca nr. 3)

Fjalët çelës:

Qëndrueshmëria – aftësia e organizatës që me shfrytëzimin optimal të resurseve, si dhe me funksionimin organizativ në një inovacion të përhershëm, të veprojë në pajtim me misionin dhe vizionin vetjak, si dhe t'i përparojë gradualisht të gjitha elementet kyç të veprimtarisë për ta arritur ashu pavarësinë dhe stabilitetin.

Ngritja e kapaciteteve (capacity building) – ngritja e nivelit të përgjithshëm të dijeve dhe aftësive organizative (autoevalimi, planifikimi strategjik dhe menaxhmenti, shtimi i mjeteve, udhëheqja e organizatës dhe puna ekipore, etj.) të individëve të ndonjë organizate, të rëndësishme për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e saj.

Parametrat e evaluimit – përcaktuesit më të përgjithshëm vlerorë, të rëndësishëm për vlerësimin e shkallës së arritur të suksesit në funksionimin e ndonjë organizate, të cilët njëkohësisht shërbejnë edhe si qëllime të saj të realizueshme në praktikë.

Indikatorët e evaluimit – treguesit kuantitativë dhe kualitativë, me të cilët në një mënyrë relativisht të saktë dhe të sigurt mundësohet përcaktimi analistik i shkallës zhvillimore të organizatës, njësoj edhe të tendencave në zhvillimin e saj, po ato i vënë në dukje edhe aspektet themelore të volitshme, si dhe vështirësitë në funksionimin e saj të përgjithshëm.

LITERATURA

- Bennett, Tony. Cultural Policy and Cultural Diversity: Mapping the Policy Domain. Council of Europe, Strasbourg, 2001.
- Babic, Adolf. Civilno društvo i politički pluralizam. Omladinski kulturni centar, Zagreb, 1990.
- Biscoe, Adam. European Integration and the Maintenance of Regional Cultural Diversity: Symbiosis or Symbolism. *Regional Studies*, vol.35, no.1, p.57-64, 2001.
- Boal, Augusto. Pozorište potlacenog. Gradina, Niš, 1984.
- Brislin R., Yoshida T. Intercultural communication training: an introduction, Sage publications, London, 1994.
- Canivez, Patrice. Odgojiti gradjanina? Zagreb, Durieux, 1999.
- Council of Europe. Artists and Markets. Report on a Council of Europe Round Table in Budapest, Strasbourg, 1994.
- Cultural Policies in Europe. A Comparative Approach. Council of Europe, Strasbourg, 1998.
- Cultural Policies in Europe: A Compendium of Basic Facts and Trends. Council of Europe, ERICarts, Artcult Media, Bonn, 2000.
- Culture and Civil Society: New Relationship with the Third Sector. Council of Europe, Strasbourg, 2001.
- Culture: A Driving Force for Urban Tourism. Application of Experiences to Countries in Transition (Daniela Angelina Jelincic, ed.). Culturelink, Special Issue, 2002.
- Cune, Jean. Pour une ethique de la médiation (le sens des pratiques culturelles). Pug, Grenoble, 1999.
- D'Angelo, Mario. Cultural Policies in Europe. Local Issues. Council of Europe, Strasbourg, 2002.
- D'Angelo, Mario; Vesprini, Paul. Cultural Policies in Europe: Methods and Practices of Evaluation. Council of Europe, Strasbourg, 1999.
- Decentralization: Trends in European Cultural Policies. Council of Europe, Strasbourg, 2001.
- Differing Diversities. Cultural Policy and Cultural Diversity (ed. Tony Bennett). Council of Europe, Strasbourg, 2001.
- Differing Diversities. Transversal Study on the Theme of Cultural Policy and Cultural Diversity. Council of Europe, 2001.
- Dimitrijevic, Vojin et al. Kulturna prava. Beogradski centar za ljudska prava, Beograd, 1999.
- Dragicevic Šešić, Milena. Umetnost i alternativa. Institut za pozorište, film, radio i televiziju, Fakultet dramskih umetnosti, Beograd, 1992.
- Dragicevic Šešić, Milena; Stojkovic, Branimir. Kultura, menadžment, animacija, marketing, CLIO, Beograd, 2000.
- Dragojevic, Sanjin. Multikulturalizam, interkulturalizam, transkulturalizam, plurikulturalizam: suprotstavljeni ili nadopunjujuchi koncepti. U: Kultura, etnicnost, identitet (Jadranka Cacic-Kumpes, ur.). Institut za migracije i narodnosti, Naklada Jesenski i Turk, Hrvatsko sociološko društvo; str. 77'90, Zagreb, 1999.

Dragojevic, Sanjin. Process of Pacification in South-Eastern Europe. Challenges and Issues from Cultural Point of View. In: Culture and Social Cohesion in the New Millennium. CIRCLE/CCRN. Canadian Journal of Communication, vol.27, nos.2'3, p. 243-257, 2002.

European Council of Artists. Artists, Responsibility and Solidarity. Report from a conference in May 1997 in Genval, Belgium, ECA, Copenhagen, 1997.

Evropske mre e kulture. Balkankult, Beograd, 2001.

Federacija Bosna i Hercegovina: drava i civilno društvo (ur. Ivo anic). Zagreb, Erasmus Gilda, Novi Liber, 1995.

Fisher Rod. Arts Networking in Europe. International Arts Bureau & Arts Council of Great Britain, London, 1997.

Fowler M., Mumford G.M. Intercultural source book: cross-cultural training methods, USA, Intercultural Press, 1995.

Fukuyama, Francis. Kraj povijesti i posljednji covjek. Hrvatska sveuilišna naklada, Zagreb, 1994.

Global Culture. Theory, Media Society, vol. 7, nos. 2-3, 1990.

Guide to the Culturelink Network (ur. Daniela Angelina Jelincic). Institute for International Relations, Zagreb, 2002.

Hagoort, Giep. Art management, entrepreneurial style, Eburon, Utrecht School of Arts, Utrecht, 2000.

Huntington, Samuel P. The clash of civilizations and the remaking of the world order. Simon and Schuster, New York, 1996.

Ilczuk, Dorota. Cultural Citizenship: Civil Society and Cultural Policy in Europe. Boekmanstudies / CIRCLE, Amsterdam, 2001.

Jakšić, Bo idar, ured. Interkulturalnost versus rasizam i ksenofobija, Forum za etni?ke odnose, Beograd, 1998.

Javne i kulturne politike (ur. Milena Dragicevic-Šeši?). PALGO centar, Beograd, 2002.

Landry, Charles. Kulturna politika u Bosni i Hercegovini: Ekspertni izvještaj. Zajedništvo u razlikama: Kultura na raskrsnici u Bosni i Hercegovini. Vijeće Europe, Strasbourg, 2000.

Management of Cultural Pluralism in Europe (Janina W. Dacyl, ed.). UNESCO, Stockholm, 1995.

Manjine u Europi: dokumenti (priredili Andjelko Milardovic i Aleksandar Vukic). Institut za migracije i narodnosti, Zagreb, 1998.

Matrarasso, François; Landry, Charles. Balancing Act: 21 Strategic Dilemmas in Cultural Policy. Council of Europe, Strasbourg, 1999.

Morin Edgar. Kako misliti Europu. Svjetlost, Sarajevo, 1989.

Multicultural Reality and Perspectives in Croatia (Vjeran Katunarić, ed.). Interkultura, Zagreb, 1997.

Multiculturalism: A Critical Reader (David Theo Goldberg, ed.). Basil Blackwell Ltd., Cambridge Massachusetts, 1994.

Mundy, Simon. Cultural Policy: A Short Guide. Council of Europe, Strasbourg, 2002.

A Must or a Muse. Conference Results. Arts and Culture in Education: Policy and Practice in Europe. Culturnetwerk Nederland, Utrecht, 2002.

O'Sullivan, Noel. European Political Identity and the Problem of Cultural Diversity. Journal of Applied Philosophy, vol.17, no. 3, p. 237-247, 2000.

Perasovic, Benjamin. Urbana plemena. Hrvatska sveucilišna naklada, Zagreb, 2001.

Privatization and Culture. Experiences in the Arts, Heritage and Cultural Industries in Europe (Peter B. Boorsma, Anemoon van Hemel, Niki van der Wielen, eds.). Circle Publications No. 10, Kluwer Academic Publishers, Boston-Dordrecht-London, 1998.

Pyramid or Pillars: Unveiling the Status of Woman in Arts and Media Professions in Europe (Danielle Cliche, Ritva Mitchell and Andreas Joh. Wiesand, eds.). ERICarts-Zfkf, ArtCult Media, Bonn, 2000.

Redefining Cultural Identities. Collection of papers from the course on Redefining Cultural Identities: Multicultural Context of the Central European and Mediterranean Regions (Nada Švob-Djokic, ed.), Dubrovnik, 10-20 May 2000. Culturelink, Institute for International Relations, Zagreb, 2001.

Redefining Cultural Identities. Collection of papers from the course of Redefining Cultural Identities: Southeastern Europe (Nada Švob-?oki?, ed.), Dubrovnik, 14-19 May 2000. Culturelink, Institute for International Relations, Zagreb, 2001.

Stojanovic, Trajan. Balkanski svetovi, prva i poslednja Evropa. Equilibrium, Beograd, 1997.

Šakaja, Laura. Stereotipi mladih Zagrepčana o Balkanu – prilog proucavanju imaginarnе geografije. Revija za sociologiju, vol. 32, br. 1-2, 2001.

Šola, Tomislav. Marketing u muzejima ili O vrlini i kako je obznaniti. Hrvatsko muzejsko društvo, Zagreb, 2001.

The Challenges of Pluriculturality in Europe. Center for European Integration Studies (Susanne Baier-Allen, Ljubomir Cucic, eds.). Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden, 2000.

The European Task Force on Culture and Development. In From the Margins – a contribution to the debate on culture and development in Europe, Council of Europe ed., Strasbourg, 1997.

The Unity of Diversities. Cultural Co-operation in the European Union. (edited by The Parliamentary Group of the PSE European Parliament). Angelo Pontecorbo Editore, Florence, 2000.

The Unity of Diversities. Cultural Co-operation in the European Union. (edited by The Parliamentary Group of the PSE European Parliament). Angelo Pontecorbo Editore, Florence, 2001.

Todorova, Marija. Imaginarni Balkan. XX vek, Beograd, 1999.

Understanding of Europe. Training in cultural awareness and Its Peoples and Cultures. Europublic, Brussels, 1995.

Xenophobia and Post-Socialism (Mojca Pajnik, ed.). Peace Institute, Ljubljana, 2002.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1.

Pyetësor për bisedë grupore: Multikulturaliteti dhe të drejtat kulturore
(sipas pyetësorit nga libri: V. Dimitjević et al. Të drejtat kulturore. Qendra për të Drejtat e Njeriut, Beograd, 1999.)

Demografja

- a. A është në rritje, në rënje apo mbetet i njëjtë numri i pjesëtarëve të komunitetit tuaj (nacional) në komunën/vendin ku jetoni, gjatë viteve më të fundit?
- b. Cilat janë arsyet e një lëvizjeje të tillë demografike të popullatës që i përkasin komunitetit tuaj nacional? Emigracioni (çka e shkakton atë)? Çka e shkakton asimilimin me grupin shumicë? Ardhja e popullatës së re me përkatësi të ndryshme nacionale (prej nga vjen dhe ku vendoset)?

Mjetet e informimit

- a. Si i vlerësoni mjetet e informimit nga pikëshikimi i komunitetit tuaj? A e pasqyrojnë ato në mënyrë objektive gjendjen e tij dhe problemet dhe a i artikulojnë interesat e tij?
- b. A ekzistojnë stacione private të radios/TV-së, të cilat emetojnë program në gjuhën e komunitetit?
- c. A zhvillohet tërë programi në gjuhën e komunitetit tuaj ose aty janë të përfaqësuar më shumë gjuhë, të cilat fliten në mjedisin tuaj?
- d. Kush i kontrollon (nga pikëpamja pronësore dhe programore) mjetet e informimit dedikuar komunitetit tuaj?

e. A është shkalla e kontrollit shtetëror e ndryshme në rastin e mediave të shtypura (gazetat) dhe mediave elektronike (radio e televizion)?

f. Çfarë është prania e informacioneve nga pjesët e tjera të vendit? A është e domosdoshme një pajisje teknike e veçantë për përcjelljen e programit në TV (antena satelitore)?

Format e ndërlidhjes sociokulturore brenda komunitetit

- a. A ekzistojnë dhe cilat janë format e organizimit jopolitik (në bazë interes, civil, kulturor, OJQ) brenda komunitetit?
- b. Sa njërzë në raport me tëresinë e popullatës së komunitetit janë të perfshirë në veprimtarinë e tyre?
- c. Cilat janë aktivitetet më të rëndësishme të atyre formave jopolitike të veprimit?
- d. Me cilat probleme, vështirësi, pengesa ballafaqoheni në fushën e veprimtarisë jopolitike, respektivisht ndihmën dhe mbështetjen e kujt e gjzonit?
- e. A i tejkalojnë ato forma të veprimit jopolitik dhe në cilat raste kufijtë e komunitetit tuaj?
- f. Me cilat komunitete të tjera bashkëpunoni në fushën e veprimtarisë jopolitike (në bazë interes, civil, kulturor, OJQ)?

Praktika dhe format e interkuulturalizmit

- a. Në cilat situata në një masë të konsiderueshme dalin në pah (megjithëse latente) tensionet midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme? Festat nacionale/kishtare? Ndeshjet sportive? Manifestimet kulturore?
- b. Çfarë mendoni për të ashtuquajturit "manekenë të asimilimit" – personat që deri në vetëharresë e pranojnë kulturën/vlerat/gjuhën/ identitetin e komunitetit tjetër edhe pse me lindje nuk i përkasin? A janë ata oportunistë, karrieristë ose

para së gjithash persona për të cilët kufijtë e komunitetit të tyre janë tepër të ngushtë?

c. A është mbyllja në komunitetin e vet mënyrë e vetme për ta shhangur asimilimin?

A duhet kuptuar kjo si detyrim ose zgjedhje të lirë?

d. A e konsideroni të pranueshme mundësinë e kzystimit të identitetit plural, i cili, nëpërmjet për shembull identitetit regjional (p.sh. boshnjaku, hercegovasi), do t'i pajtonte/relativizonte identitetet e bazuara në përkatesinë nationale?

e. A krijon probleme midis komuniteteve vendosja e një numri më të madh refugjatësh (viteve më të fundit) në mjediset multikulturore, të cilat më parë nuk kanë ekzistuar?

f. Cilat janë pikat kritike/konfliktuote në marrëdhëniet midis vendësve dhe refugjatëve?

Garantimi i të drejtave kulturore

a. A konsideroni që u është garantuar e drejta për kulturën tuaj (në kuptimin juridik) në mënyrën gjegjëse? A vëreni tek ato rregulla juridike ndonjë lëshim a mangësi?

b. Çfarë do të ndryshonit/përplotësonit ju në garantimin e të drejtave kulturore?

c. Si realizohet faktikisht e drejta e garantuar kulturore?

d. A ekiston një shpërputhje dhe çfarë është ajo midis rregullimit juridik dhe shfrytëzimit real të këtyre të drejtave?

SHTOJCA 2.

Pyetësori për vetëvlerësim rreth shkallës së arritur të multikulturalitetit Brenda OJQ-së

Komunikimi

A dini se cilat grupe kulturore ekzistojnë në nivelin lokal, shtetëror ose regional?

A dëshironi të vendosni kontakte ose bashkëpunim me organizatat që nuk i përkasin komunitetit tuaj etnik?

A do të bashkëpononit me pjesëtarët e grupeve kulturore jodominante në mjedisin tuaj ose jashtë tij?

A do tëjenë materialet tuaja të marketingut (broshurat, pllakatet) të kuptueshme dhe atraktive edhe për pjesëtarët e grupeve të tjera?

A konsideroni që zhvillimi dhe ruajtja e diversitetit kulturor ka një rëndësi themelore për organizatën tuaj?

Përcaktimi i programit

A njihni individë dhe artiste kreativë e të dalluar nga grupi tjetër etnik, si dhe të tillë që afirmojnë dialogun dhe bashkëpunimin interkulturor?

A dëshironi të bashkëpunoni me ta?

A dëshironi të përfshiheni në zhvillimin e krijimtarisë kulturore të grupeve jodominante?

Politika e kuadrove

A janë aktivistët dhe bashkëpunëtorët tuaj nga grupe të ndryshme shoqërore?

A keni vullnetarë nga grupe të ndryshme shoqërore?

A është Këshilli Ekzekutiv i juaj i krijuar në baza multikulturore?

SHTOJCA 4.

SARAJEVO CENTER FOR CONTEMPORARY ARTS  CENTAR ZA SAVREMENU UMJETNOST SARAJEVO

Pjesa hyrëse e planit strategjik afatshkurtër të Qendrës për Artin Bashkëkohor, Sarajevë

Center for Contemporary Arts, Sarajevo

Obala Maka Dizdara 3
71000 Sarajevo

SCCA (Sarajevo Center for Contemporary Art) was founded by the Open Society Fund Bosnia and Herzegovina at the end of 1996. Since 2000, SCCA has operated as an independent, non-profit professional organization, led by a seven-member executive board.

STAFF

Dunja Blazević, director of the Center, completed Art History, Faculty of Arts, Belgrade

University;

Lejla Hodžić, visual art program coordinator, completed studies at the Academy of Fine Arts Sarajevo, Department of Graphic Design;

Enes Zlatar, video and new media program coordinator, Completed II Gymnasium;

Amra Bakić Čomo, video and new media program coordinator, Completed Comparative Literature and Information Science at Faculty of Art, Sarajevo University

ANNUAL PLAN 2003

The process of transition, which is still going on in the countries of Central and Eastern Europe, has hardly started in Bosnia and Herzegovina, destroyed by war, divided and politically stagnant. This has to do not only with the unavoidable political and economic transition, but also with the need for fundamental renewal, for which the necessary political will does not exist. Being in the situation with lack of system and cultural policy, SCCA is focused on keeping contemporary art alive by supporting new artistic production. It directs its attention towards the broadest, non-artistic public and to young people who, with education and opportunities to realize their own projects, become our potential future artists and members of a dedicated public.

INFO/DOC/EDU Center can be characterized by the following basic sub-programs/project elements, which are mutually complementary and frequently indivisible:

Art documentation - SCCA continues to collect and produce photo, slide and video documentation of all the exhibitions and individual artworks.

Professional library - continuity of subscriptions to 18 periodicals

Breakfast with... is a series of 30 encounters with guests from various fields of culture and art; every Saturday at 11:00, new guest on our program

Presentations and lectures - The focus of all of the 14 lectures/presentations will be young and middle-generation artists, and organizations/institutions that emerged in the final decade mainly from the region.

Workshops and seminars - Film history in my family, video workshops, project in collaboration with European Cultural Foundation; Computer literacy workshop series: Demystification of the computer and the Internet, workshop length - 2 days, frequency -8 times per year, Introduction to basic principles and ways of processing digital images, workshop length - 2 days, frequency -8 times per year, Fundamentals of compressions, CODEC formats and characteristics of digital images (static and moving), archiving techniques for digital formats—video/audio, databases, Workshop length - 1 day, offered 3 times per year, Audio information formats, Frequency - offered 2 times per year, Interactive multimedia presentations, workshop length - 2 days, frequency -2 times per year; a seminar History of video on the soil of the former Yugoslavia.

Exhibitions - SCCA is a "producer" of exhibitions, actions and manifestations. SCCA thematically conceives, realizes, documents; conceives and realizes projects in collaboration with other centres and institutions country and abroad; undertakes projects of other institutions that correspond conceptually with the program orientation of SCCA. The funds for 2003 exhibitions haven't been insured yet.

The following list of planned exhibition is still wishful thinking:

Question mark, environmental sound sculpture; authors: Darko Stanic & Vladimir Jaksic, Bosnian girl, photo project by Sejla Kamerić,

Glam? deaf dance, video installation by Danica Dakic, Bosnian artist living in Germany.

Roma stories, photo exhibition by photographers Nihad – Nino Pusija (Sarajevo) & Jovan Belov (Skopje). Both of them live in Berlin. Both of them as photographers and human rights activists continuously witness the Roma life, Pusija in Sarajevo, Belov in Skopje, Bosnian people thank to the International Community, installation / monument; author: Nebojsa Seric – Soba; Gene XX, installation and presentation of feminist works; author: Sanja Ivezkovic, the artist from Zagreb.

Multimedia and Video Production - SCCA/pro.ba, in the field of electronic/digital technology: produces and co-produces multimedia artworks - video, Internet, video installations; creates video and web documentation of all SCCA actions; distributes and organizes, domestically and abroad, presentations of works realized in these media, for this year, 15 independent productions are planned.

STRATEGY 2003 – 2006

SCCA presents its work for the donor market, to address the specific interests of potential donors for individual program segments. The survival of SCCA and the continuity of its essential activities is dependent on securing and maintaining stable partners who will support SCCA's projects financially; this means that they recognize not only the artistic merit, but also the cultural, social and political significance of SCCA in the development of a civil society in Bosnia and Herzegovina, as well as SCCA's contribution to a positive image of BH on the world stage.

Still, SCCA has not been able to find long-term partners or funders due to specific (chaotic) situation in the culture. Only with reliable partners, SCCA can count on the most important quality of such organization – continuity of the program; therefore it is impossible to make realistic business plan and strategy report.

SHORT DESCRIPTION OF THE REGIONAL EXPERTISE

SCCA is one of the founding members of the International Contemporary Art Network (ICAN), the successor of the network of Soros Centers for Contemporary Art; it is also one of the founding members of the Balkan Art Network (BAN). SCCA considers that its primary role is to be constantly engaged with its target groups, and does this on three basic levels: local « local, local « regional, local « international.

The activities of labs and art centres in South-Eastern European countries can be divided in three different areas: production, education and presentation. These three areas are a key for

future cooperation and exchange. Importance of this kind of regional cooperation is in comparing experiences, assets and future plans and wishes. The most important projects of every lab, representing the different faces of multimedia are case studies, and with a complete overview of regional situation in multimedia, better understanding of local community on perspectives on regional lever are going to emerge. The communication and development of joint programs among the centers is of great importance for their future development on the local, regional and international level.

REGIONAL DIMENSION

In the past five years (the amount of time the Center has existed), the Center has collaborated on numerous projects with institutions from Eastern Europe.

Main regional projects in 2003:

Balkan Konsulat, contemporary art from South-Eastern Europe / project in progress/, project conceived by: Margarethe Makovec and Anton Lederer, from the <rotor> Graz, and Lejla Hodzic from the SCCA Sarajevo.

< rotor > association for contemporary are the Balkan Konsulat during a year and a half. During the whole year 2003, Graz is the cultural capital of Europe, young curators from Belgrade, Prague, Istanbul, Budapest, Sarajevo, Vienna and St. Petersburg (Special) present different artistic positions in the Balkan Konsulat.

De/construction of the monument

The idea of this project is to get together the artists from former Yugoslavia who already deal with the subject of de/constructing of monuments and rewriting the history, to present their work, and to enable the future production. The project will be realized in several phases: 1st phase - exploration – visit to the regional centers, meeting the local artists; until September 2003 , 2nd phase - exhibition of existed works followed by conference and printed collection of the texts; December 2003, 3th phase - the exhibition of the new produced works followed by gathering of people from different fields who will encourage public debates; additional written material will be published as well as the catalogue and website; the end of 2004.

a.network

In March 2003 pro.ba formalized its efforts on the regional level and became a funding member of the a.network. a.network is a regional network of new media centers which are able to

produce, present,
and reflect on current state media/culture/technology and overall social development.
Mission of South East European network is to:
strengthen the sector of new media culture and make it's production more accessible to the
general public
to enhance its structure and increase visibility to the governing and funding bodies without
losing it's plasticity of: small-scale, modular, dynamic, networked constructs...
Founding members: Multimedia Institute, Zagreb, Croatia, Ljubljana Digital Media Lab,
Ljubljana, Slovenia (working within "KUD F. Presern"), Kuda.org, Novi Sad, Serbia and
Montenegro, pro.ba, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina (working within SCCA)

SHTOJCA 5.

Pyetësori vlerësuas i seminareve "Mediacioni Interkulturore"
të mbajtura në Mostar dhe Sarajevë

1. A u ka ndihmuar seminari që t'i kuptoni më thollë proceset e shkuara dhe të tanishme në Ballkan (stereotipat, paragjykimet, komunitetet e identitetit dhe marrëdhëniet e ndërsjella midis komuniteteve)? (rrumbullakësojeni përgjigjen)

1 2 3 4 5

2. Sa ka qenë i rëndësishëm për ju shqyrtimi i problemeve të konstituimit të politikës kulturore të Bosnjës e Hercegovinës për ta kuptuar domethënien e rolit të shtetit dhe instrumenteve të tij të politikës kulturore në nxitjen e zhvillimit kulturor përgjithësisht?

1 2 3 4 5

3. Si aktivist i sektorit civil, a u ka ndihmuar seminari që ta sqaroni rolin e këtij sektori në:

rikonstruktimin e shoqërisë (se cilës nga ato veç e veç) dhe regjionit në tërësi?

1 2 3 4 5

ndërtimin e mërëbesimit në komunitetin lokal dhe në regjion

1 2 3 4 5

thyerjen e barrierave sociale dhe kulturore

1 2 3 4 5

definimin e politikave dhe iniciativave kulturore lokale, shtetërore dhe regionale?

1 2 3 4 5

4. Sa mendoni që metoda e planifikimit strategjik ua hap mundësitë e përparimit të punës?

1 2 3 4 5

5. A i keni vërejtur mangësitë strukturore në funksionimin e OJQ-së suaj pikërisht duke iu falën-
deruar këtij seminarit?

1 2 3 4 5

6. A ua ka ofruar seminari përgjigjet përkatëse për zgjidhjen e problemeve dhe mëdyshjeve në
veprimtarinë e organizatës suaj?

1 2 3 4 5

7. A ua ka zgjeruar seminari njohuritë rreth nevojës së lobimit dhe veprimit aktiv në mjedisin
lokal?

1 2 3 4 5

8. A u ka ndihmuar seminari që ju vetë t'i formësoni programet e ardhshme të bashkëpunimit dhe
komunikimit në regjion nëpërmjet programeve dhe projekteve?

1 2 3 4 5

9. Kualitetin e arritur të komunikimit midis OJQ-ve në kuadër të seminarit e vlerësoni si:
(përshkruajeni)

10. Atmosferën e përgjithshme dhe metodat e punës në seminar i vlerësoni si:
(përshkruajini)

11. A I keni zhvilluar mundësitë e tejkalimit të pengesave në komunikimin midis akterëve kulturorë
nga mjedise të ndryshme?

1 2 3 4 5

12. Si e vlerësoni kontributin e seminarit për zhvillimin e partneritetit në të ardhmen në regjion?

1 2 3 4 5

13. A e vëreni te rrjetëzimi një ndër strategjitet e rëndësishme të zhvillimit të kulturës dhe
bashkëpunimit interkulturor në regjion?

1 2 3 4 5

Argumentojeni: _____

14. A keni arritur në seminar njohuri që do t'uia mundësojnë një konceptualizim më të mirë të pro-
grameve dhe projekteve?

1 2 3 4 5

15. A mendoni që tanë keni mundësi për një vlerësim dhe evaluim mëë të mire të projekteve tuaja
dhe të tjerëve që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe komunikimin lokal dhe regional?

1 2 3 4 5

16. Sa ka qenë seminari, për ju personalisht, i rëndësishëm për ta menduar dhe ripozicionuar
veprimtarinë tuaj personale dhe karrierën e ardhshme?

1 2 3 4 5

17. Sa ua ka mundësuar seminari që nga paraqitjet e pjesëmarrësve dhe nëpërmjet vizitave që ua keni bërë organizatave joqeveritare në Mostar e Sarajevë ta thelloni dijen tuaj për kushtet e ndryshme dhe situatat në viset tjera të regjionit?

1 2 3 4 5

18. A konsideroni që ligjëruesit u janë përgjigjur pritjeve dhe nevojave tuaja?

1 2 3 4 5

19. A ka qenë (ose a do të jetë) e dobishme literatura që u është dhënë?

1 2 3 4 5

20. Si e vlerësoni organizimin e përgjithshëm të seminarit:

në Mostar 1 2 3 4 5


në Sarajevë 1 2 3 4 5

dhe a keni ndonjë propozim për vazhdimin e aktiviteteve të këtilla apo të ngjashme?

SHTOJCA 6.

Mediacioni i artit në paralagje – »FLUX02 - modernizimi gjithandej!«, Beograd

Prezentimi i punimeve të artistëve bashkëkohorë në paralagjet beogradase, autor i projektit: Nebojsa Milikic, redaktor, Rex, www.rex.b92.net/flux02 aksioni i pestë: Kaludjerica - 13. - 15. Nëntor, 2002.



Shfaqja e punimeve video në televizore:

13-15. nëntor – vitrina e bastores FER në rrugën Krala Petra I
13-15. nëntor - STR M në faqen e fundit 309

Projekcionet nga video bim-i do t'I realizojmë në këto lokacione:

13. nëntor në 19:00 - në fasadën e supermarketos PEKABETA në rrugën Krala Petra
14. nëntor në 20:00 - në hollin e Shkollës Filllore 'Aleksa Shantiq'
Autorë: Breda Beban, Miodrag Krkobabiq, Zoran Naskovski, Vladimir Nikoliq dhe
Vera Vecanski, Margareta Stanojloviq

Në prag të çdo aksioni do të vendosen qindra pllakate në të cilat janë punimet:
»Dhjetë me hark – ddhjetë me mundim» (2000, pëlhurë e qëndisur), autorë: SKART + shqata e nënave vetëmbajtëse "GRUAJA" - Zemun (vizatim i Dushica Tomiq, qëndisja Lenka Zelenoviq)
«Lagja prej Azbesti», autor: Ana Adamoviq
«Pllakati për ndeshjen» (nga seria Projekti Popullist) autor: Urosh Gjuriq

«Artistët bashkëkohorë janë të paqartë për publikun» autor: Kovaç Zolt
»Të gjitha vizat Shengen» (fotografi nga seria Pritja për Vizën, nga triptiku: Kalimi illegal i kufirit/Pritja për vizë/Kërkoj burri me pasaportë të EU) autor: Tanja Ostoqiç.

Projekti Flux prezenton dhe popullarizon artin bashkëkohor duke eksposuar punimet e artistëve vendës e të huaj në rrëthana specifike "suburbane". Me një prezentim të këtillë insistohet në interaksionin midis punimeve artistike bashkëkohore dhe pulikut nga mjediset ku gati nuk ekzistojnë programe kulturore. Aksionet janë të orientuara në zbutjen e anëve të këqija të centralizimit të ofertës kulturore dhe në shpërthimin e barrierave kulturologjike e komunikuese, të cilat i izolojnë banorët e paralagjeve nga qendra e qytetit.

Punimet e artistëve bashkëkohorë janë prezantuar në një kontekst të ri, të zhvendosura nga mjedisë i tyre i rëndomtë – galeria dhe qyteti – dhe kështu mundësojnë një qasje më të lehtë për shtresat më të gjera të popullatës, e cila shpesh nuk ka mundësi që nnë mjedisin e vet të njihet me ngjarjet dhe temat e pranishme në skenën artistike.

Flux 02 do të realizohet me aksionet që do të zgjasin tri ditë në Ripanj, Borça, Sremçicë, Kallugjericë dhe Batajnici. Gjatë çdo aksioni, në disa lokacione në vendbanime do të prezantohen punimet video: në TV aparatet në vitrinat e dyqaneve ose kiosqeve (non-stop) dhe projeksione të mbrëmjes që do të mbahen në lokacione të ndryshme. Për çdo aksion të projektit Flux, shtypet fllajeri/katalogu, një faqe të të cilët e redaktojnë bashkorganizatorët lokalë.

SHTOJCA 7.



Deklarata për opinion e Institutit Multimedial, Zagreb

Instituti Multimedial, për shkak të luftës që e kanë nisur SHBA-të në Irak, e ndërpren kontratën me të cilën nga Qeveria e SHBA -ve ka përfituar 100.000 USD për punën në zhvillimin e sektorit civil në Kroaci.

Do të dëshironim t'Ju njoftojmë me arsyet për marrjen e këtij vendimi:

Në fund të vitit 2002, Instituti Multimedial ka marrë një mbështetje financiare dyvjeçare në shumën prej 100.000 USD nga Agjencia për Zhvillimin Ndërkombëtar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) nëpërmjet programit për zhvillimin e organizatave joqeveritare në Kroaci, të cilin e realizon Academy for Educational Development (AED). Me këtë program janë financuar 10 organizațata në Kroaci, të cilat i ka zgjedhur financuesi si çelës për qëndrueshmérinë e sektorit joqeveritar dhe shoqërisë civile, po tërthorazi edhe për zhvillimin e demokracisë.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës – duke mos e respektuar të drejtën ndërkombëtare, duke minuar institucionet ndërkombëtare të vendimarrjes që bazohen në të dhe duke mos e përfillur qëndrimin mbizotërues të opinionit botëror – e filloj luftën në Irak.

Meqë është fjala për një luftë që:

- si precedent bazohet te logjika e luftës preventive,
- është nisur duke mos i respektuar proceset e legjitimimit të bashkësisë ndërkombëtare,
- është e udhëhequr nga interesa korporative për kontrollin e resurseve natyrore,

konkludojmë se një aksion i tillë është i papajtueshmë me parimet dhe vlerat që i mbrojmë dhe se, për këtë arsy, janë ndryshuar parakushtet për bashkëpunim në zhvillimin e demokracisë dhe shoqërisë civile midis organizatës sonë dhe AED-it, prandaj nuk e pranojmë mbështetjen fiananciare të Qeverisë së SHBA-ve dhe e ndërpresim kontraten për bashkëpunim.

Duke reaguar në mënyrë kritike ndaj kontekstit të globalizimit ekonomik, akterë nga e gjithë bota angazhohen për krijimin e parakushteve për globalizim politik dhe social. Duke e konsideruar veten pjesë të këtij opiniioni global, Institutit Multimedial me këtë akt nuk mbron ndonjë pozicion të caktuar nacional, por reagon ndaj luftës në Irak, e cila është e kushtëzuar nga rendi i ri global dhe është në kundërshtim me globalizimin politik.

Në këtë rrugë shprehim keqardhje që, përkundër angazhimit të AED-it dhe marrëdhënies profesionale, po e ndërpresim bashkëpunimin rrëth këtij projekti.

Instituti Multimedial (MI2) është një organizatë joqeveritare që tubon opinionin kritik, dhe që zhvillon mundësitet inovative të veprimit shoqëror dhe kulturor që i ofrojnë teknologjitë e reja informative.

Me zhvillimin e softverit të lirë për bashkëpunim, si dhe me edukimin, angazhimin publik dhe promovimin e qasjes taktike ndaj teknologjive komunikuese dhe masmedias, MI2 e njofton shoqërinë civile me mjetet dhe mënyrat si të sigurojë një jehonë dhe efekt më të madh nëpërmjet një veprimitarje të rjetëzuar dhe të ndërgjegjësuar në aspektin social.

Me hapjen e hapësirës publike për promovimin e iniciativave civile - klubit për net kulturën, MAMA, MI2 bashkepunon drejtpërdrejt me iniciativa dhe shoqata të shumta, si dhe realizon projektet e veta të angazhuara në transformimin kritik të shoqërisë.

Reagimet ndaj Deklaratës së Institutit Multimedial

Date: Wed, 26 Mar 2003 11:41:33 +0100

From: Biljana Kasic <biljana@zamir.net>

Subject: mbështetja

To: m@rcell.net

X-Mailer: QUALCOMM Windows Eudora Light Version 3.0.6 (32)

Dëshiroj t'i falënderoj të gjitha anëtarët dhe anëtarët e Institutit Multimedial për parimësinë rrëth vlerave dhe globalizimit, të shprehur në deklaratën tuaj për opinion, e me rastin e refuzimit të mbështetjes së AED-it. Arsyet tuaja I avancojnë si çështjet e kuptimit të veprimtarisë civile, ashtu edhe çështjet e kontekstualizimit (ideologjik, paqësor/luftarak, financiar, pozicional), e të gjitha këto janë njësoj të rëndësishme.

Ua drejtoj këtë falënderim para së gjithash si një aktiviste civile dhe mbështetëse e shumë aktivitetet tuaja.

Përvendetje të përzemërtë,
Bilana

Date: Thu, 27 Mar 2003 05:20:57 -0800 (PST)

From: Alex Akuti <svingar@yahoo.com>

Subject: Re: deklarata për opinion e Institutit Multimedial

To: Mladen Majetic <mladenm@zamir.net>, m@rcell.net, forca@zamir.net

Nuk kam fjalë për ta përvkruar aktin tuaj. Ju lumi, dhe ju falemnderit për Vetëdijen në aksion. Keni treguar se lufta për ide dhe ideal nuk ka çmim.

Pasi AED-i muajin e katuar ma refuzoi projektin... vetëm atëherë kuptova çfarë gati e kisha bërë...
kurrë nuk kisha menduar se një refuzim përmështetje financiare do të më gjëzonte aq shumë
Peace is not the product of a victory or a command. It has no finishing line, no final deadline, no
fixed definition of achievement. Peace is
a never-ending process, the work of many decisions. (Oscar Arias)

Aleksandra

Date: Fri, 04 Apr 2003 15:02:26 +0200

From: Foresta <foresta@wanadoo.fr>

Subject: Re: [marko-polo-tours@du.tel.hr: Re: hotel korcula 10.04.-17.04.]

To: Marcell <m@rcell.net>

Marcell,

Thanks for the message and all your help. I will contact Ivan directly to see about the hotel on Korcula. I just came back from Prague and London. We now have Prague on Access Grid. Grzesiek was there with me as well as Gabriella and we connected a performance they did in Prague with the Access Grid Network.

I read your declaration and can only say bravo. It is very easy to be against the war, but you put your money where your mouth is and I find it very courageous. I had a phone call from Chris Marker while I was reading it and read it to him. He was also impressed by the fact that you turned back money you certainly needed and avoided being bought off like everybody else supporting the war. Well done.

Not only is the war illegal it is stupid. It is obvious that the Pentagon doesn't know what it is doing. If the war is to be won, it will be won by sheer force creating a further mess to be dealt with in the future. This has to be the worse administrative the US has ever had. I keep saying that after every election but it continues. A country totally lobotomized by the media is

no longer capable of participating in democratic elections and choosing their leader intelligently. We have reached the height of the American Imperial order and I can only hope it is also the beginning of the end. If Europe would only get its act together to create the counter-balance necessary to stop it, there would be hope. I don't have much respect for Europe's politicians and the motivation behind their opposition. I think Chirac is a complete opportunist and Schroeder a political hack. Between the two of them they are destroying the European structure for the sake of their own ambitions. God protect us from our leaders. Bush and Co. have completely destroyed the international structure for maintaining order so painfully put in place after WWII. With the excuse of bringing democracy to Iraq they have ignored the democratic expression of opposition coming from most of the world's democracies. Their hypocrisy is blatantly apparent and their real motives obvious. The administration is made up of bullies, right-wing fanatics, wishful-thinking military bureaucrats, religious fundamentalists, none of whom have any sense of reality except the imaginary world they have built for themselves. I could go on and on. I have never been so depressed at the state of world affairs. I don't defend Saddam for a minute. He is an animal and should be stopped. There were ways of doing it that would have improved world order rather than destroy it. On a last note, what military leadership would put their army in a country during the hottest months of the year for the sake of macho parading? This is not leadership. This is a dog show. The only thing left to do is continue building and doing what we think is important on our own and as fast as we can.

I'll call you when we get to Croatia.

Best to you all,

Don

SHTOJCA 8.



Queer Zagreb

Queer Zagreb është një projekt ndërkombëtar, i bën përpjekje për mdërlidhjen e teorisë queer dhe praktikës. Me programin e vet Queer Zagreb përfaqëson nëpërmjet artit, teorisë dhe aktivizmit shmanget nga heteronormativiteti, si një bashkësi rregullash tradicionale të bazuara te rolet gjinore të dhëna. Queer Zagreb i hulumton modelet shoqërore të ngritura në sistem dhe të vendosura kryesish mbi relacionin midis gjinisë dhe seksit, dhe kështu i hap drejtëpërdrejt çështjet thelbësore për fuqizimin e shoqërisë civile dhe të drejtave të njeriut. Stereotipat shoqërorë, paragjykimet, militarizmi, rapporti i Kishës dhe shtetit, strukturat e ndryshme të familjes, janë vezëm disa nga konstruktet që mund të vëzhgohen nëpërmjet prizmit queer, i cili nuk niset nga marrëdhënie të përcaktuara që më parë dhe të pandryshueshme që bazohen te kategrozimet rigorozë të njerëzve. Sepse, qoftë kur bëhet fjalë për kategorizimet në baë sekxi, etniciteti, ngjyrës së lëkurës, ngjyrës së syve ose orientimit seksual, të gjitha këto në çdo çast mund të bëhen inspirim për diskriminim. Brenda fushës së seksualitetit, queer nuk është një sinonim ekskluzivisht për gay ose lezbizmin, as për çfarëdo kategori tjetër, edhe pse (vetë)përcaktimi si gay ose si lezbike është pjesë e queer-it, si shmangia më e dukshme nga sistemi i pranuar përgjithësisht dhe i nxitur i maskulinitetit a feminitetit. Përket e përkohës së arsyë, programi i Queer-it të Zagrebit më së shumti e prek realitetin gay dhe atë lezbik. Njëkohësisht, me programi mëtohet të bëhet me dije se asnjë konstrukt shoqëror nuk e ka monopolin mbi identitetin queer, por po kështu edhe personat heteroseksual mund të jenë queer për shkak të ndonjë mospërputhjeje tjetër me modelet shoqërore të propaguara. Queer Zagreb ua sjell Zagrebit dhe regjionit për herë të parë një pasqyrë të shfaqjeve, filmave, ekspositave e teorive, të cilat nga njëra anë do të prezantojnë të arriturat e momentit të diskursit queer, ndërsa nga ana tjetër do të përpinqet të artikulojë shqiptimet queer vendëse.

QUEER ZAGREB, 25. – 30. 4. 2003.

sfidat për politikën queer dhe teorinë e shoqërisë'

25. 4. e premte
10:00 Qendra MM, Rr. Sava 25 / punëtori Young Gay America, SHBA
'Përvaja në Kroaci'

Mandy Merck (Britani e Madhe)
"Queer nënshtrimi ekonomik"

18:00 Galeria e Arteve të Aplikuara, Rr. Sava 25 / ekspozitë
'Identiteti postsocialist queer' – hapja e ekspozitës
Young Gay America, SHBA
"Bollëku!"

David Halperin (SHBA)
"Qëndrueshmëria e identitetit"

19:30 GDK Gavella, Rr. Frankopani 8 – hapja e festivalit / loja
Kopergietery & Ives Thuwis, Belgjikë
'Meshkujt'

Nina Wakeford (Britani e Madhe)
"Hulumtimi i queer teknologjive"

26. 4. e shtunë
10:00 - 17: 30 Institut Goethe, Rruga Qyteti Vukovar 64 / konferencë

Dennis Altman (Australi)
"Neokolonializmi ose çlirimi: kush e trilloi gay-in global?"

Dean Vuletiq (Kroaci)
"Homoseksualiteti dhe politika në Kroaci: perspektivat historike"

Matias Waldemar (SHBA)
"Ndryshimi i sensibilitetit në botë"

20:00 MAMA, Rr. Preradoviqi 18 / film
"Një gjë e bukur" / 'Beautiful thing'
(Hettie MacDonald, Britani e Madhe, 1996)

18:00 Qendra për të Drejtat e Njeriut, Rruga Mbreti Držhislav 6 / eksopzitë

Hapja e ekspozitës së Organizatës Lezbike LORI nga Rijeka

Mark Blasius (SAD)
"Çështja e politikës Queer"

20:00 ZKM, Rr. e Testllës 7 / teatër
"I biri i Drakullës", David Drake, SHBA

Corinna Gencschel (Gjermani)
"Politika e shtetasit seksual në kontekstin e botërave sociale neoliberale, si dhe të mënzrave të vjetra dhe të reja të përjashtimit:

21:30 Kinoteka, Rr. Korduni 1 / film
"Aventurat e Felixit" / 'Drole de Felix'
(Oliver Dacastel, Jacques Martineau, Francë, 2001.)

27. 4. e diel

10:00 - 17:30; Instituti Goethe, Rruga Qyteti
Vukovar 64 / konferencë

Pawel Leskowitz (Poloni)
“Drejt sferës publike demokratike: pakicat sek-
suale në shoqëri dhe art sot”

Jonathan D Katz (SHBA)
“Përfytyrimi i të padukshmes: Queer studimet
në historinë e artit”

Ivica Buljan (Kroaci)
‘Kultura e epshi’

Vanja Hamziq (Bosnie e Hercegovinë)
“Perceptimi i identitetit queer në matricën
religjioze, mediale dhe artistike”

Roman Kuhar (Slloveni)
“Mediat mbi homoseksualitetin në Slloveni”

Tea Nikoliq (Serbi)
“Mediat mbi homoseksualitetin në Serbi”

LORI (Kroaci)
‘Mediat mbi homoseksualitetin në Kroaci’
17:00 MAMA, Rr. Preradoviqi 18 / video prezen-
tim / ligjëratë
Out North Alaskë, SHBA
“Rigjallërimi i demokracisë”

18:00 MAMA, Rr. Preradoviqi 18 / film
“Paragrafi 175” / ‘Paragraph 175’
(Rob Epstein, Jeffery Friedman, SHBA, 2000)

20:00 Qendra MM, Rr. e Savës 25 / slide
prezentim / ligjëratë

Young Gay America, SHBA
‘Personat e rinj gay osobe në post gay
Amerikën’

21:30 Kinoteka, rr. Korduni 1 / film
‘Para rënies së natës’ / ‘Before Night Falls’

(Julian Schnabel, SHBA, 2000.)

28. 4. e hiënë
10:00 – 16:30 – Instituti Goethe, Rruga Qyteti
Vukovar 64 / konferencë

Gordan Bosanac (Kroaci)
“Queer në tranzicionin ballkanik”

Svetlana Gjurkoviq (Bosna and Hercegovina)
“Identiteti dhe tranzicioni”

Zvonimir Dobrovic (Kroaci)
“Postsocializmi dhe identitetet queer”

Tavolinë e rrumbullakët
‘Aktivizmi LGBT dhe të drejtat në regjion’ me
ekspozi të shkurtër hyrës:

Ninoslav Mladenovic (Maqedoni)
“Të drejtat LGBT në Maqedoni”

Tatjana Greif (Slloveni)
“Situata juridike e personave LGBT në Slloveni:
procesi i legalizimit

SHTOJCA 9

Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente

STRATEGJA E ZHVILLIMIT TË KULTURËS NË KOSOVË

PRIORITETET (VERSIONI I KONDENSUAR)

HYRJA, HISTORIKU DHE GJENDJA AKTUALE

Të hartohet një strategji për zhvillimin e kulturës kosovare, nuk është detyrë e lehtë, sepse vetë hapësira e Kosovës në këtë situatë të pasluftës nuk është një vend i zakonshëm.

Kombinimi i historisë së saj të vonshme dhe të trazuar me karakteristikat e statusit të tanishëm politik të saj, bëjnë që hartimi i një strategjie që t'i përmbushte nevojat e vendit, është sa delikat po aq edhe urgjent. Në të njëjtën kohë mospërfillja e infrastrukturës kulturore, mungesa e njerëzve me aftësi menaxhimi profesional të kulturës, e bëjnë edhe më të vështirë detyrën e rindërtimit të një jete kulturore, sidomos kur të kemi parasysh faktin se prej vitit 1989 (nga heqja e autonomisë) jetë kulturore në Kosovë mbijetoi jashtë institucioneve të kulturës. Prej atëherë e deri pas intervenimit të Forcave ndërkombëtare, kultura e Kosovës, gradualisht dhe sistematikisht, është shkatërruar nga regjimi serb. Gjuha shqipe ishte ndaluar, institucionet ishin myllur apo nuk përfilleshin fare, njerëzve profesionistë u mohohej e drejta të zhvillonin veprimitari, librat dhe pasuritë artistike ishin shkatërruar së bashku me shumë objekte të trashëgimisë kulturore. Si rezultat i kësaj, nuk ka pjesë të jetës kulturore e cila të mos jetë goditur brutalisht apo të mos ketë nevojë për një rikonstruktim të gjërë.

Sidoqoftë, ardhja e trupave të NATO-s dhe themelimi i administratës së UNMIK-ut ndaluan këtë proces shkatërrues të jetës kulturore e shoqërore dhe tani pas disa vjetëve, sidomos pas formimit të Qeverisë së Kosovës, gjendja ka filluar të normali-
zohet.

Në Kosovë, gjatë periudhës komuniste, shteti kujdesej për të gjitha. Prandaj ai ushtronte kontroll të plotë (ose gati të plotë) mbi jetën kulturore. Tash është e rëndësishme të ecet më tej në krijimin e një modeli më fleksibil, ku shteti do të përkrahë kulturën dhe të investojë në të, por duke ia lënë shoqërisë civile të drejtën të propozojë vendime për përbajtjen dhe zhvillimin e saj. Prandaj, kjo strategji rekomandon fuqishëm që institucionet e kulturës të autorizuara po jo të dirigjuara nga qeveria, të këshillojnë për metodat që duhet të përdoren për të kryer detyrat që janë të nevojshme.

Kultura mundet dhe duhet të na largojë nga konfrontimi, prandaj detyrat që janë të nevojshme për të arritur drejt një caku ambicioz, janë shumë të vështira dhe nuk mund të përbushen që të gjitha përnjëherë. Në të vërtetë, llogaria financiare për ndërtesat dhe institucionet, së bashku me procesin e arsimimit, modernizimit dhe trajnimit, nganjëherë bëjnë që ritmi i ndryshimeve të ndihet më ngadalë sesa do ta dëshironë dikush. Por, nëse nisemi rrugës së duhur, do të kemi një hartë të mirë për të arritur atje ku Kosova do të jetë përcjellje, dhe jo ndjekëse e arritjeve kulturore.

Në këtë proces, duhet të shkruhen ligje të reja, të projektohen e të ndërtohen godina të reja, dhe të krijojen institucione të reja. Duhet të bëhet një modernizim komplet i raporteve në mes qeverisë, shoqërisë civile dhe atyre që punojnë në sektorin e kulturës. Pra, duhet të krijojen metoda të reja të punës dhe financimit, si në institucione, ashtu edhe në vetë qeverinë, në shkallë qendrore, rajonale dhe lokale.

Për këtë arsy, kjo strategji nuk është hartuar nga qeveria, por përmes konsultimeve, propozimeve dhe diskutimeve të ndryshme është shkruar nga shumë njerëz të fushave të ndryshme të kulturës, të cilët për herë të parë po përpilojnë një strategji për zhvillimin e kulturës, e cila orientim qendror ka pikësynimin që kultura në të ardhmen të udhëhiqet nga kuadri i aftë profesional, ndërsa forma e organizimit të brendshëm të jetë sa më shumë e decentralizuar, demokratike dhe transparente.

Prandaj, kjo strategji, nuk ka të bëjë me kthimin në jetën kulturore të së kaluarës. Ka të bëjë me ndërtimin e një kornize të re, e cila do të mund të nxjerrë rezultatet më të mira brenda mundësive që janë në dispozicion. Ambicjet shkojnë edhe më larg, që Kultura Kosovare të bëhet katalizator i zhvillimit ekonomik dhe social të Kosovës, një faktor i demokracisë dhe një resurs i rëndësishëm ekonomik në të ardhmen.

Gjatë katër viteve të administrimit ndërkombëtar, pak gjëra janë bërë si duhet. Në disa raste, ndërtetasat dhe institucionet është lejuar të shkatërrohen edhe më tepër. Buxheti i Ministrisë së Kulturës është i pamjaftueshëm për punët që duhet të bëhen. Nëse ky buxhet nuk do të rritet shumëfish në vitet që vijnë, asnjë nga idetë e theksuara në këtë strategji, nuk do të jepin fryte. Pra, është e nevojshme të gjenden forma të reja të financimit dhe të vetëfinancimit të kulturës, në të ardhmen. Natyrisht duke renditur prioritetet që janë të nevojshme për stabilizimin dhe zhvillimin e jetës kulturore, përmes krijimit të mekanizmave institucionalë në tërë hapësirën e kulturës kosovare, të menaxhuar sipas parimeve dhe standardeve të caktuara nga Këshilli i Evropës.

PARIMET, MARRËDHËNIET NË MES QEVERISË, AUTORITETEVE LOKALE, INSTITUCIONEVE DHE KOMUNITETIT KULTUROR

Strategjia për zhvillimin e kulturës në Kosovë duhet të bazohet në parimet që janë përqafuar gjërësisht nga institucionet dhe shtetet evropiane. Elemente kyç të këtyre parimeve janë transparenca, decentralizimi si dhe përgjegjësitë e ndara rreth përkrahjes së kulturës, në mes shtetit, autoriteteve lokale, shoqërisë civile si dhe komunitetit të biznesit. Parimet e politikës për kulturë burojnë nga të drejtat fundamentale të njeriut, që u përkasin të gjithëve, pa marrë parasysh gjininë, etnititetin, moshën, religionin ose gjuhën.

Me një autonomi të rritur të komunave, autoriteti i tyre për çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e kulturës, do të jetë vendimtar në hapësirën kulturore kosovare, mirëpo gjithnjë në dialog, bashkëpunim e në raporte të rregullta me

Ministrinë e Kulturës dhe autoritetet lokale, që më së miri do të funksiononin duke formuar një Forum apo Këshill të përbërë nga sektorët e Ministrisë dhe drejtoret e kulturës të komunave tona.

Në Kosovë ka nevojë për një organ i cili do të shërbente si një lidhje në mes operatorëve kulturorë, qeverisë dhe publikut të gjërë. Propozohet një organ këshillëdhënës i Ministrit, i cili do të emëronte 9-11 anëtarë (njëri prej tyre të jetë kryetar) të Këshillit Kosovar të Kulturës me mandat dy - tre vjeçar. Anëtarët do të ishin personalitete të njohura të jetës kulturore të Kosovës. Ky këshill do të konsultohej rrëth çështjeve, politikave dhe vendimeve të rëndësishme. Raportet e këtyj këshilli do të ishin të hapura për publikun, kurse raporti vjetor për punën e këtyj organi do t'i dorëzohej Komisionit Parlamentar të Kulturës.

Statusi i institucioneve kulturore që janë në përgjegjësinë e Ministrisë, kanë nevojë për stabilizim dhe ngritje të nivelit të qeverisjes. Propozohet që në të ardhmen, pas krijimit të kushteve për vetëfinancim të këtyre institucioneve, këto të financohen pjesërisht nga Ministria. Institucionet duhet të udhëhiqen nga bordet menaxhuese (profesionale). Kjo duhet të jetë një ndarje e balancuar e autoritetit përkthazi me çështjet administrative dhe profesionale (kulturore) në mes drejtore, bordit të institucionit dhe departamentit përkatës të Ministrisë.

Ministria duhet të institucionalizojë praktikën e ofrimit të granteve për projekte kulturore duke formuar një bord për financimin e projekteve. Shumat dhe prioritetet duhet të përcaktohen në buxhetin vjetor. Duhet të respektohen praktika e ftesave të hapura dhe procesi transparent i përzgjedhjes, si dhe vlerësimi i barabartë E **OBJEKTIIV** gjatë vendim-marrjes. Nuk ka nevojë për përfshirje sektoriale, bazuar në programet e tyre; të drejtë për grante publike kanë të gjitha organizatat joqeveritare dhe komunale si dhe institucionet kulturore private, natyrisht duke dhënë arsyeshmërinë për shpenzimin e këtyre parave publike.

ARTI, INDUSTRITË KULTURORE, LEGJISLACIONI, ARSIMIMI JOFORMAL

Në këta sektori propozohet që në të gjitha fushat e artit prioritet të kenë arsimimi, trajnimi, menaxhimi, legjislacioni, rehabilitimi i objekteve kulturore, krijimi i institucioneve të reja të kulturës si dhe krijimi i kushteve për krijimtari profesionale artistike, duke nisur që nga forma të ndryshme të organizimit të krijuesve, promovimi i krijimtarisë artistike, stimulimi përmes granteve, dhënia e Çmimeve Kombëtare (vjetore dhe jetësore) për veprat dhe krijuesit e veçantë në të gjitha fushat e kulturës, e deri tek sigurimi social i krijuesve të lirë dhe pensionet kombëtare për artistët e nivelit të lartë etj. Të gjitha këto duhet të përcaktohen me kornizën regulative përkatëse për kulturë me prioritetë së;

- Mbrojtja e pronësisë intelektuale (përfshihen të drejtat e autorit, produktet e industrisë kulturore dhe identiteti i artistit);
 - Mbrojtja e punës dhe mirëgenia sociale për krijuesit dhe artistët që duhet realizuar përmes provizioneve të posaçme përbrenda kornizës së përgjithshme ligjore;
 - Legjislacioni fiskal dhe tatimor, ulje tatimi për aktivitete kulturore dhe industrinë kulturore, në veçanti botimin, incizimin, kinemanë, mediat etj, stimulimi fiskal (heqja e doganës për qarkullimin e të mirave kulturore, stimulimi i bamirësisë dhe sponsorimit nga donatorët) etj.;
 - Instrumente të posaçme financiare për përkrahjen e programeve dhe projekteve kulturore, këto mjete do të vilen nga tatime jo të rregullta, lotari të veçanta, fonde kulturore nga donatorët për stimulimin e shërbimeve kulturore.
- Ndërsa për arsimimin joformal është propozuar zhvillimi i mekanizmave për aktivizimin e grupave amatore dhe kategoritë tjera për të promovuar në mënyrë sa më masive jetën kulturore. Posaçërisht theksohet stimulimi i pjesëmarrjes së grupave që rrezikohen nga përashtimi shoqëror, siç janë personat që kanë lënë shkolimin, të papunët, të zhvendosurit, personat me aftësi të kuñzuara, të burgosurit, komuniteti në diasporë dhe sidomos kërkohet aktivizimi i etniteteve në jetën kulturore kosovare. Se si duhet të realizohen të gjitha këto, janë dhënë propozime

konkrete, duke filluar prej trajnimeve për të përfunduar me rindërtimin e infrastrukturës lokale.

Natyrisht që në këta sektorë ka nevojë për formimin e institucioneve të reja, sikundër janë Instituti i Kulturës, Qendra Informative e Kulturës, Instituti i Kulturës Populllore etj. dhe për objekte të nevojshme që duhet të ndërtohen, si: Salla Koncertale - Universale (Qendra e Arteve), Muzeu i Arteve Moderne dhe hapësira të tjera për të gjithë lëmenjtë e kulturës, të caktuar sipas këtyre prioriteteve:

Bibliotekat dhe Letërsia

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të bibliotekave dhe botimeve, propozohet që :

- të aplikohen standartet e deklaratës së IFLA-së për bibliotekat
- të ndërtohet infrastruktura elektronike (digjitalizimi dhe rrjeti unik);
- të bëhen bibliotekat qendra për promovimin e kulturës së Kosovës dhe të botës dhe si qendra informuese;
- brenda Ministrisë së Kulturës të themelohet Këshilli Kombëtar i Librit që do të përcaktonte prioritetet në fushën e publikimeve dhe të aktiviteteve letrare;
- të sigurohet se botuesit do t'i japin Bibliotekës Kombëtare nga dy kopje të botimeve të tyre të reja si ekzemplarë të obligueshëm;
- të financohen botimet që kanë rëndësi të veçantë;
- të rritet rrjeti i marketingut dhe distribuimi i librit dhe revistave;
- të stimulohet organizimi më i mirë i shoqatave dhe klubeve të shkrimitarëve në Kosovë.

Teatri, Vallëzimi dhe Opera

- Të rinovohet infrastruktura e teatrove dhe të krijohet rrjeti i teatrove në tërë hapësirën Kosovës;

- Të ndihmojë autoritetet lokale për të themeluar teatrin - në edukim

- Të ndihmohet themelimi i teatrove të vogla private si dhe i grupeve të vallëzimit;

- Të përkrahet iniciativa për formimin e Operës dhe Baletit;
- Të mbështetet prodhimi i dramës televizive dhe i radiodramës;
- Të stimulohet arsimimi dhe specializimi i të gjitha llojeve të vallëzimit si dhe stimulimi për zhvillimin e koreografisë origjinale.

Artet pamore

- Të sigurohet një standard më i lartë i edukimit për artin në shkolla;
- Të krijohen hapësira për ekspozim në të gjitha komunat e Kosovës;
- Të stimulohet një organizim më efektiv i krijuesve, ngritja e nivelit të krijimtarisë profesionale përmes granteve, udhëtimeve, shpërbërimeve etj.;
- Të themelohet Muzeu i Arteve Moderne për prezantimin e koleksionit të veprave të artistëve kosovarë.

Muzika

- Të stimulohet ngritja e kuadrit profesional muzikor në të gjitha nivelet, sidomos i kuadrove deficitare;
- Të rindërtohet infrastruktura për koncerте në komunat e Kosovës;
- Të ndërtohet Salla Koncertale (Universale);
- Të stimulohetjeta koncertale përmes organizimit të festivalave të zhanreve të ndryshme artistike.

Kinematografia

- Krijimi i një rrjeti modern të kinemave në tërë Kosovën;
- Të themelohet Qendra Kinematografike e Kosovës për mbështetjen financiare të producentëve, pronarëve të kinemave, distributorëve, me qëllim të zhvillimit të kinematografisë vendore, blerjes, distribuimit dhe shfaqjes së filmave;
- Të iniciohen programe trajnuese për artistë, kompozitorë, shkrimitarë, regjisörë, producentë dhe menaxherë të kinemave.

Mediat dhe Kultura

Me qëllim të prezantimit sa më të mirë të kulturës sidomos në mediat audiovizuale, propozohet që pranë Ministrisë të formohet Bordi i Medies, i cili do të përpilojë projekt-propozime për prezantimin sa më efektiv të kulturës në mjetet e informacionit. Bordi do të shërbente si ndërlidhje profesionale në mes Ministrisë së Kulturës dhe Autoritetit të Pavarur të Transmetuesve, i cili pritet të formohet së shpejti nga Parlamenti i Kosovës.

Bordi do të këshillonte dhe do t'i dorëzonte APT-së propozime konkrete që në programet e medies publike për arsimim, informim dhe argëtim niveli prezantimit të kulturës të jetë sa më i lartë, dhe kjo duke filluar prej prodhimeve të dramës radiotelevizive e deri tek prezantimi më kualitativ i të gjitha zhanreve të muzikës, prezantimi i arteve pamore në nivel profesional, përdorimi i standardit të gjuhës shqipe etj. Gjithë këto pa imponuar politikën redaktuese ose ndonjë formë tjetër që është në kundërshtim me ligjet për mediat e pavarura.

Trashëgimia

Kuptimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës është thelbësor për vëtëpërcaktimin e territorit dhe njerëzve të tij. Kjo trashëgimi duhet të përfjetohet si në formën materiale, ashtu edhe në atë shpirtërore. Kujdesi ndaj trashëgimisë kulturore të Kosovës do të jetë vendimtar në promovimin e përkrahjes së diversitetit kulturor brenda hapësirës së Kosovës, si dhe për inkurajimin e turizmit kulturor për vizitorët nga vendet e tjera. Organizimi dhe menaxhimi në këtë fushë janë me rëndësi jetësore në të ardhmen.

Arkivat

Arkivat janë institucione qeveritare dhe joqeveritare, të cilat mbledhin, procesojnë, menaxhojnë, konservojnë, ruajnë dhe ofrojnë shërbime për të arkivuar pasuritë private dhe shtetërore, si dhe këto informacionetë ti vënë në disponicion për publikun.

Prioritete në këtë veprimtari janë:

- Kthimi i materialit arkivor në Kosovë;
- Renovimi i objekteve të arkivave në Kosovë;
- Përmirësimi i standardeve të konservimit dhe inventarizimit sipas standardeve evropiane;
- Riorganizimi i rrjetit arkivor në përputhje me strukturën funksionale.

Muzetë dhe Trashëgimia Lëvizëse

Muzetë janë institucione kulturore - shkencore që mbledhin, prezantojnë dhe interpretojnë vlerat materiale e shpirtërore, të cilat kanë mbijetuar dhe kanë rëndësi të posaçme për gjeneratën e tanishme dhe gjeneratat e ardhshme, me prioritete si:

- Kthimi i eksponenteve arkeologjike dhe etnologjike nga Beograd;
- Hulumtimet për kthimin e pasurive nga vendet e tjera;
- Përmirësimi i standardeve të koleksioneve, ruajtja dhe konservimi i tyre sipas standardeve evropiane;
- Formimi i Institutit Arkeologjik, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit;
- Modernizimi i shërbimeve të muzeve në Kosovë në nivelin kombëtar dhe lokal;
- Krijimi i muzeve të reja në nivelin rajonal dhe lokal me një rrjetëzim dhe përgjegjësi profesionale;
- Pranimi dhe trajnimi i stafit profesional në fushën e menaxhimit të koleksioneve të arkeologjisë dhe trashëgimisë lëvizëse;
- Krijimi i lidhjeve në mes muzeve dhe shërbimeve arsimore për të siguruar që muzetë dhe shkollat të kenë bashkëpunim më intensiv;
- Përcaktimi i përgjegjësive të sektorëve për mbrojtjen e arkeologjisë;
- Marrja e iniciativës për themelimin e Institutit Të Kulturës Popullore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, duke theksuar praninë e diversitetit kulturor.

Trashëgimia Jolëvizëse (Arkitekturore)

Trashëgimia jolëvizëse përfshin të gjitha llojet e ndërtimit të objekteve dhe monumenteve nga e kaluara.

Kjo duhet ruajtur, mbrojtur dhe promovuar për shfrytëzimin sa më korrekt nga gjenerata e sotme dhe gjeneratat e ardhshme.

Për diversitetin kulturor dhe për nxitjen e turizmit kulturor, përmes vetëdijesimit për respektin ndaj trashëgimisë materiale dhe jomateriale, të lëvizshme e të palëvizshme në formë të ndryshme, propozohen prioritetet si:

- Ridefinimi i kornizës institucionale për mbrojtjen e lokacioneve dhe monumenteve dhe percepioni publik për rolin e tij, duke marrë në konsiderim mundësinë e riemërimit

të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në Institut të Trashëgimit të Ndërtuar;

- Inventarizimi i trashëgimisë jolëvizëse sipas standardeve evropiane dhe vlerësimi i gjendjes së tyre;

- Trajnim i më intensiv për stafin në fushën e inventarizimit, konservimit, mjeshtërise

specifike të ndërtimit etj.;

- Themelimi i fondit për mirëmbajtjen emergjente të ndërtesave të rrezikuara të lokacioneve arkeologjike dhe një kërkim më intensiv i donatorëve;

- Sigurimi që Departamenti i Planifikimit Urban të marrë në konsiderim këshillat e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në të gjitha projektet zhvillimore, me theks të posaçëm për ndërtesat historike, dhe sigurimi i një mbrojtjeje më efektive sidomos në rastet kur bëhen ndërtime ilegale.

Trashëgimia natyrore

Natyra është një burim i çmueshëm, me karakteristika të veçanta të hapësirave rajonale, me përshtypje vizuale dhe kujtime historike për identitetin kolektiv, me intervenime njerëzore gjatë shekujve.

Mbrojtja e kësaj pasurie është e rëndësishme jo vetëm për gjeneratat, po edhe për

zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor. Kjo është një përgjegjësi jo vetëm e Ministrisë së Kulturës, por edhe e ministritë të tjera, sikur janë Ministria e Planifikimit, Transportit, Ambientit, e Zhvillimit Ekonomik, e Turizmit dhe e Bujqësisë.

Përbyllja

Në mungesë të statistikave dhe materialeve themelore për gjendjen në fushën e kulturës në Kosovë, që në fillim kemi konkluduar se nuk është aspak lehtë të përiplohet një strategji e zhvillimit kulturor, mirëpo duhet pranuar se edhe më vështirë është që të realizohet kjo strategji.

Të gjitha ato caqe dhe detyra të caktuara në këtë draft, janë diskutuar shumë.

Sidomos janë shoshitur mundësitë e zbatimit praktik të tyre, duke pasur parasysh se çdo përpilim i një politike apo strategjie të tillë përmban në vete një rrezik të posaçëm për realizimin praktik, edhe më shumë në një situatë çfarë është sot kjo në Kosovë, ku pothuajse çdo ide dhe projekt kalon përmes filtrit të "mësimit duke punuar".

Sidoqoftë, këto që u vunë në dukje më lart, përbëjnë një version të shkurtër të prioriteteve, duke mbajtur parasysh të dhënët historike, gjendjen aktuale dhe nevojat e shumta që ka sot kultura kosovare. Pra, ky është një version në vija të trasha i fazës së parë, i nxjerrë nga Drafti Përfundimtar, në të cilin janë saktësuar propozimet e shumta për krijimin e infrastrukturës në hapësirën kulturore, e cila i duhet Kosovës në të ardhmen. Në të njëjtin draft është propozuar edhe faza e dytë për realizimin e kësaj Strategjie, e cila është edhe më e vështirë për një implementim të suksesshëm, duke filluar prej sigurimit të mjeteve financiare, dinamikës së realizimit, vlerësimit profesional - financiar për rehabilitimin e hapësirave kulturore në komunat tona (shtëpitë e kulturës, kinematë etj.), për të përfunduar me promovimin sa më të suksesshëm të kulturës sidomos në Botën e Jashtme dhe inkluadrimin e minoritetave në jetën kulturore. Pastaj vijnë çështjet si: përpilimi i modeleve dhe rregulloreve më adekuate për funksionimin e bordeve që u për-

mendën në këtë draft, modelet për ndërlidhjet sa më të suksesshme të sektorëve brenda Ministrisë si dhe ndërlidhjet e Ministrisë me autoritetet lokale, përpilimi i legjislacionit për kulturë, sidomos përfushat që janë caktuar si prioritete e të tjera.

Pra, mbetet edhe shumë e shumë për të punuar, por shpresojmë se hapin e parë e kemi bërë në drejtim të mirë, sidomos po të kemi parasysh faktin se për herë të parë përpilojmë një strategji të pavarur për zhvillimin e kulturës kosovare, pa përmendur pengesat e shumta si rrjedhojë e gjendjes aktuale të pasluftës.